

UDHËZUES

ADRESIMI I ANTISEMITIZMIT NË SHKOLLË

*Material ndihmës për trajnimin e mësuesve dhe të drejtuesve në
arsimin parauniversitar*

Shtator, 2022

Udhëzuesi “Adresimi i antisemitizmit në shkollë” ka si qëllim të ofrojë materiale dhe burime të bollshme, të besueshme dhe të sigurt për trajnimin e mësuesve dhe të drejtuesve të arsimit parauniversitar, në lidhje me antisemitizmin dhe me holokaustin.

Ky material është një përshtatje e programeve të formimit dhe të trajnimit të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave për adresimin e antisemitizmit në shkollë, të cilat janë zhvilluar me mbështetjen e Qendrës së Kolegjit Universitar të Londrës, ODIHR-it dhe UNESCO-s, në kuadër të Programit të UNESCO-s për Arsimin 2030.

Udhëzuesi ka në fokus rëndësinë e edukimit për antisemitizmin në shkollë. Ai synon të ndërtojë kapacitete drejtuesish dhe mësuesish të aftë për të evidentuar dhe për të parandaluar gjuhën e urrejtjes, sjelljet paragjyquese dhe diskriminuese në shkollë dhe jashtë saj.

Përmbatja

I.	Hyrje	01
I.I.	Përkufizimi i antisemitizmit	02
II.	Struktura e udhëzuesit	03
II.I.	Parimet dhe Qasja	03
II.II.	Korniza e udhëzuesit	04
III.	Zbatimi i udhëzuesit	05
III.I.	Materiale udhëzuese	06
III.II.	Renditja e përmbajtjes	06
III.III.	Planifikimi i përmbajtjes	07
III.IV.	Mësimi i bazuar në skenar	08
III.V.	Perspektivave gjinore	08
III.VI.	Vlerësimi	09
III.VI.I.	Qasje e bazuar në portofol	09
III.VI.II.	Vlerësimi i progresit	09
IV.	Përshtatja e udhëzuesit për të adresuar format të tjera të intolerancës, anësive dhe paragjytimeve	11
1.	Trajtimi i antisemitizmit në kurrikulën e arsimit paruniversitar	13
2.	Fushat, rezultatet, qëndrimet, tematikat kryesore, pyetjet dhe temat	16
3.	Pyetje për temat, rezultatet e të nxënësve dhe materialet udhëzuese	21
3.1	Tema 1. Sa i vetëdijshëm jam? Cilat janë anësitë dhe paragjykimet e mia?	22
3.2	Tema 2. Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e mia si mësuese për të trajtuar antisemitizëm, anësitë dhe paragjykimin?	29
3.3	Tema 3. Në çfarë kontekstesh më të gjera jam pozicionuar dhe si ndikojnë ato tek nxënësit e mi?	32

3.4	Tema 4. Cilat janë format, funksionet dhe pasojat e antisemitizmit?	34
3.5	Tema 5. Cilat janë mënyrat e ndryshme në të cilat hebrenjtë shprehin hebraizmin, judaizmin dhe identitetin e tyre hebre?	40
3.6	Tema 6. Çfarë ndodhi me hebrenjtë gjatë Holokaustit?	44
3.7	Tema 7. Cila është origjina e anësive, paragjykimeve dhe intolerancës? Çfarë funksionesh kryejnë dhe çfarë formash mund të marrin?	48
3.8	Tema 8. Cilat janë bazat disiplinore të specializimit tim lëndor? Çfarë kontributi specifik mund të japë për adresimin e paragjykimeve, intolerancës dhe antisemitizmit?	54
3.9	Tema 9. Si të planifikoj të trajtoj antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet përmes kurrikulës në mënyrë të përshtatshme për moshën?	53
3.10	Tema 10. Si mund të përgatitem për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive incidenteve kritike të antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjykimeve në klasë dhe në mjediset arsimore?	56
3.11	Tema 11. Si mund të ndërtoj te nxënësit aftësitë e mendimit kritik dhe kompetenca të qëndrueshme ndaj antisemitizmit dhe paragjykimeve?	60
3.12	Tema 12. Si mund të bashkëpunoj në mjedisin tim arsimor dhe më gjerë për të sfiduar antisemitizmin dhe paragjykimet?	65
4.	Materialet mbështetëse dhe udhëzuese	71
4.1	Materiale të praktikave më të mira	72
4.1.I	Materiale burimore për fushën “Vetë njohja”	72
4.1.II	Materiale burimore për fushën “Njohuri për përmbajtjen”	74
4.1.III	Materiale burimore për fushën “Njohuri Pedagogjike”	77
4.2	Qasje të bazuara në skenarë për të trajtuar antisemitizmin	82
5.	Mundësi për trajtimin e Holokaustit në kurrikulën e arsimit parauniversitar në Shqipëri.	88
5.1.	Konsiderata metodologjike për mësuesit e lëndëve të historisë, letërsisë, qytetarisë, arteve.	90
5.2.	Mundësi për përfshirjen e Holokaustit në kurrikulën shkollore të arsimit parauniversitar në Shqipëri	97

6. Referencat	111
7. Anekset	116
Aneks 1: Përkufizimi i antisemitizmit i miratuar nga Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit	117
Aneks 2: Përkufizimi i Mohimit dhe Shtrembërimit të Holokaustit i miratuar nga Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit	119
Aneks 3: Shqiptarët dhe Hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore	121
Aneks 4: Holokausti dhe ndihma që shqiptarët u ofruan hebrenjve Luftës së Dytë Botërore	127
Aneks 5: Përdorimi i fjalës hebre në gjuhën shqipe	131
Aneks 6: Deklarata e Stokholmit	132
Aneks 7: Deklarata ministrore e IHRA-s 2020 (2020 IHRA Ministerial Declaration)	134

I. Hyrje

Antisemitizmi, i referuar si "urrejtja më e gjatë [1]", është larg të qenit një sfidë e re. Për shekuj me radhë, antisemitizmi ka vënë në rrezik jetesën, kulturën dhe sigurinë e hebrenjve. Sot, antisemitizmi vazhdon të jetë "një problem shkatërrues që nuk njihet kufij kombëtarë, fetarë, socialë apo ekonomikë" dhe përhapet në variacione të ndryshme në të gjitha rajonet e botës [2]. Studimet e fundit tregojnë një rritje globale të antisemitizmit, i cili ekziston pavarësisht nga prania e komuniteteve të rëndësishme hebreje [3]. Ai po ringjallet si në hapësirën reale ashtu edhe në hapësirën kibernetike [4]. Duke mos u kufizuar më në qarqet ekstremiste, narrativat antisemite marrin formën e tyre në stereotipe, paragjykime dhe teori konspirative, të pranishme në diskursin publik dhe në bisedat e përditshme. Ato cenojnë të drejtat e komuniteteve dhe të individëve hebrenj, i ekspozojnë ata ndaj gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit dhe kërcënojnë sigurinë e tyre fizike. Ashtu si çdo formë diskriminimi, antisemitizmi nuk është një problem me të cilin përballen vetëm komunitetet hebraike. Duke kultivuar ideologji të ankoruara në urrejtje dhe diskriminim, antisemitizmi rrezikon realizimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për çdo individ. Udhëzuesi "Adresimi i antisemitizmit në shkollë" është përshtatje e një grupi me katër vëllime kurrikulash për trajnimin e mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave për të trajtuar antisemitizmin në shkollë, botuar nga UNESCO [5].

Ai synon të ndihmojë trajnerët në fushën e arsimit për të punuar në mënyrë efektive drejt forcimit të kapaciteteve të mësuesve për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur antisemitizmit, këtij lloji specifik dhe shumë të rrezikshëm të paragjykimit të drejtuar ndaj popullit hebre.

Materiali nuk jep domosdoshmërisht fjalën përfundimtare për çështjet e rëndësishme që trajton. Në këtë këndvështrim, ky udhëzues është projektuar që të jetë njëkohësisht gjithëpërfshirës dhe e fuqishëm, por edhe e adaptueshëm, praktik dhe fleksibël në lejimin dhe ofrimin e qasjeve të ndryshme, për t'iu përshtatur rrethanave të veçanta dhe konteksteve specifike lokale dhe kombëtare.

[1] Wistrich, R., *Antisemitism: The Longest Hatred* (New York: Pantheon, 1992).

[2] Anti-Defamation League (ADL), *ADL Global 100: An Index of Anti-Semitism*, <<https://global100.adl.org/map>>.

[3] Për shembull, në vitin 2017, Shtetet e Bashkuara të Amerikës raportuan këtë vit si vitin me rritjen më të madhe të incidenteve antisemitike që nga viti 1979, United States (Anti-Defamation League, *Annual Audit 2017*, <<https://www.adl.org/resources/reports/2017-audit-of-anti-semitic-incidents>>). Trendë të ngjashme janë raportuar dhe nga United Kingdom (Government Response to Home Affairs Committee (2016) Report: "Anti-Semitism in the UK", <https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/576792/CM9386_-_Select_Comitee_Response_-_Antisemitism_in_UK.pdf>), Kanada (Toronto Police, *2017 Annual Hate Crime Statistical Report*, <<https://www.toronto.ca/legdocs/mmis/2018/ex/bgrd/backgroundfile-115202.pdf>>) dhe në France (Jewish Community Security Service (2016) Report on Antisemitism in France, <<https://www.antisemitisme.fr/dl/2016-EN.pdf>>). Në vitin 2014, ADL kreu një sondazh global, i cili testoi qëndrimet ndaj hebrenjve dhe stereotipet anti-hebraike në 101 vende të botës. Sondazhi tregoi se ndjenjat antisemite shpreheshin në mënyrë të barabartë nga njerëzit që kanë takuar një person hebre dhe njerëzit që nuk kanë takuar kurrë një person hebre.

[4] Rosenfeld, A. H., *Resurgent Antisemitism: Global Perspectives* (Bloomington, Indiana: Indiana University Press, 2013).

[5] Publikuar në vitin 2020 nga United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), në kuadër të programit të UNESCO-s për arsimin. Këto kurrikula janë zhvilluar me mbështetjen e: OSCE (The Organization for Security and Co-operation në Europë); ODIHR (Office for Democratic Institutions and Human Rights) dhe Qendrës së Kolegjit Universitar të Londrës.

Procesi i zbatimit do të lejojë që ky udhëzues dhe materialet shoqëruese të përpunohen më tej nga ata që zgjedhin ta zhvillojnë atë.

Udhëzuesi, ndër të tjera, prezanton dhe mundësi për përfshirjen e Holokaustit në kurrikulën shkollore të arsimit parauniversitar në Shqipëri. Ai është me vlerë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtuesve dhe të mësuesve në arsimin parauniversitar. Trajtimi i antisemitizmit është një sfidë e vazhdueshme për të gjithë ata që janë të përfshirë në arsim gjatë gjithë karrierës së tyre.

I.I Përkufizimi i antisemitizmit

Nuk ka një përkufizim të pranuar botërisht dhe antisemitizmi mund të përkufizohet në shumë mënyra, duke filluar, për shembull, nga "urrejtja ndaj hebrenjve [6]", i cili është një përkufizim sintetizues i antisemitizmit:

Antisemitizmi është një kundërshtim kategorik i hebrenjve si mishërues kolektivisht të tipareve të papëlqyeshme dhe/ose shkatërruese. Me fjalë të tjera, besimi që hebrenjtë kanë cilësi të përbashkëta të papëlqyeshme dhe/ose shkatërruese, të cilat i dallojnë popullsitë nga jo-hebre [7].

Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit (IHRA [8]) ka miratuar përkufizimin e mëposhtëm:

Antisemitizmi është një perceptim i caktuar i hebrenjve, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit janë të drejtuara ndaj hebrenjve ose individëve jo-hebrenj dhe/ose pronës së tyre, ndaj institucioneve dhe objekteve fetare të komunitetit hebre [9].

Në botimin e ODIHR-it dhe UNESCO-s "Addressing Anti-semitism through Education [10]", pranohet se antisemitizmi është një koncept kompleks që mund të marrë shumë forma të ndryshme dhe të ketë kuptime dhe referenca të ndryshueshme me kalimin e kohës. Disa nga këto forma janë diskutuar në nënkapitullin 3.4 të udhëzuesit.

[6] Bauer, Y., The Jews: A Contrary People (Zurich and Munich: Lit Verlag, 2014), p. 101.

[7] Hayes, P., Why? Explaining the Holocaust (New York: W.W. Norton and Company, 2017).

[8] The IHRA is an intergovernmental structure that unites governments and experts to strengthen, advance and promote Holocaust education, research and remembrance and to uphold the commitments to the 2000 Declaration of the Stockholm International Forum on the Holocaust. As of September 2019, it numbered 33 member states. See more at <<https://www.holocaustremembrance.com/>>.

[9] IHRA Plenary in Bucharest, "Decision to Adopt a Non-legally Binding Working Definition of Antisemitism". Information provided by the IHRA Romanian Chairmanship, 26 May 2016. The full definition can be found in Annex 1 of this training curriculum. For the web link to the IHRA's "Working Definition of Antisemitism", see <<https://www.holocaustremembrance.com/resources/working-definitions-charters/working-definition-antisemitism>>. Translations of this definition into European Union languages can be found at <<https://ep-wgas.eu/ihra-definition/#translations>>.

[10] Adresimi i antisemitizmit përmes edukimit"

Për qëllime praktike, ky udhëzues e përkufizon antisemitizmin si “një perceptim negativ ndaj popullit hebre dhe veprimet kundër tyre të motivuara nga paragjykimi, urrejtja dhe ideologjitë që e mbështesin atë”.

Antisemitizmi është një formë e veçantë e intolerancës. Antisemitizmi karakterizohet nga mite, trope dhe tregime të përsëritura për hebrenjtë. Këto mobilizohen nga tendenca të ndryshme politike në momente të ndryshme kur hebrenjtë bëhen objekt debati politik. Manifestimet politike dhe të tjera të antisemitizmit të diskutuara në këtë udhëzues duhet të shihen si shembuj ilustrues të mënyrave se si manifestohen format kulturore themelore të antisemitizmit në kohët moderne. Qëllim themelor i edukimit për antisemitizmin duhet të jetë ndërgjegjësimi i individit për këto forma në mënyrë që ata të njihen kur shfaqen në mënyra të parashikueshme dhe të paparashikueshme.

II. Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi dhe materialet shoqëruese shpjegohen më poshtë nga një këndvështrim metodologjik. Këto materiale të trajnimit të mësuesve shërbejnë për të përgatitur mësuesit që të jenë në gjendje për të trajtuar intolerancën dhe veçanërisht antisemitizmin, në një mënyrë të informuar dhe me kompetencë, duke përdorur mjete pedagogjike novatore, si pjesë e një programi shkollor.

II.1 Parimet dhe qasja

Udhëzuesi ka një qasje edukative e bazuar në një sërë parimesh thelbësore që janë zhvilluar dhe futur në praktikë në Qendrën UCL për Edukimin e Holokaustit (<<https://www.holocausteducation.org.uk/>>) dhe janë shpërndarë nga UNESCO [11] dhe ODIHR. Më e rëndësishmja ndër këto është se arsimimi është një e drejtë themelore e njeriut, të cilën e gëzojnë të gjithë, pavarësisht nga gjinia, mosha, përkatësia etnike apo prejardhja. Kjo qasje është e themeluar mbi një besim të fortë në potencialin transformues të arsimit dhe në aftësinë e tij për të çliruar, për të fuqizuar dhe për të frymëzuar. Ajo gjithashtu bazohet në besimin se arsimi ka aftësinë për të ndryshuar qëndrimet, të hapë mendjet, të kapërcejë kufijtë realë dhe imagjinarë dhe të na detyrojë të përballemi me paragjykimet tona. Së fundmi, kjo qasje përcjell besimin se arsimi sot është më i rëndësishëm se kurrë. Është e domosdoshme të zhvillojmë një kuptim më të mirë për veten, për njëri-tjetrin, për sfidat dhe mundësitë me të cilat përballemi në të ashtuquajturën epokë të post -vërtetës, të post-informacionit [12].

[11] As outlined, for example, in the UNESCO 1974 Declaration concerning Education for International Understanding, Co-operation and Peace and Education relating to Human Rights and Fundamental Freedoms, Paris, 1974, <http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13088&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html> and Education 2030: Incheon Declaration and Framework for Action for the implementation of Sustainable Development Goal 4, UNESCO, 2015, <<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245656>>.

[12] Wineburg, S., Why Learn History (When It's Already on Your Phone) (Chicago and London: University of Chicago Press, 2018).

II.II Korniza e udhëzuesit

Duke ndjekur orientimet e ODIHR-it dhe UNESCO-s për trajtimin e antisemitizmit përmes arsimit: hartimi i udhëzuesit, për të lehtësuar përafrimin me edukimin për të drejtat e njeriut, ndjek modelin e Edukimit Global të Qytetarisë të UNESCO-s: Temat dhe rezultatet e të nxënit [13].

Të dhënit mësim në mënyrë që të trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me antisemitizmin, intolerancën, anësitë[14] dhe paragjykimet[15] është një proces kompleks që përfshin zhvillimin e njohurive dhe të kuptuarit në tri fusha: *njohja e vetvetes, njohja e përmbajtjes dhe njohuritë pedagogjike*.

- Njohja e vetvetes, në një kontekst profesional, lidhet si me njohjen personale ashtu edhe me atë profesionale. Njohja personale e vetvetes i referohet vlerave, besimeve dhe motivimeve të heshtura dhe të qarta të mësuesve, si dhe aftësisë së tyre për të reflektuar dhe për të qenë të vetëdijshëm për to në praktikën e tyre. Njohja profesionale e vetvetes i referohet personalitetit dhe praktikave që mësuesit shprehin dhe mishërojnë përmes punës së tyre si mësues, si dhe ndërgjegjësimit reflektiv të tyre për rolet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Njohja e përmbajtjes i referohet njohurive dhe të kuptuarit e çështjeve në fjalë, përkatësisht, antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjykimeve. Kjo nuk ka të bëjë thjesht me njohjen e përmbajtjes në një kuptim akademik konvencional, pasi materiali përfshin njohuri për një sërë mënyrash në të cilat këto dukuri mund të manifestohen në përgjithësi në mjediset arsimore, në shoqëri dhe në debatin publik.
- Njohuritë pedagogjike i referohen njohurive dhe të kuptuarit se si duhet të veprojë mësuesi për të trajtuar antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet, i referohet strategjive të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të mësimdhënies, një sërë metodash të mësimdhënies, si dhe qasjeve proaktive dhe të përgjegjshme.

Temat dhe rezultatet e të nxënit (RN) të sugjeruara në këtë burim bazohen në këto tri fusha. Këto fusha analitike janë të dallueshme, por të ndërlidhura me njëra –tjetrën në praktikë. Një aspekt kyç i njohurive të mësuesve përkrah punës më të gjerë, përtej përmbajtjes së kurrikulës është “njohja e qëllimeve dhe vlerave arsimore”, që thekson rëndësinë për zhvillimin e njohurive dhe aftësive praktike të mësuesve [16].

Rezultatet e të nxënit për mësuesit janë ato që këta profesionistë të arsimit duhet të njohin, kuptojnë dhe zbatojnë, për të qenë të ditur në tri fushat, në mënyrë që pas

[16] Woods. P., Teacher Skills and Strategies (Lewes: The Falmer Press, 1990)

trajnimin të jenë në gjendje për të trajtuar në kurrikul antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet.

Rezultatet e të nxënit do të përmbushen nëpërmjet eksplorimit të një sërë çështjesh, pyetjesh dhe temash kyç. Rezultatet e të nxënit, atributet kryesore, temat kryesore dhe pyetjet janë të detajuara në kapitujt 2 dhe 3 të këtij udhëzuesi.

Udhëzuesi është krijuar për të qenë fleksibël dhe i adaptueshëm me kontekstin.

Tematikat, pyetjet dhe temat kryesore hulumtohen përmes një sërë pyetjesh kyç dhe rezultatesh që shtjellojnë dhe zbërthejnë çështjet e ngritura, duke bërë të mundur menaxhimin dhe adresimin e tyre. Secila tematikë, temë apo pyetje kyç ka rezultatin përkatës mësimor ose grup rezultatesh, rreth të cilave planifikohet dhe vlerësohet të nxënit. Nën pyetjet dhe rezultatet e të nxënit janë specifikuar më tej nënkapitullin 3 të udhëzuesit.

III. Zbatimi i udhëzuesit

Zbatimin e këtij udhëzuesi bazohet në dy kritere:

- a) Synimet dhe materialet duhet të përshtaten me kontekstin e caktuar.
- b) Trajnerët duhet të jenë në gjendje për të marrë vendime se si të përshtatet ky material.

Synimet e udhëzuesit “Adresimi i antisemitizmit në shkollë” janë:

- Të shpjegojë natyrën komplekse të antisemitizmit: manifestimet e tij, karakteristikat, variacionet dhe ndikimin.
- Të përvijojë rezultatet e të nxënit, parimet dhe politikat parandaluese për edukimin e antisemitizmit përmes arsimit.
- Të integrojë antisemitizmin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe pa probleme brenda qasjes ekzistuese arsimore, siç ndodh me edukimin për qytetarinë globale.
- Të përshkruajë fushat kryesore të veprimit dhe të japë udhëzime mbi politikat dhe praktikën pedagogjike për edukimin rreth antisemitizmit në sistemin arsimor.
- Të diskutojë mënyrat për të trajtuar antisemitizmin në shkollë, si parakusht për të mësuar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e nxënësve dhe ato të njeriut.
- Të përfshijë politika për adresimin e antisemitizmit në mjedise të ndryshme arsimore si dhe politika për edukimin e mediave dhe informacionit për të njohur dhe për të refuzuar antisemitizmin në internet.
- Të paraqesë praktika mësimore me qëllim që mësuesit të njohin antisemitizmin dhe t'i përshtatin këto praktika në kontekstin lokal ose kombëtar.

Për të trajtuar antisemitizmin, drejtuesit dhe mësuesit:

- Duhet të sigurojnë që shkolla mbështet mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kultivon respekt dhe përfshirje, ofron mjedise mësimore të sigurta dhe mbështetëse për të gjithë nxënësit.
- Duhet të pranojnë antisemitizmin si një problem që duhet trajtuar përmes kurrikulës shkollore.
- Duhet të integrojnë antisemitizmin si një temë e të drejtave të njeriut përmes qasjeve pedagogjike që promovojnë demokracinë, paqen dhe barazinë gjinore.
- Duhet të sigurojnë zhvillimin e brendshëm profesional të stafit të mësuesve, shfrytëzimin e burimeve të trajnimit të mësuesve, të bazuara në kërkime mbi antisemitizmin. Njohja e mësuesve me teoritë e konspiracionit, stereotipitë antisemite dhe funksionet e tyre sociale dhe politike, në mënyrë që ata të mund t'i identifikojnë dhe t'u përgjigjen atyre në mënyrë të përshtatshme.
- Duhet të promovojnë qasje që luftojnë paragjykimet dhe stereotipat duke zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik dhe reflektues të nxënësve dhe duke zbrëthyer sistematikisht gjininë dhe stereotipitë e tjera.
- Duhet të njohin legjislacionin, procedurat dhe mekanizmat e aksesueshëm të raportimit të incidenteve antisemitike që sigurojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në institucionet arsimore.
- Duhet të promovojnë bashkëpunimin dhe partneritetin ndërmjet shkollave dhe përfaqësuesve të komuniteteve të hebrenjve, si dhe të promovojnë muzetë, memorialët, bibliotekat dhe institucionet e tjera përkatëse.
- Duhet të zhvillojnë aftësitë e shkrim-leximit në media dhe informacion për të nxitur qëndrueshmërinë e nxënësve ndaj manipulimeve, paragjykimeve, stereotipave dhe teorive konspirative.

III.I. Materiale udhëzuese

Të gjitha dokumentet e materialit përmbajnë udhëzime të detajuara. Këto udhëzime ofrohen për secilën nga tematikat, pyetjet dhe temat kryesore. Materiali synon të ofrojë udhëzime duke reflektuar faktin se përmbajtja duhet të përshtatet me kontekstin e saj nga trajnerët e mësuesve dhe drejtuesve që do të zhvillojnë këto materiale.

III.II. Renditja e përmbajtjes

Përmbajtja specifike në lidhje me antisemitizmin, anësitë, paragjykimet dhe intolerancën do të ndryshojë në varësi të vendit, të kontekstit, si dhe moshës së nxënësit. Udhëzuesi nuk e përcakton dhe detyron renditjen. Ai është hartuar në mënyrë të tillë që vetë trajnerët të marrin vendime për renditjen e përmbajtjes. Për shembull:

a) Një qasje deduktive ndaj renditjes së materialit (nga e përgjithshmja tek specifika), duke filluar me koncepte të përgjithshme, si paragjykimi dhe diskriminimi, dhe më pas duke vazhduar me trajtimin në mënyrë specifike të antisemitizmit.

b) Një qasje induktive (nga specifika te e përgjithshmja), fillon duke trajtuar antisemitizmin si një rast të veçantë, përmes të cilit mund të reflektohet mbi format e paragjykit dhe diskriminimit në përgjithësi.

Një mësues që ndjek një *qasje induktive*, fillimisht duhet të trajtojë pyetje të tilla si: *“Cilat janë format, funksionet dhe pasojat e antisemitizmit?”* para se të adresojë pyetje si “Cilat është origjina e paragjyqimeve dhe e intolerancës?; Cilat janë format që ato shfaqen dhe marrin?” Anasjelltas, një mësues që ndjek një *rend deduktiv* duhet të fillojë duke eksploruar pyetjet *“Cilat janë origjina e paragjyqimeve dhe e intolerancës?; Cilat janë format që ato shfaqen dhe marrin?”* para pyetjes “Cilat janë format, funksionet dhe pasojat e antisemitizmit?”

III.III. Planifikimi i përmbajtjes

Udhëzuesi është hartuar për të qenë i adaptueshëm me kontekstin ku trajtohet. Mësuesit për të adresuar këto çështje duhet të përshtatin kurrikulën, orët dhe kohën në dispozicion me kontekstet e tyre mësimore. Ka shumë mënyra në të cilat mund të planifikohet përmbajtja. Një qasje e mundshme përshkruhet më poshtë.

Një ecuri e qartë e të mësuarit mund të hartohet përmes tri fushave (njohja e vetes, njohja e përmbajtjes dhe njohuritë pedagogjike), duke filluar me njohjen e vetvetes. Kjo mënyrë trajtimi mund të shihet si një bazë, në kuptimin që një nxënës, i cili ka pasur fillimisht mundësi për të reflektuar mbi natyrën e anësive dhe mbi paragjykimet e veta personale ka më shumë gjasa të asimilojë materialet dhe t'i përdorë ato mbi paragjykimet komplekse të ngulitura në antisemitizëm sesa një nxënës që nuk e ka pasur një mundësi të tillë. Pra ka kuptim të fokusohemi në njohjen e vetvetes përpara njohjes dhe kuptimit të antisemitizmit.

Është e dobishme, të trajtohet gjerësisht antisemitizmi përpara se të shqyrtohet Holokausti, pasi në kuptimin kronologjik antisemitizmi vjen përpara holokaustit. Ekzistojnë gjithashtu baza etike për të argumentuar se mësuesve duhet t'u kërkohet të reflektojnë mbi judaizmin dhe hebreizmin përpara se të eksplorojnë Holokaustin. Përndryshe, ekziston rreziku që judaizmi dhe hebreizmi të përkufizohen në termat e Holokaustit. Në bazat logjike dhe zhvillimore, ka arsye për t'i dhënë përparësi disa aspekteve të përmbajtjes së kurrikulës mbi të tjerat, duke trajtuar disa elementë si pjesë e lëndëve themelore që mund të mësohen fillimisht dhe të formojnë një bazë mbi të cilën mund të ndërtohen module pasuese më të avancuara.

Përmbajtja themelore mund të jetë fokusi fillestar i kurrikulës, veçanërisht kur koha është e kufizuar dhe aspekte të tjera të përmbajtjes mund të shpërndahen më pas në mënyra të tjera, si p.sh. përmes hulumtimeve individuale. Në përgjithësi, nëse mësuesit nuk kanë pasur një trajnim të tillë gjatë viteve të arsimimit – qoftë fillestar apo të thelluar – trajnimi duhet të jetë pjesë e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm profesional.

III.IV. Mësimi i bazuar në skenar

Kapitulli 4.2 i udhëzuesit paraqet një sërë skenarësh kritikë. Skenarët ndihmojnë në adoptimin e një qasjeje kritike, të bazuar në incidente për adresimin e antisemitizmit, anësive, intolerancës dhe paragjytimeve, në mënyrë që të ndihmojë në trajtimin kompleks të çështjeve në praktikë.

Për shkak se skenarët janë afër praktikës, ata janë të vështirë për t'u shkruar për kontekste të shumta. Shembujt e dhënë në kapitullin 4.2 sugjerohen vetëm si shembuj dhe jo si modelet që duhen ndjekur. Trajnuesit e mësuesve duhet t'i përshtatin këto në kontekstet e tyre të veçanta.

Kapitulli 5 i këtij udhëzuesi paraqet mundësi për përfshirjen dhe trajtimin e Holokaustit në kurrikulën shkollore të arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe konsiderata metodologjike për mësuesit e lëndëve të historisë, letërsisë, qytetarisë, arteve.

III.V. Marrja e perspektivave gjinore

Këto materiale ndjekin udhëzimet e dhëna në ODIHR dhe UNESCO's "Addressing Anti-Semitism Through Education", veçanërisht:

Edukimi mbi perspektivën gjinore është thelbësor për nxënësit që të fillojnë të kuptojnë dinamikën e identitetit në përgjithësi. Marrja në konsideratë e kësaj qasjeje mund të jetë e dobishme, pasi është një qasje e testuar nga mësuesit dhe mund të përshtatet për demaskimin e paragjytimeve apo të diskriminimeve të tjera. Është e rëndësishme për mësuesit të marrin në konsideratë rëndësinë e kryqëzimeve, të përbashkëtave dhe dallimeve ndërmjet gjinive, racave dhe akteve të tjera të pabarazisë ose të paragjytimeve, duke përfshirë antisemitizmin.

Në këtë drejtim, ndërsektorialiteti është një koncept i njohur në diskutimet bashkëkohore të barazisë dhe të barrierave ndaj barazisë [17]:

Interseksionaliteti është një mënyrë për të parë mbivendosjen dhe kryqëzimet e identiteteve të grupeve shoqërore të njerëzve (p.sh., raca, gjinia, klasa, identiteti gjinor, feja, orientimi seksual, paaftësia, etj.) dhe trajton sistemet e ndërlidhura dhe ndërthura të paragjyimit, diskriminimit dhe shtypjes [18].

[17] Phoenix, A., "What is intersectionality?", BritishAcademy website, 8 March 2018, <<https://www.thebritishacademy.ac.uk/blog/what-is-intersectionality>>.

[18] "What the Women's March Teaches Us about Intersectionality", ADL Website, 24 January 2017, <<https://www.adl.org/blog/what-the-womens-march-teaches-us-about-intersectionality>>.

Konsiderimi i perspektivës gjinore mundëson që të eksplorojnë kryqëzimet midis gjinisë dhe faktorëve të tjerë të pabarazisë.

Kërkojuni mësuesve të marrin në konsideratë ndryshimin që mund të bëjë gjinia në shqyrtimin e çështjeve të ndryshme. Mësuesit duhet të përdorin qartë perspektivat e ndryshme gjinore në punën e tyre me nxënësit, duke u kërkuar shpesh atyre të marrin në konsideratë ndryshimin që bën gjinia në lidhje me çështjet e antisemitizmit, paragjytimeve dhe intolerancës. Trajneri për shembull, mund të ndryshojë gjininë e pjesëmarrësve kryesorë në skenarë (kapitulli 4), pasi mësuesit kanë pasur mundësi t'i marrin në konsideratë. Kjo do t'i lejojë mësuesit (të trajnuarit) të shohin nëse kjo e ndryshon reagimin e tyre apo kuptimin e dinamikës së situatave që po shqyrtojnë. Shkalla e ndryshimit të bërë nga ndryshimi i perspektivave gjinore ka të ngjarë të ndryshojë shumë sipas vendit dhe rajonit, si dhe në varësi të elementeve të skenarit që ndryshohen (për shembull, gjinia e mësuesit ose gjinia e nxënësit).

III.VI. Vlerësimi

Meqenëse pritet që ky material të përshtatet në kontekstin e tij në një sërë mënyrash, do të ishte e përshtatshme të ishte tepër përshkruese në komentet se si ai mund të zbatohet, kjo veçanërisht në lidhje me vlerësimin. Megjithatë, më poshtë jepen disa rekomandime se si mund të organizohet vlerësimi në kontekste bashkëkohore.

III.VI.I. Qasja e bazuar në portofol

Një qasje e zakonshme për vlerësimin e të nxënit është vlerësimi i bazuar në portofol, i cili përdoret shpesh në kontekste profesionale, siç është kualifikimi i mësuesve në të cilin grumbullimi i dëshmive të praktikës është shpesh një mënyrë shumë efektive për vlerësimin e kompetencave dhe të praktikës.

Një qasje e bazuar në portofol përputhet mirë me strukturën e udhëzuesit, pasi të tria fushat ofrojnë parime të qarta organizimi, sipas të cilave mësuesit mund të mbledhin dëshmi të të nxënit. Rezultatet e të nxënit të renditura në këtë udhëzues ofrojnë kriteret përmes të cilave mund të kryhet vlerësimi. Gjithashtu ka mundësi për reflektime praktike, kur mësohet për anësitë, paragjykimet, intolerancën dhe antisemitizmin (siç është theksuar, për shembull, në kapitullin 4.2 të udhëzuesit në lidhje me të mësuarit e bazuar në skenar).

III.VI.II. Vlerësimi i progresit

Një konsideratë kryesore kur mendohet për vlerësimin është progresi, i cili mund të përkufizohet më së mirë në termat e arritjes së nxënësve. Përparimi në mësim mundëson nxënësit të trajtojnë një numër më të madh detyrash dhe problemesh (një rritje sasiore në fuqinë e ideve të tyre) dhe të trajtojnë detyrat dhe problemet me kompleksitet në rritje (një rritje cilësore në fuqinë e ideve të tyre).

Ndjekja e progresit mbi bazën e përmbushjes së rezultateve të të nxënit është e natyrës kumulative dhe përfshin ndërtimin e kuptimeve të reja mbi bazën e atyre ekzistuese. Kështu, për shembull, rezultati i të nxënit numër 18, i cili gjurmon aftësitë e mësuesve për të dalluar anësitë, paragjykimet dhe intolerancën në përgjithësi, është themelor për përmbushjen e rezultatit të të nxënit numër 19, i cili gjurmon aftësitë e mësuesve për të dalluar midis antisemitizmit dhe llojeve të tjera të paragjytimeve dhe intolerancës. Në raste të tilla, vlerësimi i progresionit nuk mund të ndahet nga renditja e përmbajtjes. Progresi dhe vlerësimi i progresionit, në këto raste, është i varur nga rruga dhe përfshin renditjen e mësimit në mënyrë kumulative. Megjithatë, ka shumë raste kur përparimi përfshin ndërtimin e zotërimit të ideve që nuk demonstrojnë varësi logjike nga njëra-tjetra. Tema 11, për shembull, përfshin ndërtimin e "kompetencave të mendimit kritik ndaj antisemitizmit dhe paragjykit" duke eksploruar ide që janë cilësisht të dallueshme dhe që nuk varen nga njëra-tjetra në mënyrë kumulative, të tilla si kuptimi i të drejtave të njeriut.

Rezultatet e të nxënit shprehin qartë se si mund të matet progresi i arritjeve të tyre. Disa rezultate identifikojnë veprimet ose kryerjen e aktiviteteve dhe për këtë arsye duhet të vlerësohen përmes performancës - përmes përfundimit të veprimeve ose detyrave që tregojnë se kompetenca është fituar. Një shembull i tillë është rezultati i të nxënit numër 30, nëpërmjet të cilit kërkohet që mësuesit të demonstrojnë se mund "të kuptojnë, të zhvillojnë njohuritë, të planifikojnë dhe të kryejnë vlerësimin e nxënësve për çështjet e të drejtave të njeriut". Është e qartë se e vetmja mënyrë për ta demonstruar këtë është nëpërmjet kryerjes së një planifikimi të tillë. Rezultate të tjera, për shembull rezultati i të nxënit numër 18, i cili kërkon nga mësuesit të bëjnë dallimin midis koncepteve: anësi, paragjykim dhe intolerancë, mund të vlerësohen në mënyra shumë më të thjeshta, si p.sh. përmes ushtrimeve të punës në klasë të krijuara për të testuar njohuritë konceptuale.

Ushtrimi i vlerësimit në klasë

Mësuesit renditin rastet e skenarëve të ndryshëm që demonstrojnë paragjytime dhe intolerancë, në segmente të ndryshme të një Diagrami të Venit dhe hartojnë marrëdhëniet midis këtyre koncepteve.



Së fundi, ka rezultate të nxëni që kërkojnë integrimin e njohurive dhe të kuptuarit dhe që për rrjedhojë, vlerësohen më së miri përmes detyrave që kërkojnë veprim dhe reflektim. Rezultati me numër 16, për shembull, kërkon që mësuesit "të dinë se çfarë ndodhi me hebrenjtë e Evropës gjatë Holokaustit", si dhe "të marrin njohuri për lidhjet që vendi i tyre ka me këtë histori". E para mund të vlerësohet në mënyra relativisht të thjeshta, përmes pyetjeve faktike (p.sh., *"A ishin të gjitha kampet e përqendrimit kampe vdekjeje?"*; *"Si u trajtuan hebrenjtë në vendin tonë?"*) dhe përmes pyetjeve që vlerësojnë zotërimin e koncepteve përkatëse (p.sh., *"Çfarë e dallon gjenocidin nga persekutimi?"*). Megjithatë, kjo e fundit kërkon që si tregimi i ngjarjeve të Holokaustit ashtu edhe rrëfimi i zhvillimeve në një vend të caktuar të konsiderohen së bashku, duke lejuar një shqyrtim të lidhjeve të ndryshme ndërmjet tyre. Ky është një rezultat që mund të vlerësohet më mirë nëpërmjet një detyre reflektimi, për shembull, një kërkimi në internet ose një diskutim në klasë të vëzhguar nga mësuesi: "Hebrenjtë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore"

IV. Përshtatja e udhëzuesit për të adresuar forma të tjera të intolerancës dhe paragjykitimit

Siç u argumentua më sipër dhe në materialet udhëzuese që shoqërojnë udhëzuesin, duke trajtuar antisemitizmin, intolerancën dhe paragjykimin duhet të mendosh për të paktën tri fusha: të njohjes së vetes, njohjes së përmbajtjes dhe njohurive pedagogjike.

- **Fusha e parë** (njohja e vetvetes) që ka të bëjë me ndërgjegjësimin e mësuesve, ka të ngjarë të përfshijë të njëjtat çështje kyç, pavarësisht nga lloji specifik i paragjykitimit që trajtohet pasi njohuritë dhe mirëkuptimi i nevojshëm për të marrë në konsideratë rolin që luan stereotipi në shumë ndërveprime shoqërore, zbatohen në të gjitha kontekstet.
- **Fusha e tretë** (njohuritë pedagogjike) e fokusuar në ndërtimin e mendimit kritik dhe shkrim-leximit mediatik është e pavarur nga konteksti në shumë aspekte, veçanërisht duke pasur parasysh shtrirjen globale të formave dhe formateve të veçanta të medias.

Ndërsa fusha e dytë (njohja e përmbajtjes) që lidhet me njohuritë specifike për formën e intolerancës dhe/ose paragjykitimeve që trajtohen, do të ndryshojë në varësi të formës specifike të adresimit të tyre, kjo pasi forma të ndryshme të intolerancës raciste kanë historitë e tyre specifike. Për shembull, adresimi i paragjykitimeve ndaj komuniteteve romë në kontekstet e Evropës Jugore, Perëndimore, Qendrore dhe Lindore kërkon njohuri të historive, tropeve dhe stereotipeve të ndryshme.

Përshtatja e udhëzuesit për të trajtuar forma të ndryshme të intolerancës, paragjytimeve është e mundur, por do të kërkonte modifikim të pyetjeve në fushën e tretë, si p.sh. lidhur me temën 9 "Si mund të planifikoj të trajtoj antisemitizmin, intolerancën dhe paragjykimet nëpërmjet arsimit në mënyrë të përshtatshme për moshën e nxënësve?". Megjithëse intoleranca dhe paragjykimi janë koncepte universale në historinë njerëzore, ato janë manifestuar gjithmonë në kontekste specifike historike dhe kulturore, kështu që ato nuk mund të trajtohen të izoluara nga koha dhe vendi i tyre.

01

TRAJTIMI I ANTISEMITIZMIT NË KURRIKULËN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Trajtimi i antisemitizmit fillon që në edukimin e hershëm të nxënësve në arsimin fillor duke vijuar më pas në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. Arsimi fillor (AF) është thelbësor për nxënësit nëse duam që të përparojnë në pjesën tjetër të karrierës së tyre shkollore dhe më gjerë, pasi këtu ata fillojnë të përjetojnë arsimin formal. Në arsimin fillor nxënësit mësojnë se ka burime të tjera informacioni për botën përveç prindërve, vëllezërve, motrave apo të afërmeve të tjerë. Qëndrimet ndaj të mësuarit dhe sjelljet e vendosura gjatë arsimit fillor janë thelbësore për mënyrën se si nxënësit zhvillohen gjatë viteve në vijim. Prandaj, në një mënyrë shumë reale, arsimi fillor është themelor për zhvillimin e mëvonshëm të nxënësve.

Kurrikulat e arsimit fillor janë shpesh tematike dhe ndërdisiplinore në natyrë, duke i lejuar nxënësit të shikojnë çështje dhe koncepte të zhvilluara brenda një sërë lëndësh/disiplinash. Kjo inkurajon një qasje më holistike ndaj të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijëve sesa ndodh në vitet e mëvonshme. Rrjedhimisht, kur nxënësit eksplorojnë çështje të gjera që nuk i përkasin vetëm një lënde, të tilla si të drejtat e njeriut, kombësia, ndryshimet klimatike dhe ushqimi i shëndetshëm, mësuesit kanë shpesh mundësi që të japin mësim në një mënyrë tematike, duke eksploruar këto çështje në të gjitha lëndët/ disiplinat, si dhe duke përdorur koncepte dhe metodologji ndërdisiplinore për të mbështetur mësimin. Ky multidisiplinaritet është i dobishëm për t'i prezantuar dhe për t'i familjarizuar nxënësit me konceptet e intolerancës, paragjykitimit dhe antisemitizmit në një sërë mënyrash – përmes letërsisë, dramës, historisë, gjeografisë, matematikës, qytetarisë etj. Ekziston po aq mundësia për t'iu qasur temave në një mënyrë të bazuar në çështje, për shembull duke u fokusuar në temën e emigracionit ose në një temë tjetër që lejon lidhjet midis çështjeve të të drejtave të njeriut në të shkuarën dhe në të tashmen.

Paragjykimet mund të trajtohen më lehtë në arsimin fillor. Të mësuarit rreth Holokaustit gjithashtu mund të përshtatet shumë lehtë në procesin mësimor në shumë kontekste parësore, për shembull, në mësimet tematike me fokus në historinë personale.

Prezantimi i Holokaustit në vitet e para kërkon një qasje të përshtatshme për moshën. Për shembull mësimet mbi tolerancën dhe respektin mund të ndërtohen me rritjen e kompleksitetit në klasat e mëvonshme.

Gjatë viteve të arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë nxënësit angazhohen me kurrikulën e shkollës përmes studimit të lëndëve të veçanta. Këto lëndë mësohen nga mësues lëndor, të cilët në bazë të trajnimit ose kualifikimeve të tyre, kanë ekspertizë specifike për atë fushë të kurrikulës.

Organizimi i kurrikulës me lëndë të veçanta paraqet gjithashtu mundësi të shumta për trajtimin dhe luftimin e antisemitizmit, paragjykimeve, intolerancës dhe paragjykimeve. Njohuritë, të kuptuarit ose kompetencat që një nxënës mund të nxjerrë nga studimi i çdo lënde të caktuar janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën disiplinore të asaj lënde. Rrjedhimisht, kjo krijon mundësinë që nxënësit të zhvillojnë dhe kuptojnë atë që dinë në lidhje me fenomenet e ndryshme të antisemitizmit, intolerancës dhe paragjykimeve, si në thellësi ashtu edhe në gjerësi. Me planifikimin e duhur, nëpërmjet qasjeve ndërkurrikulare, mësuesi u mundëson gjithashtu nxënësve, të mësuarin holistik në mënyrë që ata të fitojnë kuptime shumëdimensionale dhe perspektive në lidhje me këto çështje.

Mësuesit duhet të kuptojnë disiplinat e ndryshme që përdorin për të mbështetur nxënësit. Ata duhet të jenë në gjendje të artikulojnë mënyrën se si lëndë të ndryshme ndërveprojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën kur shqyrtojnë çështjet e paragjykimeve, intolerancës, paragjykimeve dhe antisemitizmit.

Një mësim i tillë nuk mund t'i lihet rastësisë. Që të ketë sukses, mësimi holistik duhet të planifikohet dhe të bashkërendohet. Kjo është arsyeja pse mësuesit duhet të jenë në gjendje të artikulojnë natyrën e disiplinave të ndryshme të përfshira në këtë mësim.

Në udhëzimet më poshtë aty ku është e përshtatshme, ka orientime drejt mënyrave të veçanta, në të cilat lëndë specifike [19] mund t'u qasen çështjeve që kanë të bëjnë me antisemitizmin, intolerancën dhe paragjykimet.

Në dritën e këtyre konsideratave dhe të faktit se mësimdhënia mbi Holokaustin është e zakonshme në kontekste kombëtare në mbarë botën është qartësisht e nevojshme që mësuesit e arsimit parauniversitar të pajisen me vetë kuptim, përmbajtjen dhe njohuritë pedagogjike që do t'u nevojiten për t'i trajtuar këto çështje me nxënësit e tyre.

[19] Shih kapitullin 5

02

FUSHAT, REZULTATET E TË NXËNIT, QËNDRIMET, TEMATIKAT KRYESORE, PYETJE DHE TEMAT

FUSHAT

Njohja e vetvetes

Njohuritë pedagogjike

Njohja e përmbajtjes

Rezultatet kyç të të nxënit

Mësuesit mbrojnë të drejtat e njeriut dhe trajtojnë në mënyrë efektive antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet në klasat e tyre, komunitetet shkollore dhe kontekstet më të gjera.

Mësuesit dinë dhe kuptojnë se çfarë është antisemitizmi historik dhe bashkëkohor, si dhe çfarë është intoleranca, anësia dhe paragjyrimi. Ata janë të vetëdijshëm për origjinën, format që marrin secili, si dhe funksionet e tyre.

Mësuesit zotërojnë strategji që ndihmojnë ndërtimin e njohurive të nxënësve për kuptimin e antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjyimeve në mënyra të përshtatshme për moshën.

Mësuesit reflektojnë mbi paragjykimet dhe supozimet e tyre, si dhe mbi natyrën e tyre si qenie emocionale. Ata zhvillojnë vetëdije të zgjeruar për vlerat, identitetet dhe përgjegjësitë e tyre personale dhe profesionale.

Mësuesit njohin antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet si çështje e të drejtave të njeriut dhe e kuptojnë antisemitizmin si një problem global që mund të jetë i pranishëm edhe aty ku nuk vërehet apo kuptohet.

Mësuesit fitojnë njohuri rreth strategjive që mund të ndihmojnë në ndërtimin e aftësive të mendimit kritik të nxënësve ndaj antisemitizmit dhe intolerancës, ndërgjegjësimi të tyre për anësitë dhe paragjykimet, si dhe aftësinë e tyre për të sfiduar këto dukuri kur ato shfaqen.

Mësuesit janë të ndjeshëm ndaj ndikimit njerëzor të antisemitizmit, intolerancës dhe paragjyimeve.

Mësuesit kuptojnë se si antisemitizmi dhe paragjyime të tjera komunikohen, shpërndahen dhe promovohen në botën e sotme.

Mësuesit janë të gatshëm dhe të aftë të punojnë brenda dhe ndërmjet ekipeve në mjediset e tyre arsimore, si dhe në komunitetet e tyre lokale, për të trajtuar antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet.

FUSHAT

Njohja e vetvetes

Njohuritë pedagogjike

Njohja e përmbajtjes

Rezultatet kyç të të nxënit

Mësuesit janë të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm për kontekstet e mbivendosura brenda të cilave janë pozicionuar. Ata mund të identifikojnë sfidat dhe mundësitë që ofrojnë këto kontekste për të trajtuar antisemitizmin, anësitë, intolerancën dhe paragjykimet.

Mësuesit kanë njohuri për judaizmin dhe për diversitetin e jetës hebreje, sot dhe gjatë historisë, si dhe për Izraelin, duke u mundësuar nxënësve të sfidojnë keqkuptimet e përhapura në shoqëri.

Mësuesit dinë dhe kuptojnë sesi planifikimi i kurrikulës dhe reagimet ndaj incidenteve kritike funksionojnë për të ndërtuar fleksibilitet dhe për të sfiduar antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet.

Mësuesit zhvillojnë të kuptuarit e ligjeve në lidhje me diskriminimin, krimin e urrejtjes, antisemitizmin dhe racizmin në kontekstin e vendit të tyre.

FUSHAT

Njohja e vetvetes

Njohuritë pedagogjike

Njohja e përmbajtjes

Rezultatet kyç të qëndrimeve

Reflektues, i përkushtuar dhe i angazhuar në aspektin etik

Mësuesit demonstrojnë ndërgjegjësim për rolin e tyre profesional dhe personal në mësimdhënie. Ata shfaqin angazhimin e tyre në trajtimin e antisemitizmit, intolerancës dhe paragjyimit.

I ditur dhe i mirinformuar

Mësuesit kanë njohuri të qarta për trajtimin e antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjyimeve. Ata kanë një kuptim të qartë të pasojave që këto fenomene kanë për arsimin dhe të drejtat e njeriut. Mësuesit identifikojnë se si t'i zbatojnë njohuritë në praktikën e tyre mësimore.

I aftë, i shkathët dhe reflektues

Mësuesit janë të sigurt dhe kompetent në përdorimin e strategjive pedagogjike që trajtojnë antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet. Ata janë fleksibël për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme konteksteve të caktuara. Ata janë të aftë të kuptojnë sesi arsimi ndërton qëndrueshmërinë e nxënësve ndaj këtyre fenomeneve.

FUSHAT

Njohja e vetvetes

Njohuritë pedagogjike

Njohja e përmbajtjes

Tematikat kryesore, pyetjet dhe temat

1. **Tema 1.** Sa i vetëdijshëm jam? Cilat janë anësitë dhe paragjykimet e mia?

2. **Tema 2.** Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e mia si mësues për të trajtuar antisemitizmin, anësitë dhe paragjykimin?

3. **Tema 3.** Në çfarë kontekstesh më të gjera jam pozicionuar dhe si ndikojnë ato tek nxënësit e mi?

4. **Tema 4.** Cilat janë format, funksionet dhe pasojat e antisemitizmit?

5. **Tema 5.** Cilat janë mënyrat e ndryshme në të cilat hebrenjtë e shprehin hebraizmin, judaizmin dhe identitetin e tyre hebre? A ka besime dhe zakone të përbashkëta? Cilat janë lidhjet me Izraelin?

6. **Tema 6.** Çfarë ndodhi me hebrenjtë gjatë Holokaustit?

7. **Tema 7.** Cila është origjina e anësive, paragjykimeve dhe intolerancës? Çfarë funksionesh kryejnë dhe çfarë formash mund të marrin?

8. **Tema 8.** Cilat janë bazat disiplinore të formimit tim lëndor? Çfarë kontributi(et) specifik mund të japë për adresimin e anësive, paragjykimeve, intolerancës dhe antisemitizmit?

9. **Tema 9.** Si planifikoj të trajtoj antisemitizmin, intolerancën, anësitë dhe paragjykimet, në mënyrë të përshtatshme për moshën e nxënësve?

10. **Tema 10.** Si mund të përgatitem për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive incidenteve kritike të antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjykimeve në klasë dhe në mjediset arsimore?


11. **Tema 11.** Si mund të ndërtoj te nxënësit kompetencat kritike dhe të qëndrueshme ndaj antisemitizmit dhe paragjykimeve?

12. **Tema 12.** Si mund të bashkëpunoj në mjedisin tim institucional dhe më gjerë për të sfiduar antisemitizmin dhe paragjykimet?

03

FPYETJE PËR TEMAT, REZULTATET E TË NXËNIT DHE MATERIALET UDHËZUESE

3.1. Tema 1.



Sa i vetëdijshëm jam? Cilat janë anësitë dhe paragjykimet e mia?

Pyetje për temën

- Cilat janë vlerat dhe parimet e mia thelbësore?
- Cilat janë anësitë e mia?
- A kam paragjykime?
- Cilat janë ato?
- A kam stereotipa?

Rezultatet e të nxënit

RN1: Mësuesit identifikojnë dhe artikulojnë vlerat dhe parimet e tyre personale dhe në veçanti se si këto vlera dhe parime ndikojnë në qasjen e tyre ndaj mësimdhënies.

RN2: Mësuesit eksplorojnë natyrën e paragjykimeve dhe shkallën në të cilën ata si individë mund të ballafaqohen me paragjykimet dhe stereotipat dhe se si kjo mund të ndikojë në mësimdhënien e tyre.

Nëse mësuesit do të jenë në gjendje t'i edukojnë nxënësit rreth antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjykimeve, ata duhet të jenë të qartë se pse është e rëndësishme të trajtohen këto çështje dhe të kenë një njohje dhe një kuptim të saktë për këto çështje. Antisemitizmi, intoleranca, anësia dhe paragjykimi janë çështje të ndjeshme për t'u eksploruar. Manifestimi i anësive dhe paragjykimeve mbart stigmë sociale dhe për rrjedhojë dhe rrezik social. Në përgjithësi, njerëzit mendojnë se pikëpamjet e tyre për grupet e tjera janë private dhe jo çështje për diskutim publik. Për këtë arsye, paragjykimet dhe stereotipat duhet të hulumtohen me ndjeshmëri dhe në mënyrë të hapur për diskutimin dhe kategorizimin e rolit të supozimit, paragjykimet, stereotipit, me qëllim që të pranohet se këto fenomene megjithëse komplekse, janë aspekte normale që bëhen patologjike vetëm nëse lejohet të funksionojnë pa kufizime.

Anësi i referohet tendencës sistematike për të vlerësuar në mënyrë më të favorshme grupin e vet të anëtarësimit (grupin e brendshëm) ose anëtarët e tij karshi një grupi jo anëtarësh (grupi të jashtëm që nuk bën pjesë ose nuk i përket)[20]. Anësitë nxiten dhe ruhen nga procese normale psikologjike dhe nga procese sociale dhe strukturore.

[20] Dovidio, J. F., Hewstone, M., Glick, P. & Esses, V. M. (Eds.), The Sage Handbook of Prejudice, Stereotyping and Discrimination (London: SAGE Publications Ltd, 2010), p. 3.

Stereotipat, paragjykimet dhe diskriminimi shihen si forma të paragjykimeve sociale.

Stereotipat janë “shoqërime (lidhje) dhe besime (dogma) rreth karakteristikave dhe attributeve të një grupi dhe anëtarëve të tij që formësojnë mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe reagojnë ndaj grupit”. Literatura e fundit psikologjike sugjeron dy dimensione themelore të stereotipave: të përzemërt (të ngrohtë) dhe kompetent (autoritarë, të pushtetshëm). Përzemërsia lidhet me grupet bashkëpunuese dhe u mohohet grupeve konkurruese. Autoriteti (kompetenti) lidhet me grupet me status të lartë dhe u mohohet grupeve me status të ulët.[21] Vlerësimi i një grupi në këto dy dimensione përcakton reagimin emocional ndaj atij grupi. Grupet e stereotipizuara si të përzemërt dhe kompetente (p.sh., anëtarët e grupit ose aleatët) shkaktojnë krenari dhe admirim. Grupet e stereotipizuara si të ngrohta, por të paafte (p.sh., të moshuarit) shkaktojnë keqardhje dhe simpati. Grupet e stereotipizuara si të ftohta, por kompetente (p.sh., hebrenjtë në rastin e paragjykimeve antisemitike) shkaktojnë zili dhe xhelozë. Grupet e stereotipizuara si të ftohtë dhe të paafte (p.sh., përfituesit, të korruptuarit e sistemit) shkaktojnë ndjenja zemërimi, inati dhe neverie. Kur grupet vlerësohen pozitivisht në një dimension, por negativisht në dimensionin tjetër, qëndrimi i përgjithshëm ndaj tyre është i paqartë (i dyzuar). Hebrenjtë, nëse shihen përmes lentës së paragjykimit si të ftohtë, por kompetentë (pa ngrohtësi, me kompetencë të lartë), nxisin stereotipa ziliqare.

Stereotipat, pavarësisht nga lloji, mund të çojnë në paragjykime.

Paragjykimi zakonisht kuptohet si një qëndrim me një komponent njohës, afektiv dhe konativ (për shembull, zotërimi i një besimi të caktuar për një grup të synuar, mospëlqimi i grupit dhe predispozita për t'u sjellë negativisht ndaj atij grupi).[22] Paragjykimi mund t'i shërbejë funksioneve psikologjike, të tilla si rritja e vetëvlerësimit,[23] por gjithashtu u shërben funksioneve sociale, të tilla si ruajtja e statusit dhe e dallimeve të roleve midis grupeve.[24] Stereotipat dhe paragjykimet janë dukuri intrapsikike – ato ndodhin brenda individit dhe ndryshojnë në nivelin e transparencës ndaj të tjerëve dhe në nivelin e ndërjegjësimit nga ana e individit që i mban ato. . Ato mund të jenë përgjigje eksplicite – besime dhe qëndrime që njerëzit e dinë se i kanë dhe i nënshtrohen kontrollit të qëllimshëm në shprehjen e tyre. Ato gjithashtu mund të jenë të nënkuptuara – aktivizohen automatikisht dhe pa i vërejtur perceptuesi[25].

[21] Fiske, S. T., Cuddy, A. J. C., Glick, P. & Xu, J., “A Model of (Often Mixed) Stereotype Content: Competence and Warmth Respectively Follow from Perceived Status and Competition”, *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 82, No. 6, 2002, pp. 878–902.

[22] Dovidio, J. F. et al., *The Sage Handbook of Prejudice, Stereotyping and Discrimination*, p. 5.

[23] Fein, S. & Spencer, S. J., “Prejudice as Self-Image Maintenance: Affirming the Self Through Derogating Others”, *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 73, No. 1, 1997, pp. 31-44.

[24] Eagly, A. H. & Diekmann, A. B., “What Is the Problem? Prejudice as an Attitude-in-Context”, in J. F. Dovidio, P. Glick & L. A. Rudman (Eds.), *On the Nature of Prejudice: Fifty Years after Allport* (Malden, Massachusetts & Oxford: Blackwell Publishers, 2005), pp. 19–35.

[25] Dovidio, J. F. et al., *The Sage Handbook of Prejudice, Stereotyping and Discrimination*.

Qoftë e qartë apo e nënkuptuar, mënyra se si paragjykimet dhe stereotipat ndikojnë në sjelljen tonë, sjell implikime për ne dhe shoqërinë në përgjithësi.

Veprimi i vetëdijshëm ose i pavetëdijshëm sipas preferencave (anësive) dhe paragjykimeve tona mund të çojë në diskriminim.

Diskriminimi mund të marrë formën e trajtimit të padrejtë ndaj grupeve të perceptuara si jashtë tyre ose trajtimit të favorshëm ndaj grupeve të perceptuara si pjesë e tyre. Për shembull, mund të ketë diskriminim në shpërndarjen e burimeve, duke u dhënë më shumë anëtarëve të grupit tënd dhe duke rritur ekzistencën e avantazhit social.[26] Njëanshmëria ndër grupe zakonisht kufizohet në favorizimin brenda grupit, përveç rasteve kur grupet e jashtme shoqërohen me emocione të forta. Emocione të forta si përbuzja ose zemërimi mund të ngjallen kur një grup tjetër perceptohet si kërcënues dhe këto emocione mund të shkaktojnë veprime armiqësore dhe dëme ndaj grupit[27].

Intoleranca nënkupton mungesë tolerance ndaj dallimeve në mendime apo praktikës ndryshe, veçanërisht në çështjet fetare; mohimi i së drejtës për të ndryshuar; kundërshtim mendjengushtë ose fanatik ndaj mospajtimit.[28] Intolerancë do të thotë gjithashtu mungesë respekti, mungesë pranimi dhe vlerësimi të diversitetit të kulturave të botës sonë ... mungesë të formave të shprehjes dhe mënyrave të të qenit njerëzor dhe mungesë njohjeje të të drejtave universale të njeriut dhe lirive themelore të tij.[29]

Intoleranca është e lidhur ngushtë me diskriminimin dhe mund të shfaqet [vetë] në forma të ndryshme, duke filluar nga niveli sistemik në atë individual, duke përfshirë "vërejtjet përçmuese dhe urrejtjen në diskursin publik, si dhe diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe sjelljen armiqësore, si p.sh. sulme fizike dhe agresion verbal".[30]

Hulumtimet sugjerojnë se ndërhyrjet e suksesshme për të adresuar paragjykimet duhet së pari të rrisin ndërgjegjësimin për problemin, siç është ndërgjegjësimi për lidhjet midis preferencave të papranuara të nënkuptuara ose preferencave të vetëdijshme, të qarta dhe sjelljeve diskriminuese. Më pas, ata duhet të motivojnë individët që të veprojnë për të ndryshuar.

[26] Banaji, M. R. & Greenwald, A. G., *Blind Spot: Hidden Biases of Good People* (New York: Bantam Books, 2016).

[27] Brewer, M. B., "A Dual-Process Model of Impression Formation", In T. K. Srull & R. S. Wyer (Eds.), *Advances in Social Cognition* (Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates Publishers, 1988), pp. 1-36; Mackie, D. M., Devos, T. & Smith, E. R., "Intergroup Emotions: Explaining Offensive Action Tendencies in an Intergroup Context", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 79, No. 4, 2000, pp. 602-616.

[28] "Intolerance", *Oxford English Dictionary Online*, Oxford University Press, 2019.

[29] Declaration of Principles on Tolerance", UNESCO website, <http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13175&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html>.

[1] ODIHR, UNESCO, & the Council of Europe, *Guidelines for Educators on Countering Intolerance and Discrimination against Muslims: Addressing Islamophobia through Education* (OSCE/ODIHR: Warsaw, 2011), p. 17.

Në rastin e paragjytimeve të qarta, ndërgjegjësimi mund t'i referohet një shqyrtimi se si anësitë e dikujt bien ndesh me normat shoqërore, çfarë efektesh shkaktajnë këto njëanshmëri te njerëzit e tjerë dhe se si veprimet e njëanshme mund të bien ndesh me rolin profesional dhe misionin e dikujt si mësues. Motivimi është një çështje komplekse dhe studimet kanë treguar se ndërhyrjet që theksojnë kërkesën shoqërore për të kontrolluar paragjykimet, i rriten, në vend që t'i pakësonin, ato.[31]

Autorët e një studimi të tillë shkruajnë:

Ne i këshillojmë mësuesit të largohen nga strategjitë kundër paragjytimeve, të jenë të vetëdijshëm për taktikat e kontrollit, të reduktojnë përdorimin e gjuhës së presionit dhe të përmbahen ndaj ushtrimit të presionit ndaj individëve për të arritur rezultate të përcaktuara rreptësisht. Në vend të kësaj, është e rëndësishme të inkurajohet vlerësimi personal i diversitetit dhe i barazisë. Kjo mund të bëhet duke ofruar arsyetime informuese, duke diskutuar rëndësinë dhe kënaqësinë e mos paragjytimeve dhe duke shqyrtuar përfitimet e klasave, grupeve e vendeve të ndryshme dhe të drejta të punës.

Festimi i drejtësisë, gjithëpërfshirjes dhe barazisë, ndërkohë që theksohet anëtarësimi i përbashkët në grup, ka të ngjarë, të jetë i rëndësishëm në zhvillimin e vullnetit dhe motivimit për të sfiduar paragjykimet. Gjithashtu duke qenë se rregullimi i stereotipave dhe paragjytimeve si të qarta, ashtu edhe të atyre të nënkuptuara, kërkon zbulimin e mospërputhjeve midis qëllimeve dhe veprimeve,[32] ka të ngjarë të jetë e dobishme t'u kërkohet mësuesve të artikulojnë vizionet e tyre dhe ndjenjën e misionit në karrierën e tyre profesionale.

Cilat janë vlerat që ata synojnë të zhvillojnë nëpërmjet punës së tyre? Çfarë dëshirojnë të përfaqësojnë ata si mësues?

Të mësuarit ka të bëjë me ndryshimin: ndryshime në njohuri/dije dhe ndryshime në mënyrën e të menduarit, pra mësimdhënia është ajo që sjell ndryshimin.

Kërkojuni mësuesve të identifikojnë ndryshimet që ata personalisht dëshirojnë të sjellin nëpërmjet punës së tyre, si dhe kërkojuni atyre të ndajnë dhe të krahasojnë vizionet e tyre për mësimdhënien me ato të kolegëve të tyre.

[31] Legault, L., Gutsell, J. & Inzlicht, M., "Ironie Effects of Antiprejudice Messages: How Motivational Interventions Can Reduce (but Also Increase) Prejudice"(research article), 28 November 2011, <<https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/0956797611427918>>.

[32] Burns, M. D., Parker, L. R. M. & Monteith, M. J., "Self-regulation Strategies for Combatting Prejudice", in C. G. Sibley & F.K. Barlow (Eds.), The Cambridge Handbook of the Psychology of Prejudice (Cambridge: Cambridge University Press, 2016).

Kjo ka të ngjarë të jetë e dobishme për të kuptuar dhe diskutuar këto aspekte (stereotipat dhe paragjykimet.)

Strategjitë që mund të përdoren si mjete për të pakësuar anësitë, stereotipat dhe paragjykimet përfshijnë sa vijon:

- **Imazhe kundër-stereotipive:** Përdorimi i paraqitjeve të grupeve që bien ndesh me supozimet stereotipike për këto grupe, duke i bërë ekzemplarë pozitivë të spikatur dhe të arritshëm;^[33]
- **Individualizimi:** Njohja e anëtarëve të grupeve stereotip si individë, duke u fokusuar kështu në atributet personale dhe jo të bazuara në grup, mund të dobësojë stereotipitë;^[34]
- **Ri kategorizimi:** Së bashku me individualizimin, ri kategorizimi i individëve në një kategori më gjithëpërfshirëse ose më të lartë rrit rëndësinë e një identiteti të përbashkët midis anëtarëve të grupeve të ndryshme dhe mund të çojë në gjykime dhe ndërveprime më të favorshme ndër grupe;^[35]
- **Pranimi i këndvështrimit të tjetrit:** Shqyrtimi i një situate, mendimeve, ndjenjave dhe përvojave nga këndvështrimi i një tjetri është sugjeruar nga një numër psikologësh socialë si një strategji efektive në reduktimin e paragjykimeve ndaj grupeve të stigmatizuara;^[36]
- **Rritja e mundësive për kontakt:** Rritja e mundësive për ndërveprim pozitiv me grupet e stereotipizuara mund të krijojë lidhje pozitive për të shkatërruar stereotipitë negative;^[37]

[33] Blair, I. V. & Banaji, M. R., "Automatic and Controlled Processes in Stereotype Priming", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 70, No. 6, 1996, pp. 1142–1163; Blair, I. V., Ma, J. E. & Lenton, A. P., "Imagining Stereotypes Away: The Moderation of Implicit Stereotypes Through Mental Imagery", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 81, No. 5, 2001, pp. 828–841; Carnes, M., Devine, P. G., Baier Manwell, L., Byars-Winston, A., Fine, E., Ford C. E. & Sheridan, J., "The Effect of an Intervention to Break the Gender Bias Habit for Faculty at One Institution: A Cluster Randomised, Controlled Trial", *Academic Medicine*, Vol. 90, No. 2, 2015, pp. 221–230; Devine, P. G., Forscher, P. S., Austin, A. J. & Cox, W. T. L., "Long-Term Reduction in Implicit Race Bias: A Prejudice Habit-Breaking Intervention", *Journal of Experimental Social Psychology*, Vol. 48, No. 6, 2012, pp. 1267–1278; Devine, P. G. & Sharp, L. B., "Automaticity and Control in Stereotyping and Prejudice", in T. D. Nelson (Ed.), *Handbook of Prejudice, Stereotyping, and Discrimination* (London: Routledge, 2009), pp. 61–88; Lai, C. K., Marini, M., Lehr, S. A., Cerruti, C., Shin, J.-E. L., Joy-Gaba, J. A. & Nosek, B., "Reducing Implicit Racial Preferences: A Comparative Investigation of 17 Interventions", *Journal of Experimental Psychology*, Vol. 143, No. 4, 2014, pp. 1765–1785.

[34] Carnes et al., "The Effect of an Intervention to Break the Gender Bias Habit for Faculty at One Institution"; Devine et al., "Long-Term Reduction in Implicit Race Bias". See also: Brewer, M. B., "A Dual-Process Model of Impression Formation"; Fiske, S. T., "Stereotyping, Prejudice and Discrimination", in D. T. Gilbert, S. T. Fiske & G. Lindzey (Eds.), *The Handbook of Social Psychology* (Vol. 2) (New York: McGraw-Hill, 1998), pp. 357–411; Fiske, S. T. & Neuberg, S. L., "A Continuum of Impression Formation, from Category-Based to Individuating Processes: Influences of Information and Motivation on Attention and Interpretation", in M. P. Zanna (Ed.), *Advances in Experimental Social Psychology* (Vol. 23) (San Diego, CA: Academic Press, 1990), pp. 1–74.

[35] Gaertner, S. L. & Dovidio, J. F., *Reducing Intergroup Bias: The Common Ingroup Identity Model* (New York: Psychology Press, 2000).

[36] Devine et al., "Long-Term Reduction in Implicit Race Bias"; Burgess, D., van Ryn, M., Dovidio, J. & Somnath, S., "Reducing Racial Bias Among Health Care Providers: Lessons from Social-Cognitive Psychology", *Journal of General Internal Medicine*, Vol. 22, No. 6, 2007, pp. 882–887; Carnes et al., "The Effect of an Intervention to Break the Gender Bias Habit for Faculty at One Institution"; Galinsky, A. D. & Moskowitz, G. B., "Perspective-Taking: Decreasing Stereotype Expression, Stereotype Accessibility, and In-Group Favoritism", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 7, No. 4, 2000, pp. 708–724.

[37] Boscardin, C., "Reducing Implicit Bias Through Curricular Interventions", *Journal of General Internal Medicine*, Vol. 30, No. 12, 2015, pp. 1726–1728; Burgess et al., "Reducing Racial Bias Among Health Care Providers: Lessons from Social-Cognitive Psychology".

- **Promovimi i krijimtarisë:** Përgatitja e individëve me mendësi krijuese tregon se redukton aktivizimin automatik të stereotipive duke inkurajuar alternativa ndaj mendimeve ndryshe dhe lidhjeve konvencionale dhe tipike [38].

Janë krijuar materiale të vlefshme për të ndihmuar nxënësit ose të rriturit për t'u ndërgjegjësuar në lidhje me anësitë, paragjykimet dhe stereotipitë e tyre. Materialet e prezantuara më poshtë janë shumë efektive për të ndihmuar mësuesit të zhvillojnë njohuritë e tyre pedagogjike dhe përmbajtjesore. Këto materiale janë të përshtatshme si për trajnimin e mësuesve ashtu dhe për t'u përdorur nga vetë mësuesit si modele në klasë.

- **Shtëpia e Anne Frank**

(<<https://www.annefrank.org/en/Education/product/33/stories-that-move-english>>)

"Tregimet që lëvizin"[39] ofron përvoja të të mësuarit ndërveprues duke u mundësuar nxënësve të reflektojnë mbi supozimet dhe anësitë, si dhe për veten ashtu dhe për të tjerët. Ai është një mjet online falas, i disponueshëm në shtatë gjuhë, i bazuar në historitë dhe përvojat reale të të rinjve. Ai është një mjedis i sigurt mësimi në internet me fokus diversitetin, gjithëpërfshirjen dhe llojet e ndryshme të diskriminimit. Ai përmban pyetje të dedikuara çështjeve të tilla si: racizmi, antisemitizmi, diskriminimi ndaj romëve dhe sintit, myslimanëve dhe LGBT-së.

- **Përballja me historinë dhe vetveten [40]**

me titull "Konfirmimi dhe anësi të tjera" (<<https://www.facinghistory.org/resource-library/facing-ferguson-news-literacy-digital-age/confirmation-and-other-biases>>) është një platformë e cila ofron plane dhe materiale mësimore digjitale të fokusuara ndaj anësive dhe paragjykimeve (përfshin përdorimin e problemeve matematikore që nxjerrin në pah paragjykimet dhe iluzionet "Biznesi i majmunëve",[41] i cili vë në plan të parë rolin e përgatitjes dhe supozimit në formësimin e perceptimit). Ky është një eksperiment i psikologjisë sociale, ku njerëzve iu shfaq një videoklip me basketbollistë dhe u kërkohet të numëronin sa herë e kalonin topin. Të fokusuar në top, gjysma e shikuesve nuk e vënë re kur dikush i veshur me një kostum gorilla hyri në skenë për disa momente. Eksperimenti është përsëritur në mjediset e trajnimit me rezultate kryesisht të ngjashme. Nëpërmjet kësaj nxënësit përcaktojnë paragjykimet e shprehura qartë dhe ato të nënkuptuara dhe shqyrtojnë pse njerëzit ndonjëherë ruajnë bindjet e tyre përballë informacioneve kontraktore. (Simons, D., "Por a e patë Gorillan? Problemi me verbërinë e pavëmendshme", revista *Smithsonian*, shtator 2012).

[38] Sassenberg, K. & Moskowitz, G. B., "Don't Stereotype, Think Different! Overcoming Automatic Stereotypes Activation by Mindset Priming", *Journal of Experimental Social Psychology*, Vol. 41, No. 5, 2005, pp. 506–514.

[39] The Anne Frank House's "Stories that Move" (<<https://www.annefrank.org/en/education/product/33/stories-that-move-english>>)

[40] The Facing History and Ourselves lesson plan and materials "Confirmation and Other Biases" (<<https://www.facinghistory.org/resource-library/facing-ferguson-news-literacy-digital-age/confirmation-and-other-biases>>)

[41] This was a social psychology experiment, where people were shown a video clip with basketball players and asked to count how many times they passed the ball. Focused on the ball, half of the viewers did not notice when someone dressed in a gorilla suit entered the scene for a few moments. The experiment has been repeated in training settings with largely similar results. Simons, D., "But Did You See the Gorilla? The Problem with Inattentional Blindness", *Smithsonian Magazine*, September 2012, <<https://www.smithsonianmag.com/science-nature/but-did-you-see-the-gorilla-the-problem-with-inattentional-blindness-17339778/>>.

Materiale të tjera të dobishme janë:

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USA):

- Shërbimi i Transmetimit Publik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Klasifikimi i racave njerëzore”^[42]
(https://www.pbs.org/race/002_SortingPeople/002_00-home.htm).
- “Iniciativa për mësimdhënien e nxënësve të ndryshëm”^[43]
(<https://www.tolerance.org/>), e cila përfshin një sërë burimesh për të ndihmuar në krijimin e një përvoje takimi dhe kështu mundëson sfidimin e stereotipive.
- Shoqata Amerikane Antropologjike^[44] (AAA) ka zhvilluar një faqe interneti interaktive të emërtuar “RACA: A jemi ne kaq të ndryshëm?”
(<http://www.understandingrace.org/>), i cili përmban materiale që mund të ndihmojnë kundër stereotipive dhe keqkuptimeve rreth racës, përkatësisë etnike dhe variacionit njerëzor.

Në Holandë dhe në Belgjikë:

- Studio Globo (<https://www.studioglobo.be/>), në Belgjikë^[45], dhe Stichting School & Veiligheid^[46] (School and Safety Foundation, <https://www.schoolenveiligheid.nl/>), në Holandë, eksplorojnë natyrën e paragjytimeve dhe mënyrën se si formohen ato.

Në Republikën Çeke:

- Projekti “Paměť národa” / “Kujtesa e Kombeve”^[47]
(<http://territoryterror.org.ua/en/projects/international-projects/nation-memory/>), ku përdorimi i dëshmisë gojore është parë si një metodë e dobishme në inkurajimin e nxënësve të rinj që të pranojnë diversitetin në komunitetet dhe historinë e tyre.

Në Francë:

- Musée d'Art et d'Histoire du Judaïsme^[48] (<https://www.mahj.org/>) thekson kulturën dhe historinë e komuniteteve hebreje.

[42] United States' Public Broadcasting Service's "Sorting People" resource (https://www.pbs.org/race/002_SortingPeople/002_00-home.htm)

[43] "Teaching Diverse Students Initiative" (<https://www.tolerance.org/>)

[44] The American Anthropological Association (AAA) has developed an interactive website linked to its "RACE: Are We So Different?" project (<http://www.understandingrace.org/>)


[45] Studio Globo (<https://www.studioglobo.be/>), in Belgium

[46] Stichting School & Veiligheid (School and Safety Foundation, <https://www.schoolenveiligheid.nl/>),

[47] The "Paměť národa" / "Memory of Nations" project <http://territoryterror.org.ua/en/projects/international-projects/nation-memory/>, in the Czech Republic

[48] Musée d'Art et d'Histoire du Judaïsme (<https://www.mahj.org/>) in France.

3.2. Tema 2.



Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e mia si mësues për të trajtuar antisemitizmin, anësitë dhe paragjykimin?

Pyetje për temën

- Cilat janë detyrat, detyrimet dhe përgjegjësitë e mia?
- Çfarë ndryshimi mund të bëj?
- Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat personale dhe profesionale të mësuesve në lidhje me këto çështje?
- Çfarë implikimesh kanë të drejtat e njeriut dhe edukimi për qytetarinë globale [49] për praktikën time më të gjerë si mësuese?

Rezultatet e të nxënit

RN 3: Mësuesit identifikojnë dhe shpjegojnë përgjegjësitë e tyre profesionale dhe implikimet e të drejtave të njeriut në rolin e tyre si profesionistë.

RN2: Mësuesit shpjegojnë se çfarë do të thotë të japësh mësim në mënyrë që të ushqejnë te nxënësit qytetarinë globale dhe edukimin për të drejtat e njeriut.

Praktikat e mësuesve janë, natyrisht, të lidhura me identitetet personale të tyre. Megjithatë, megjithëse mësuesit janë njerëz me individualitet personal, të jesh mësues do të thotë të përvetësosh një personalitet publik dhe një rol të përcaktuar shoqëror. Ky rol lidhet me pritshmërinë për vlerat dhe normat që mësuesit pritët të mishërojnë, të përkrahin, të zbatojnë dhe të praktikojnë në klasë. Shumë nga këto pritshmëri janë pjesë e kornizës ligjore dhe parakushte për mbajtjen e roleve të mësimdhënies. Mësuesit gjatë trajnimit duhet të identifikojnë dhe të reflektojnë mbi vlerat dhe normat që duhet të zotërojnë ata, si dhe për pritshmërinë që nxënësit, prindërit, punëdhënësit kanë për mësuesit në lidhje me këto norma.

Mësuesit gjatë trajnimit:

a) do të listojnë ose do të hartojnë dimensionet e ndryshme të pritshmërisë që aktorë të ndryshëm në arsim kanë për ta, si p.sh., nxënësit, prindërit, drejtuesi i shkollës;

b) do të reflektojnë se sa të aftë janë për t'i adresuar këto pritshmëri të shumëfishta. Cilat pritshmëri në lidhje me rolin e tyre përmbushen lehtësisht dhe cilat prej tyre janë sfida aktuale që mund të kenë nevojë për ndihmë?

Pritshmëritë e drejtojnë vëmendjen drejt përgjegjësiave dhe detyrave.

[49] Qytetaria globale i referohet ndjenjës së përkatësisë ndaj një komuniteti më të gjerë dhe njerëzimit të përbashkët. Ai thekson ndërvarësinë politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe ndërlidhjen ndërmjet lokale, kombëtares dhe globale. UNESCO, Global Citizenship Education: Topics and Learning Objectives, 2015, p. 14.

Megjithatë, ato gjithashtu tërheqin vëmendjen edhe në kapacitetin që kanë mësuesit për të vepruar e për të formësuar përvojat e të rinjve në mjediset në të cilat ata mësojnë. Përgjegjësitë që kanë mësuesit ndryshojnë sipas kontekstit, ndaj mësuesit duhet të ndërgjegjësohen, të reflektojnë dhe të eksplorojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas ligjeve në fuqi. Një mjet i fuqishëm për të menduar për përgjegjësitë e mësuesve dhe ndryshimin që mësuesit mund të bëjnë, është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e cila është e përfshirë në të drejtën ndërkombëtare [50]. Gjatë shqyrtimit të këtij dokumenti, mësuesit duhet të marrin kohë për të konsideruar sesi nenet e ndryshme të Konventës lidhen dhe zbatohen në punën e tyre të përditshme.

Një ushtrim i dobishëm që duhet të plotësojnë mësuesit është: (a) të shikojnë nenet e Konventës, në mënyrë që të identifikojnë ato që kanë rëndësinë më të madhe për arsimin (për shembull, neni 28 - E drejta për arsim; neni 14 - Liria e mendimit, besimit dhe fesë dhe neni 17 – Qasja në informacione nga media) dhe më pas (b) të marrin në konsideratë aftësitë që ata kanë si mësues për të ndihmuar fëmijët të ushtrojnë këto të drejta. Cilat lloje praktikash në klasë kanë më shumë gjasa të sigurojnë që fëmijët të ushtrojnë këto të drejta dhe çfarë mund të bëjnë mësuesit për të përmirësuar praktikën e tyre për këtë qëllim?

Konventa tërheq vëmendjen për detyrën që mësuesi ka për të siguruar që të gjithë fëmijët pa u diskriminuar, të kenë akses të barabartë në të drejtat e tyre, duke theksuar rëndësinë që mësuesit të jenë të vetëdijshëm për veçoritë strukturore të klasës. Mësuesit, gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm se anshmëritë dhe supozimet që mund të kenë për nxënësit, nëse nuk kontrollohen, çojnë në trajtim të ndryshëm dhe të pabarabartë.

Ekzistojnë shumë burime të vlefshme për të edukuar mësuesit për të drejtat e njeriut dhe për lidhjen midis të drejtave dhe historive të diskriminimit, për shembull, nëpërmjet botimit “Teachers and Human Rights Education[51]” mund të eksploroni lidhjet midis sulmit nazist ndaj të drejtave të hebrenjve evropianë në vitet 1930 dhe 1940 dhe ekzistencës, formës dhe përmbajtjes së Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948.[52]

Një numër i madh organizatash dhe burimesh të hartuara prej tyre fokusohen në zhvillimin e strategjive të mësimdhënies për të edukuar fëmijët për të drejtat e tyre duke u mundësuar atyre të ushtrojnë të drejtat e tyre, të tilla si:

[50] A useful summary from UNICEF is available at <http://www.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2010/05/UNCRC_summary-1.pdf>.

[51] Mësuesit dhe arsimi për të drejtat humane

[52] Osler, A. & Starkey, H., Teachers and Human Rights Education (Stoke on Trent: Trentham Books, 2010), pp. 54-55.

- Anti-Defamation League's [53] (ADL) është një ndër organizatat kryesore që vepron kundër urrejtjes në botë. E themeluar në vitin 1913, misioni i saj i përjetshëm është “të ndalojë shpifjen ndaj popullit hebre dhe të sigurojë drejtësi dhe trajtim të drejtë për të gjithë”. ADL vazhdon të luftojë të gjitha format e antisemitizmit dhe të paragjyqimeve. Si një lider global në luftën kundër antisemitizmit dhe kundër ekstremizmit kudo dhe kurdo që ndodh, ADL punon për të mbrojtur demokracinë dhe për të siguruar një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë. ADL ofron edukim kundër paragjyqimeve përmes mësimit profesional, programeve arsimore, burimeve dhe strategjive për të ndërtuar dhe për të mbështetur mjedise të barabarta dhe gjithëpërfshirëse. Materialet e trajnimit të prodhuara nga Anti-Defamation League's (ADL) synojnë të pajisin mësuesit me aftësitë e nevojshme për të edukuar nxënësit kundër paragjyqimeve dhe për të promovuar respektin, gjithëpërfshirjen dhe qytetarinë. Këto materiale [54] ofrojnë mësim ndërvepruese duke eksploruar zbatimin e ideve që lidhen me barazinë dhe respektin në shkollë e jashtë saj.
- Manuali i Këshillit të Evropës për Edukimin për të Drejtat e Njeriut ofron materiale udhëzuese dhe materiale pedagogjike shumë të dobishme për të eksploruar të drejtat e njeriut me të rinjtë në mënyra interaktive [55], duke përfshirë aktivitete dhe plane të shumta mësimore [56] që inkurajojnë dhe fuqizojnë të rinjtë të ushtrojnë të drejtat e tyre.
- Avokati i Popullit (Ombudsman) i Irlandës për të Drejtat e Fëmijëve ofron materiale për të ndihmuar mësuesit të planifikojnë dhe të realizojnë me nxënësit edukimin e fokusuar në të drejtat e njeriut. Materialet burimore “T'i bëjmë të drejtat reale” synojnë t'i mësojnë fëmijët dhe të rinjtë rreth të drejtave të tyre, si dhe fokusohen në mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve për të zbatuar dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.
- Kombet e Bashkuara publikojnë një botim të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut [57], të ilustruar dhe miqësor për fëmijët, i cili mund të përdoret nga mësuesit, për të edukuar nxënësit për të drejtat e tyre.

[53] The Anti-Defamation League's Education | ADL www.adl.org/about/education


[54] www.adl.org/resources/lessons-plans/searchResources Search | ADL

[55] (<<https://www.coe.int/en/web/compass/chapter-2>>)

[56] www.coe.int/en/web/compass/chapter-3

[57] (<<https://www.un.org/en/udhrbook/index.shtml>>)

3.3. Tema 3.



Në çfarë kontekstesh më të gjera jam pozicionuar dhe si ndikojnë ato tek nxënësit e mi?

Pyetje për temën

- Cili është konteksti social - ekonomik i shkollës sime?
- Si është historia lokale dhe kombëtare dhe si i formuloj këto çështje në kontekstin tim?

Rezultatet e të nxënit

RN 3: Mësuesit identifikojnë dhe reflektojnë mbi kontekstet e tyre institucionale, lokale dhe më gjerë. Ata janë në gjendje të shpjegojnë se si këto mundësi arsimore lidhen me edukimin rreth antisemitizmit dhe paragjykimeve.

RN2: Mësuesit njohin dhe zbatojnë kurrikulën kombëtare.

Arsimi është një përpjekje sociale, kulturore dhe politike e vendosur brenda një sërë kontekstesh të ndryshme. Këto kontekste ushtrojnë shkallë të ndryshme ndikimi mbi praktikën e mësimdhënies dhe proceset e të nxënit. Ndonjëherë ky ndikim është i dukshëm dhe i njohur nga të gjithë. Në raste të tjera, është më delikat dhe më pak i njohur nga qarqet e jashtme të ekspertëve. Disa kontekste janë të gjera, duke ndikuar në veprimtarinë arsimore në nivel kombëtar apo edhe ndërkombëtar. Kontekste të tjera mund të jenë më të veçanta, më specifike dhe më të rëndësishme për zona, rajone ose zona të caktuara. Thënë kështu, sa më të vetëdijshëm të jenë mësuesit për kontekstet e tyre shumë më të gjera, aq më mirë do të jenë të pozicionuar për të njohur, për të kuptuar dhe për të adresuar antisemitizmin, anësinë, paragjykimet dhe intolerancën në dhe përmes arsimit.

Mësuesit duhet të marrin në konsideratë sfidat dhe mundësitë që janë të pranishme në komunitetet e tyre lokale, stafin e tyre, nxënësit e shkollës së tyre, si dhe kurrikulën shkollore në lidhje me mundësinë që antisemitizmi të sfidohet dhe të adresohet. Për këtë qëllim, mësuesit duhet të dinë se kontekstet u përkasin dy kategorive: kontekstit të brendshëm të shkollës dhe kontekstit jashtë shkollës.

Meqenëse shkollat priren të organizojnë kurrikulën e tyre në ekipe lëndore, mësuesit duhet të zhvillojnë një vetëdije të informuar se si lidhet formimi i tyre lëndor me fushat e tjera të kurrikulës.

Kjo do të thotë të zhvillojnë një vlerësim se ku, kur dhe si lëndët e tyre përputhen me lëndët e tjera në arsimin e një nxënësi, në mënyrë që ata të kontribuojnë nëpërmjet planifikimit vjetor për të pasur një kurrikul shkollore shumëdimensionale për nxënësit. Për të kundërshtuar çdo pikë qorre të mundshme rreth asaj se si mësimdhënia e një mësuesi specifik lidhet me edukimin holistik të nxënësve të tyre, mësuesit duhet të njohin kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, si dhe të zotërojnë programet kombëtare sipas lëndëve përkatëse. Në nivelin e trajnimit, ata duhet të kuptojnë se çfarë është kurrikula si koncept dhe si realitet dhe si ndërtohet kurrikula shkollore. Një kuptim i tillë është integral për një mësues, për të vlerësuar përvojën arsimore që nxënësit ndërmarrin në shkollë dhe të kuptojnë rolin dhe vendin e tyre në këtë përvojë.


Mësuesit duhet të njohin dhe të zbatojnë mënyrat në të cilat shkollat formulojnë dhe zbatojnë politikat e sjelljes. Ata duhet të zotërojnë njohuri mbi mënyrën se si shkolla u qaset çështjeve të sjelljes dhe të disiplinës. Në bashkëpunim me kolegët e tyre, ata përmes shembujve nga jeta reale, mund të edukojnë nxënësit për çështje të tilla si: të antisemitizmit, anësitë, paragjykimet dhe intoleranca. Njëfarë kuptimi për këto çështje mund të krijohet gjithashtu nëpërmjet diskutimeve të bazuara në skenarë, duke përdorur materiale të tilla si ato që gjenden në kapitullin 4, të këtij udhëzuesi.

Si institucione me rëndësi vendimtare shoqërore, shkollat domosdoshmërisht përshkojnë një sërë kontekstesh të jashtme. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se konteksti i jashtëm më domethënës është familja. Njohja e prejardhjes dhe e rrethanave personale të nxënësve është parësore dhe shumë e rëndësishme kur planifikohet edukimi i nxënësve rreth antisemitizmit, anësive, paragjykimeve dhe intolerancës. I lidhur ngushtë me rrethanat personale të nxënësve është formimi i tyre arsimor. Që mësuesit të hartojnë plane që bazohen në mënyrë kuptimplote mbi njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat, është thelbësore që ata të njohin njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet ekzistuese të nxënësve të tyre, të dinë se çfarë kanë mësuar nxënësit e tyre më parë rreth antisemitizmit, paragjykimeve dhe intolerancës, dhe ku dhe kur ekziston mundësia për të trajtuar këto çështje brenda shkollës dhe arsimit në përgjithësi.

Duke qenë se shkolla është një mjedis social dhe kulturor, një kontekst i tretë i jashtëm që mësuesit duhet të njohin është dhe familjarizimi i mësuesit me komunitetin lokal.

Trajnuesit e mësuesve mund t'u nënvizojnë atyre mënyrat në të cilat institucionet sociale, kulturore dhe ekonomike pranë shkollës mund të ofrojnë mundësi për të mbështetur ekspertizën ose për të krijuar mundësi mësimi që zgjerojnë dhe zhvillojnë bazën e njohurive dhe të aftësive të nxënësve.

3.4. Tema 4.



Cilat janë format, funksionet dhe pasojat e antisemitizmit?

Pyetje për temën

- Cilat janë mënyrat stereotip në të cilat është përfaqësuar populli hebre?
- Cilat janë forma e antisemitizmit?
- Si e njohim/identifikojmë antisemitizmin?
- Cilat janë rrënjët e antisemitizmit?
- Cilat janë funksionet e antisemitizmit?
- Cilat janë pasojat e antisemitizmit?
- Çfarë ndikimi ka antisemitizmi në shoqëri?
- Pse antisemitizmi është çështje e të drejtave të njeriut?

Rezultatet e të nxënit

RN 7: Mësuesit, kur është e nevojshme, identifikojnë dhe shpjegojnë mitet dhe narrativët antisemitike.

RN 8: Mësuesit identifikojnë dhe shpjegojnë forma të ndryshme të antisemitizmit, për shembull, antisemitizmin bazuar në interpretimet e besimeve fetare (p.sh., i krishterë, mysliman), antisemitizmin racist, antisemitizmin dytësor (politik dhe eliminues),^[58] dhe mohimin e Holokaustit.

RN 9: Mësuesit identifikojnë dhe shpjegojnë disa nga shkaqet e antisemitizmit dhe disa nga funksionet për të cilat është përdorur antisemitizmi.

RN 10: Mësuesit, identifikojnë dhe reflektojnë mbi mënyrat në të cilat prania e antisemitizmit ndikon në të drejtat e njeriut dhe të popullit hebre, direkt dhe indirekt.

Cilat janë format e antisemitizmit që ekzistojnë?

Edhe pse ka pasur periudha kur ka munguar, urrejtja dhe armiqësia ndaj hebrenjve ka ekzistuar për mijëvjeçarë. Ajo ka kaluar ngritjen dhe rënien e perandorive, formimin dhe shpërbërjen e shteteve, revolucionet në mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe drejtojnë jetën e tyre. Gjatë shekujve, mospëlqimi, mosbesimi dhe diskriminimi i drejtpërdrejtë ndaj hebrenjve është përshtatur me këto kontekste dhe rrethana në ndryshim, që do të thotë se ajo që ne e quajmë antisemitizëm ka marrë dhe vazhdon të marrë forma të ndryshme.

[58] Antisemitizmi dytësor i referohet disa shprehjeve antisemite që u shfaqën pas Luftës së Dytë Botërore. Një shembull është ideja se hebrenjtë do të shfrytëzonin ndjenjat e fajit të gjermanëve dhe austriakëve për Holokaustin. Në kontekstin ku antisemitizmi i hapur nuk ishte më i pranueshëm, kemi antisemitizmin dytësor që shpjegohet gjithashtu si një formë e shprehjes së antisemitizmit në mënyrë indirekte.

Antisemitizmi mund të shprehet si *intolerancë fetare* kur urrejtja dhe armiqësia ndaj hebrenjve racionalizohet në idetë ose besimet që janë thelbësore për një besim të caktuar.[59] Këtu, në diskutim janë kodet dhe bindjet që qëndrojnë në zemër të judaizmit, për të cilin disa adhurues me ndikim të feve më të reja që ndërtohen mbi judaizmin shpesh mendonin se "ishte zëvendësuar" dhe "duhet të hidhet poshtë si një relike e një epoke të mëparshme".[60]

Antisemitizmi mund të artikulohet edhe në *terma raciale dhe/ose pseudo-shkencorë*. Me rritjen e teorisë së racës në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, një element racor u fut në diskursin anti-hebre. Teoria e racës zakonisht e ndan njerëzimin gabimisht në raca të ndryshme dhe i atribuon cilësi dhe karakteristika të veçanta çdo race. Hebrenjtë shihen të dallohen dhe përcaktohen nga gjenealogjia e tyre biologjike.[61]

Artikulimet *politike* të antisemitizmit përfshijnë *antisemitizmin "shpëtimtar"*- idenë se "kombi" ose një ent tjetër politik mund të restaurohet dhe të rinovohet duke hequr hebrenjtë dhe ndikimet hebraike që pretendohet se e prekin atë.[62]

Antisemitizmi i ri ose bashkëkohor përfshin manifestime të antisemitizmit në kontekstin e diskutimeve në lidhje me situatën në Lindjen e Mesme, për shembull, duke i quajtur të gjithë hebrenjtë kolektivisht përgjegjës për konfliktin izraelito-palestinez ose duke argumentuar se Izraeli nuk ka të drejtë të ekzistojë.[63]

Forma të tjera të antisemitizmit që u shfaqën pas Holokaustit përfshijnë *mohimin ose shtrembërimin e Holokaustit*. [64]

Mohimi i Holokaustit është në thelb një përpjekje për të fshirë realitetin historik të krimeve të kryera dhe për t'i dhënë legjitimitet nazizmit, ndërkohë që kërkon të demonstrojë se hebrenjtë shpikën ose e ekzagjeruan Holokaustin për të përfituar përfitime politike ose ekonomike.

Shtrembërimi i Holokaustit është më i zakonshëm se mohimi i drejtpërdrejtë dhe synon qëllimisht të justifikojë, minimizojë ose keqinterpretojë të dhënat e njohura historike të Holokaustit.[65]

[59] Hayes, P., Why? Explaining the Holocaust, pp. 6-13; Bauer, Y., The Jews: A Contrary People, pp. 121-146; Schroeter, D. J., "Islamic Anti-Semitism" in Historical Discourse", The American Historical Review, Vol. 123, No. 4, 2018, pp. 1172-1189.

[60] Hayes, P., Why? Explaining the Holocaust, p. 6.

[61] Gay, P., The Cultivation of Hatred: The Bourgeois Experience: Victoria to Freud (London: Fontana, 1993); Hayes, P. Why? Explaining the Holocaust, pp. 15-20.

[62] Friedländer, S., Nazi Germany and the Jews: The Years of Persecution, 1933-1939 (Vol. 1) (New York: Harper Collins, 1997).

[63] Bauer, Y., The Jews: A Contrary People.

[64] Lipstadt, D., Denying the Holocaust: The Growing Assault on Truth and Memory (London: Penguin Books, 1993). For more information, see ODIHR & UNESCO, Addressing Anti-Semitism through Education, pp. 22-25.

[65] Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit (The International Holocaust Remembrance Alliance (IHRA) bashkon qeveritë dhe ekspertët për të forcuar, avancuar dhe promovuar edukimin, kërkimin dhe kujtimin e Holokaustit dhe për të mbështetur angazhimet ndaj Deklaratës së Stokholmit të vitit 2000. IHRA - Task Force për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Edukimin, Kujtimin dhe Kërkimin e Holokaustit, u iniciua në vitin 1998 nga ish-kryeministri suedez Göran Persson. Sot anëtarësimi i IHRA përbëhet nga 35 vende anëtare, secila prej të cilave pranon se koordinimi politik ndërkombëtar është imperativ për të forcuar angazhimin moral të shoqërive dhe për të luftuar mohimin në rritje të Holokaustit dhe antisemitizmit. Rrjeti i ekspertëve të besuar të IHRA ndajnë njohuritë e tyre mbi shenjat e hershme paralajmëruese të gjenocidit të sotëm dhe edukimin mbi Holokaustin. Kjo njohuri mbështet politikëbërësit dhe shumëfishuesit arsimorë në përpjekjet e tyre për të zhvilluar kurrikula efektive dhe informon zyrtarët qeveritarë dhe OJQ-të aktive në nismat globale për parandalimin e gjenocidit. IHRA nxori një Përkufizim të Mohimit dhe Shtrembërimit të Holokaustit në vitin 2013, i cili identifikoi pesë mënyra në të cilat manifestohet shtrembërimi i Holokaustit: minimizimi bruto i numrit të viktimave; përpjekjet për të fajësuar hebrenjtë për Holokaustin; duke përdorur termin për të përshkruar mizoritë e lidhura ose duke u përfshirë në krahasime të rreme me krime të tjera masive; përcaktimi i Holokaustit si një ngjarje historike pozitive; dhe mjegullimi i përgjegjësisë për vrasjet e Holokaustit.

Antisemitizmi mund të manifestohet në mënyra të ndryshme, duke filluar nga retorika politike deri te abuzimi dhe diskriminimi në sport.[66] Pikëpamjet antisemite janë shprehur në pjesë të botës ku nuk ka komunitet hebre dhe janë bërë gjithnjë e më shumë nëpërmjet rrjeteve sociale, pjesë e diskurseve globale.[67]

Ndërsa të gjitha këto ide dhe besime janë irracionale, kjo nuk e zvogëlon fuqinë e tyre ose nuk i bën ato më pak të dëmshme. Pavarësisht nga forma e veçantë që merr antisemitizmi, të menduarit pas tij mbështetet në një sërë supozimesh rreth popullit hebre të perceptuar si një masë kolektive, homogjene, me ndikim negativ në jetën e përditshme. Antisemitizmi u atribuon atyre shkallë të pabazuara fuqie dhe ndikimi dhe u cakton qëllime mashtruese, mendimeve dhe veprave të tyre dhe vetë ekzistencës së tyre.

Antisemitizmi është një sulm ndaj identiteteve dhe interesave të popullit hebre dhe shpesh merr forma fizikisht shkatërruese dhe ndonjëherë edhe vrasare.

Të kuptuarit e ideve dhe të besimeve që qëndrojnë në themel të formave të ndryshme të antisemitizmit është i dobishëm për formulimin e përgjigjeve efektive. Është thelbësore që mësuesit të kuptojnë mënyrën se si idetë antisemite mund dhe shfaqen në forma të ndryshme. Për ta bërë këtë, ata së pari duhet të fitojnë njohuri dhe të kuptojnë mënyrat në të cilat populli hebre është stereotipizuar gjatë historisë dhe se si kjo ushqehet në mitet për hebrenjtë që vazhdojnë ende sot.

Për këto qëllime, mësuesit duhet të njihen dhe/ose të jenë të ndjeshëm ndaj miteve dhe keqkuptimeve që janë të zakonshme brenda formave të ndryshme të antisemitizmit. Këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, sa vijon:

- *Shaka për hebrenjtë që riciklojnë mitet e vjetra të koprracisë.*
- *Argumentet se hebrenjtë ishin/janë përgjegjës për vrasjen e Krishtit.*
- *Teoritë e konspiracionit që i modelojnë "hebrenjtë" si një grup të fuqishëm, pothuajse të gjithë-pranishëm, të cilët kanë në kontroll ekonominë botërore, marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën e brendshme dhe median.*
- *Akuzat për pabesi dhe nënshtrim që janë përdorur për të hequr të drejtat, liritë, shtetësinë ose për të lejuar ligjërisht akte diskriminimi ose persekutimi.*
- *Përpyekjet për t'i mohuar popullit hebre të drejtën e tij për vetëvendosje dhe për të vënë në pikëpyetje të drejtën e Izraelit për të ekzistuar.*
- *Trajtimi i hebrenjve në mbarë botën, kolektivisht ose si individë, përgjegjës për veprimet e shtetit të Izraelit.*
- *Mohimi dhe shtrembërimi i Holokaustit apo argumentet se "hebrenjtë" e meritonin atë.*

[66] Clavane, A., "We Thought Antisemitism in Football Was Long Gone. How Wrong We Were", The Guardian, 5 December 2016, <<https://www.theguardian.com/commentisfree/2016/dec/05/antisemitism-football-antisemitic-incidents-abuse>>.

[67] Sternberg, E., "The Origin of Globalized Anti-Zionism: A Conjunction of Hatreds Since the Cold War", Israel Affairs, Vol. 21, No. 4, 2015, pp. 585–601; World Jewish Congress, "Anti-Semitic Symbols and Holocaust Denial in Social Media Posts", World Jewish Congress website, January 2018, <http://www.worldjewishcongress.org/download/3KVjYgi8FN0TxdWd5HeFPw?utm_source=PRESS&utm_campaign=3d806f4ab8-EMAIL_CAMPAIGN_2018_02_08&utm_medium=email&utm_term=0_c3b21e69b1-3d806f4ab8-utm_source=WJC+Mailing+Lists&utm_campaign=78bfed156d-EMAIL_CAMPAIGN_2018_02_08&utm_medium=email&utm_term=0_04292c525e-78bfed156d-318920277>.

Sa e rëndësishme është që mësuesit të njihen me antisemitizmin, po aq e rëndësishme është që ata të kuptojnë se mendimi dhe sjellja antisemitike ndryshon intensitet dhe merr forma të ndryshme me kalimin e kohës dhe në varësi të vendit^[68]. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se ka pasur kohë kur qëndrimet dhe politikat anti-hebreje ishin më të dobëta, si në disa pjesë të Gadishullit Iberik në periudhën mesjetare, dhe kohë kur pikëpamjet anti-hebreje kanë qenë të njohura dhe mbizotëruese. Mësuesit duhet të marrin në konsideratë kontekstin specifik shoqëror për të shpjeguar pse ka pasur periudha dhe vende ku hebrenjtë kanë përparuar (si rasti i hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, shiko aneks 3), si dhe të tjera ku ata janë persekutuar.

Cilat janë rrënjët dhe funksionet e antisemitizmit?

Duke qenë se antisemitizmi dhe antijudaizmi kanë histori të gjata, është e rëndësishme që mësuesit të dinë dhe të kuptojnë mënyrën se si faktorë të ndryshëm e kanë bërë popullor antisemitizmin në periudha të ndryshme. Mësuesit duhet të kuptojnë se si diskriminimi i gjatë i bazuar në fe, kundër hebrenjve i ka lënë ata si një objektiv dhe grup tradicional që është i lehtë për t'u stigmatizuar dhe subjekt i një sërë shakash, mitesh dhe stereotipash që njihen lehtësisht në kulturën dhe shoqërinë botërore.^[69]

Si mund të përgatitem për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive incidenteve kritike të antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjytimeve në klasë dhe në mjediset arsimore?

Pyetje për temën

- Cilat janë incidentet kritike dhe si mund të reagohet ndaj tyre?
- Si mund t'i përgjigjem në mënyrë efektive incidenteve në klasë?

Rezultatet e të nxënit

RN 28: Mësuesit kuptojnë tiparet kryesore të incidenteve kritike dhe aftësohen t'u përgjigjen atyre me korrektësi dhe në kohën e duhur.

RN 29: Mësuesit u përgjigjen incidenteve kritike në klasë dhe i kthejnë këto sfida në mundësi mësimi.

Antisemitizmi dhe format e tjera të intolerancës, anësive dhe paragjytimeve janë dukuri të këqija që kanë efekte të dëmshme në mirëqenien emocionale, intelektuale dhe fizike të njerëzve. Këto ndikime mund të jenë të menjëhershme, të qarta dhe të dukshme. Ato gjithashtu mund të jenë më jetëgjata, të fshehura dhe më të vështira për t'u identifikuar. Ato mund të shkatërrojnë jetë dhe mjete jetese, të krijojnë tensione sociale dhe mosmarrëveshje kulturore dhe mund të çojnë në akte dhune, duke përfshirë edhe ekstremizmin e tyre, vrasjen. Si i tillë, antisemitizmi, intoleranca, dhe paragjykimet kërcënojnë më shumë sesa individin që i nënshtrohet këtyre qëndrimeve dhe sjelljeve, ato rrezikojnë strukturën e jetesës së përbashkët, shëndetin social, moral dhe politik të mbarë shoqërisë.

Këto arsye ofrojnë një rast bindës për nevojën themelore për t'iu përgjigjur incidenteve kritike në klasa dhe në mjediset arsimore. Të lihen pa adresuar këto dukuri, në radhë të parë, do të thotë të heqësh dorë nga përgjegjësitë që kanë të gjithë ata që punojnë në arsim për të ruajtur dhe për të mbrojtur sigurinë e fëmijëve. Për këtë arsye, përgjigjja ndaj këtyre fenomeneve fillon me njohjen dhe me ndërgjegjësimin e antisemitizmit, intolerancës dhe paragjytimeve, format që ato mund të marrin, si dhe pasojat që ato kanë për individët. Kjo i referohet, ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve dhe për përgjegjësitë e mësuesit për t'i respektuar dhe mbrojtur këto të drejta (shihni temën e dytë (3.2.) më lart). Të qenit i vetëdijshëm dhe i informuar do ta ndihmojë mësuesin të njohë një incident kritik kur ai ndodh, dhe të reagojë në mënyrë të drejtë për minimin dhe parandalimin e tij.

Gjithashtu ndërgjegjësimi për njohjen dhe identifikimin e këtyre fenomeneve do të rrisë vlerësimin e mësuesit për të kuptuar se një incident që të jetë kritik jo domosdoshmërisht duhet të përfshijë dhunë fizike ose agresion.

Mësuesit kanë nevojë për të reflektuar mbi të paktën dy dimensione të planifikimit dhe të mësimdhënies në lidhje me paragjykimet dhe çështjet e ndërlidhura:

1. veprime të qëllimshme, të tilla si ato që angazhohen kur shkruajnë planet mësimore gjatë një periudhe ose një viti;
2. veprime reaguese të përgjegjshme, të ndërmarra në përgjigje të incidenteve dhe ngjarjeve të paparashikuara.

Dy mënyra të veprimit pedagogjik

Praktikë aktive	Praktikë reaguese
<i>Veprim i synuar dhe i projektuar i shprehur përmes qasjes së mësimdhënies-nxënies dhe aktiviteteve mësimore.</i>	<i>Veprimi që i përgjigjet ngjarjeve dhe situatave të paparashikuara dhe shfrytëzohet si mundësi për të nxënë.</i>

Për sa i përket incidenteve kritike, praktika reaguese e veprimit modelohet në kontekste profesionale duke reflektuar mbi incidente të tilla. Në arsim, një incident kritik shpesh kuptohet si një ngjarje me potencial për të nxënë, për t'i bërë praktikuesit të ndalojnë dhe të mendojnë, ose “të vënë në dyshim një aspekt të besimeve, vlerave, qëndrimit ose sjelljes së tyre”.^[107] Incidentet kritike kuptohen në mënyra dramatike dhe modelohen si “çdo incident ose sekuencë ngjarje e menjëhershme dhe e papritur e cila shkakton traumë brenda një komuniteti shkolle dhe mposht mekanizmat normalë të funksionimit të asaj shkolle”^[108] ose, në mënyrë më pak dramatike, si “një incident ku efektiviteti i përgjigjes ka të ngjarë të ketë ndikim në “besimin” e atyre që janë prekur nga incidenti, familjes së tyre dhe/ose komunitetit”.^[109]

Reflektimi mbi incidentet dhe për shkallën në të cilën ato janë ose mund të jenë “kritike” për individët, institucionet dhe komunitetet e përfshira, mund të jetë një objekt mësimi shumë efektiv për mësuesit, kjo sepse incidentet shpesh dramatizojnë

[107] Society for Education and Training, “Critical Incident Analysis for Teachers, Tutors and Trainers”, 2016.

[108] United Kingdom Department of Education, “Every School a Good School: A Guide to Managing Critical Incidents in Schools.” Department of Education website, 2014 <<https://www.education-ni.gov.uk/publications/guide-managing-critical-incidents-schools>>.

[109] Critical Incident Management”, <<https://www.app.college.police.uk/app-content/critical-incident-management/types-of-critical-incident/>>.

kompleksitetin dhe natyrën shumëdimensionale të çështjeve në fjalë dhe të konteksteve arsimore në të cilat ato lindin.

Përcaktimi i asaj që përbën një incident kritik nuk është i drejtpërdrejtë. Me përjashtim të shprehjeve qartësisht të qarta të antisemitizmit, intolerancës, anësive dhe paragjytimeve, një mësues duhet të njohë, të kuptojë dhe të identifikojë praninë dhe shfaqjen e këtyre fenomeneve në klasë që të japë më pas një gjykim profesional.

Mësuesit gjatë trajnimit duhet të ushtrohen me aktivitete të bazuara në skenarë për të ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve të tyre, për të njohur se si këto dukuri mund të marrin formë në situata të jetës reale. Këto aktivitete janë jashtëzakonisht të dobishme për zbërthimin dhe eksplorimin e gamës së veprimeve që duhet të ndërmerret një mësues në një situatë të caktuar, si dhe për hartimin e një liste të parimeve që ai mendon se është e rëndësishme t'i zotërojë dhe ushtrojë për kapërcimin e situatës. Modele të tillë skenarësh gjenden në kapitullin e katërt të këtij dokumenti.

Këta skenarë nuk synojnë të japin një përgjigjeje të saktë ose e një rruge veprimi, pasi mësuesit duhet të vlerësojnë vetë përgjigjet e tyre ndaj incidenteve të cilat janë domosdoshmërisht të varura nga konteksti.

Ndërsa mësuesit kuptojnë se nuk ekziston asnjë model universal për t'iu përgjigjur incidenteve kritike, ata duhet gjithashtu të jenë të vetëdijshëm se ka elemente të mira praktike që tejkalojnë situatat me të cilat mund të përballen. Mësuesit duhet të shmangin sjelljet instinktive (qoftë në aspektin e nxjerrjes së përfundimeve të shpejta ose arritjes së formës më të rëndë të disiplinës në dispozicion të tyre), dhe duhet të vlerësojnë se duhet të jenë sa më të informuar përpara dhënies së një gjykimi. Ata duhet të kenë dhembshuri dhe ndjeshmëri për personin e ndikuar në dukje nga incidenti. Mësuesit duhet gjithashtu të jenë të ndërgjegjshëm për integritetin e tyre profesional dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me ligjin dhe me autoritetet e tjera dhe palët e interesuara në arsim. Ata duhet të sigurojnë mbajtje të mirë të shënimeve, të veprojnë shpejt dhe në kohën e duhur dhe sigurohen për përfshirjen e kolegëve dhe prindërve, kur pjesëmarrja e tyre është e domosdoshme. Procese dhe procedura të tilla kanë rëndësi të shtuar në kontekstin e shkollave të mesme, ku nxënësit në fazat e fundit të arsimit të tyre mund të kenë arritur moshën e përgjegjësisë ligjore dhe potencialisht të jenë subjekt i ndjekjes penale. Kështu, mësuesit e arsimit të mesëm duhet të jenë të vetëdijshëm për politikën shkollore, rajonale dhe kombëtare që kanë të bëjnë me raportimin e incidenteve të gjuhës së urrejtjes dhe radikalizimit të dhunshëm.

Është e rëndësishme të ndihmohen mësuesit të kuptojnë se, përveç reagimit ndaj incidenteve kritike nëpërmjet masave disiplinore, ata do të duhet gjithashtu të marrin në konsideratë – dhe të planifikojnë – si të rindërtojnë dhe të riparojnë marrëdhëniet më pas. Kjo vlen si për menaxhimin e marrëdhënieve ndërmjet nxënësve të përfshirë, ashtu edhe për menaxhimin e marrëdhënies që mësuesi do të ketë me personin që është sjellë në mënyrë të papranueshme.

Mësuesit e arsimit parauniversitar duhet të jenë të vetëdijshëm se deklaratat antisemite ose ndryshe paragjyquese mund dhe shfaqen në momente të paparashikueshme gjatë mësimdhënies, kështu ato mund të shfaqen në mënyra të ndryshme - si “shaka”, si argumente në një diskutim ose thjesht rastësisht. Në të gjitha rastet, mësuesi duhet t'u përgjigjet këtyre incidenteve në mënyrë që të menaxhojë njëkohësisht katër kërkesa:

- *Përgjigja duhet të mbrojë çdo viktimë/viktme të mundshme.*
- *Përgjigja nuk duhet të përçmojë apo ofendojë individin për pikëpamjet që ai ka. Kjo ka të bëjë edhe me të drejtat e fëmijës, edhe për faktin se mësuesi dhe nxënësi, sipas të gjitha gjasave, do të punojnë së bashku në të ardhmen.*
- *Përgjigja duhet të zbusë çdo konflikt që mund të lindë për një koment, duke lënë hapësirë për të rishqyrtuar çështjen në një datë të mëvonshme.*
- *Përgjigja, nëse është e mundur, nuk duhet të ndërhyjë në rrjedhën e natyrshme të mësimin. Mësuesi nuk duhet të anashkalojë mësimin dhe t'i reduktojë të drejtën e arsimit të nxënësve të tjerë.*


Aty ku një koment kundërshtohet lehtësisht me një deklaratë të thjeshtë faktike, kjo duhet të bëhet nga mësuesit për të inkurajuar nxënësin që shprehu pikëpamjen që të përfshihet në vetë-reflektim dhe të përpiket të vërtetojë ose jo pohimet e dhënë. Shembulli “Të gjithë hebrenjtë janë të pasur”,^[110] është i përshtatshëm për të vënë në dukje mospërputhjet dhe gabimet faktike. Mësuesit duhet të jenë të mirë informuar në mënyrë që të jenë në gjendje ta bëjnë këtë.

Për sugjerime praktike se si të trajtohet antisemitizmi nëpërmjet veprimtarive pedagogjike, mësuesit mund të konsultohen me:

- Udhëzimin e hartuar nga Qendra Poorvu për Mësimdhënie dhe Nxënien (<<https://poorvucenter.yale.edu/ImplicitBiasAwareness>>);
- Botimin “Praktika kritike për edukimin kundër paragjykimeve” (<<https://www.tolerance.org/professional-development/critical-practices-for-antibias-education>>).

[110] Shembuj të ngjashëm të pretendimeve të papaba që prekin grupe të tjera janë “A janë myslimanët terroristë?” ose “A na marrin emigrantët ose të ardhurit të gjitha punët?”.

3.11. Tema 11.



Si mund të ndërtoj te nxënësit aftësitë e mendimit kritik dhe kompetenca të qëndrueshme ndaj antisemitizmit dhe paragjykimeve?

Pyetje për temën

- Si të zhvilloj respektin për të drejtat e njeriut nëpërmjet lëndës që jap mësim?
- Si mund të ndërtoj një klasë gjithëpërfshirëse?
- Si ta zhvilloj edukimin mediatik tek nxënësit e mi?
- Si mund të nxisë zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe qëndrueshmërinë ndaj antisemitizmit, intolerancës dhe paragjykimeve?

Rezultatet e të nxënit

RN 30: Mësuesit zhvillojnë

njohuri/aftësi/qëndrime dhe vlerësojnë nxënësit për çështjet e të drejtave të njeriut.

RN 31: Mësuesit krijojnë në klasë një klimë gjithëpërfshirëse që mundëson të mësuarin për të drejtat e njeriut.

RN 32: Mësuesit përmes edukimit për të drejtat e njeriut fuqizojnë nxënësit të sfidojnë antisemitizmin dhe paragjykimet.

RN 33: Mësuesit nxisin edukimin kritik mediatik te nxënësit, duke integruar shqyrtimin e këtyre çështjeve në mësimdhënien e lëndës së tyre, si dhe duke i fuqizuar nxënësit të vlerësojnë në mënyrë kritike tekstet mediatike (natyrën, formën, origjinën, qëllimin).

RN 34: Mësuesit nxisin aftësitë e të menduarit kritik te nxënësit, duke integruar konsiderata të antisemitizmit, intolerancës dhe paragjykimeve në mësimdhënien e lëndës së tyre dhe duke u dhënë mundësi nxënësve për të vlerësuar bazën e argumenteve narrative dhe pretendimeve përballë fakteve dhe logjikës së tyre.

Ekzistojnë materiale të shumta që zhvillojnë te nxënësit edukimin për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë globale, si për shembull: Edukimi Global i Qytetarisë së UNESCO-s^[111] dhe udhëzuesi “ Respekt për të gjithë”^[112], i cili ofron aktivitete dhe vlerësime që mësuesit mund të përdorin për të nxitur respektin në klasë. Burimet pedagogjike dhe reflektuese, si Osler dhe Starkey's Teachers and Human Rights Education^[113], janë gjithashtu shumë të dobishme për t'u përdorur nga mësuesit.

Çfarë është edukimi për të drejtat e njeriut?

Edukimi për të drejtat e njeriut mund të përkufizohet si edukim, trajnim dhe informacion që synon ndërtimin e një kulture universale të të drejtave të njeriut. Edukimi efektiv për të drejtat e njeriut jo vetëm që ofron njohuri për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat që i mbrojnë ato, por gjithashtu zhvillon aftësitë e nevojshme për të promovuar, mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e njeriut në jetën e përditshme. Edukimi për të drejtat e njeriut gjithashtu nxit qëndrimet dhe sjelljet e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e njeriut për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Aktivitetet e edukimit për të drejtat e njeriut duhet të përcjellin parimet themelore të të drejtave të njeriut, si barazia dhe mosdiskriminimi, duke afirmuar ndërvlerësinë, pandashmërinë dhe universalitetin e tyre. Në të njëjtën kohë, aktivitetet duhet të jenë praktike, duke lidhur të drejtat e njeriut me përvojat e jetës reale të nxënësve dhe duke u mundësuar atyre të ndërtojnë parimet e të drejtave të njeriut në kontekstin e tyre kulturor. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla, nxënësit fuqizohen për të identifikuar dhe adresuar nevojat e tyre për të drejtat e njeriut dhe për të kërkuar zgjidhje në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut. Për më tepër, për ata që kanë përgjegjësinë për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të të tjerëve, edukimi për të drejtat e njeriut zhvillon kapacitetin e tyre për ta bërë këtë. Si ajo që mësohet, ashtu edhe mënyra në të cilën mësohet, duhet të pasqyrojnë vlerat e të drejtave të njeriut, të inkurajojnë pjesëmarrjen dhe të nxisin një mjedis mësimi pa praninë e nevojës dhe të frikës.^[114]

Angazhimi i mësuesve me të drejtat e njeriut kërkon një fokus në një sërë dimensionesh të edukimit për të drejtat e njeriut:

- Edukimi rreth të drejtave të njeriut i mëson nxënësit për të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën për informacion (nga një shumëllojshmëri burimesh kombëtare dhe ndërkombëtare), të drejtën për lirinë e fesë ose të besimit dhe lirinë e shprehjes, i mëson se si antisemitizmi cenon të drejtat e individëve dhe për përgjegjësinë e përbashkët për të mbrojtur të drejtat e njeriut;

[111] UNESCO, Global Citizenship Education: Topics and Learning Objectives (Paris: UNESCO, 2015), <<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000232993>>.

[112] UNESCO, Teaching Respect for All: Implementation Guide (Paris: UNESCO, 2014), <<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000227983>>.

[113] Osler, A. & Starkey, H., Teachers and Human Rights Education.

[114] UN/HCHR/UNESCO, World Programme for Human Rights Education: Plan of Action (New York and Geneva: United Nations, 2012).

- Edukimi për të drejtat e njeriut siguron që mjediset arsimore të mbrojnë të drejtat e të gjithë nxënësve, pa asnjë formë diskriminimi, duke përfshirë të drejtën për një mjedis mësimi pa antisemitizëm.
- Edukimi për të drejtat e njeriut u jep mundësi nxënësve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të mbrojnë të drejtat e të tjerëve, duke përfshirë ndalimin e antisemitizmit.

Kur diskutoni për mësimdhënien dhe të nxënësve me mësuesit gjatë trajnimit, është e dobishme t'i kushtoni kohë jo vetëm mundësive se si ata mund të integrojnë në kurrikul mësimdhënien për të drejtat e njeriut, por gjithashtu t'u kërkonit atyre të reflektojnë se si dhe në çfarë masedhe në çfarë mënyre klasat e tyre miratojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut. Me fjalë të tjera, mësuesit duhet të marrin në konsideratë se si do të dizajnojnë mjediset e të mësuarit për të siguruar dinjitet dhe barazi për të gjithë nxënësit dhe si t'u ofrojnë nxënësve mundësi për të ushtruar dhe miratuar të drejtat e tyre.

Është gjithashtu e rëndësishme të integrohet një perspektivë gjinore për të demaskuar paragjykimet dhe që nxënësit të kuptojnë dinamikën e identitetit në përgjithësi. Përqasjet dhe strategjitë pedagogjike të mësimdhënies tashmë të testuar për të zgjidhur paragjykimet gjinore mund të përdoren për të zbërthyer lloje të tjera diskriminimi. Në të njëjtën kohë, përdorimi i perspektivës gjinore është i rëndësishëm për të kuptuar kryqëzimet, si dhe të përbashkëtat ose dallimet, ndërmjet gjinisë dhe llojeve të tjera të diskriminimit dhe pabarazisë, duke përfshirë antisemitizmin. Qëndrueshmëria ndaj antisemitizmit nxitet më së miri përmes projektimit të mjediseve arsimore që ushqejnë dhe zhvillojnë kultura në të cilat të drejtat miratohen dhe mbështeten si çështje të natyrshme.

Shoqëria sot kërkon që nxënësit të zhvillojnë njohuri dhe kompetenca specifike që do t'u mundësojnë atyre “të lundrojnë” të sigurt në mjediset sociale bashkëkohore, duke përfshirë angazhimin në mënyrë kritike në mjediset e mediave sociale. Suksesi për këtë kërkon zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe kompetenca specifike mediatike që nuk zhvillohen përmes edukimit tradicional akademik.^[115] Formimi mediatik dhe informacioni është një mënyrë e dobishme për të zhvilluar të menduarin kritik.

Punimi i fundit i ndërmarrë nga Stanford History Education Group ka treguar se edhe individët me arsim të lartë nuk e përpunojnë informacionin në mënyrë që t'u mundësojë atyre të kërkojnë për “dezinformata, lajme të rreme dhe propagandë” fenomene që karakterizojnë botën tonë sot.^[116]

[115] Wineburg, S., Why Learn History (When It's Already on Your Phone).

[116] Wineburg, S. & McGrew, S., “Lateral Reading: Reading Less and Learning More When Evaluating Digital Information”, Stanford History Education Group Working Paper No. 2017-A1, 9 October 2017, <<https://ssrn.com/abstract=3048994>>.

Në Shqipëri nëpërmjet lëndës së historisë mësuesit përveç teksteve shkollore dhe burimeve të tjera alternative mund të përdorin “Librat e historisë së përbashkët” (<http://jointhistory.net/>), me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aftësive të mendimit kritik te nxënësit.

Librat (1. Perandoria Osmane; 2. Kombet dhe shtetet; 3. Lufta Ballkanike; 4. Lufta e Dytë Botërore) janë një koleksion unik i burimeve historike nga të gjitha vendet, i përpiluar për studentët dhe mësuesit e historisë. Qëllimi i tyre kryesor është të tregojnë se çdo histori ka këndvështrime të shumëfishta, duke mbështetur të menduarit kritik dhe duke zhvilluar një kuptim se si është bërë historia. Asgjë nuk është tabu në librat e përbashkët të historisë - ato përfshijnë gjithçka nga fytyra politike e diktaturës dhe represionit deri te krizat e viteve '70 dhe '80, dhe shpërbërja e Jugosllavisë. Këto libra ishin programi qendror i Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Evropën juglindore (QDPEJ), një OJQ rajonale me bazë në Selanik, e orientuar drejt ndikimit, e cila u përpoq të nxiste shoqëritë demokratike, pluraliste dhe paqësore në Evropën juglindore. Pavarësisht se ka prodhuar një nga projektet më të suksesshme ndonjëherë, në vitin 2019, QDPEJ është detyruar të mbyllet për shkak të mungesës së fondeve.

Me iniciativën e Fondit Evropian për Ballkanin (FEB), përmes mbështetjes për krijimin dhe mirëmbajtjen e kësaj faqeje interneti, këto libra janë sërish në dispozicion të publikut. FEB thekson se këto libra janë një mjet i rëndësishëm jo vetëm për mësimdhënien e historisë, por edhe për hapjen e një kulture dialogu dhe mënyrash të ndryshme të të menduarit. Librat e përbashkët të historisë mund të jenë një rrugëdalje nga një sistem arsimor kryesisht njëdimensional në rajonin e Evropës Juglindore dhe ato kanë potencialin për të inkurajuar shkëmbimin e perspektivave dhe përvojave të ndryshme.

Komiteti i Edukimit për Historinë i QDPEJ, i përbërë nga kontribuues nga çdo vend i rajonit, identifikoi burimet dhe përmbajtjen për prodhimin e librave, duke siguruar që të portretizohen perspektiva të shumta. Më shumë se 100 historianë dhe 300 mësues ishin përfshirë në hartimin e këtyre librave.

Këto libra janë krijuar për t'u përdorur dhe janë prodhuar në bashkëpunim me historianë dhe mësues nga të gjitha anët e Evropës juglindore: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Greqia, Kosova, Mali i zi, Rumania, Maqedonia e veriut, Sllovenia, Serbia dhe Turqia. Këto libra pune nuk synojnë të zëvendësojnë tekstet e historisë që përdoren aktualisht në klasa dhe as nuk synojnë të ofrojnë një tregim koheziv të historisë së Evropës juglindore nga shekulli XIV deri më sot. Ato kanë qëllime njohëse dhe morale dhe sugjerojnë metodat dhe mjetet për mësimdhënien e historisë. Ato propozojnë të rishkruhet historia përmes një mësimi të metodës dhe jo përmbajtjes.

Burimet që zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik, të cilat i gjeni në internet janë:

- *The Foundation for Critical Thinking* (<<https://www.criticalthinking.org/>>);
- *The P4C Co-operative* (<<https://p4c.com/>>);
- *The University of Queensland CriticalThinking Project* (<<https://critical-thinking.project.uq.edu.au/home>>); and
- *The Canadian Critical Thinking Consortium website* (<<https://tc2.ca/>>), i cili ofron video materiale shpjegimi të zhvillimit të menduarit kritik nga mësuesi. (<<https://www.youtube.com/watch?v=oseRkZcaEIs&feature=youtu.be>>)

Shumë materiale të dobishme janë krijuar për të ndihmuar nxënësit të bëhen lexues kritikë të mediave bashkëkohore. Këto materiale janë të përshtatshme në programet e trajnimit të mësuesve:


- *Librat e historisë së përbashkët* (<http://jointhistory.net/>).
- *The “Mastering the media” learning pathway in the Anne Frank House’s “Stories that Move” resource* (<<https://www.storiesthatmove.org/en/for-educators/the-learning-paths/mastering-the-media/>>) ofron përvoja interaktive të nxënimit për nxënësit, duke u mundësuar atyre të reflektojnë mbi marrëdhëniet e tyre me masmedian, stereotipet dhe manipulimin e medias.
- *Teaching Tolerance’s “Analyzing How Words Communicate Bias” ofron mësim dhe materiale shoqëruese, të cilat janë efektive për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë shkrim-leximin mediatik* (<<https://www.tolerance.org/classroom-resources/tolerance-lessons/analyzing-how-words-communicate-bias>>).

The Stanford History Education Group (<<https://sheg.stanford.edu/>>) ka zhvilluar një sërë mjetesh dhe burimesh vlerësimi që mund të ndihmojnë mësuesit të zhvillojnë njohuritë mbi qytetarinë në internet,^[117] duke përfshirë:

- *Materiale për vlerësimin e pretendimeve në YouTube* (<<https://sheg.stanford.edu/civic-online-reasoning/claims-youtube>>).
- *Materiale për të eksploruar analizën argumentuese në komentet në faqet e internetit të lajmeve* (<<https://sheg.stanford.edu/civic-online-reasoning/argument-analysis>>).
- *Materiale për vlerësimin e artikujve* (<<https://sheg.stanford.edu/civic-online-reasoning/article-evaluation>>).
- *Materiale për vlerësimin e lajmeve në Twitter* (<<https://sheg.stanford.edu/civic-online-reasoning/news-twitter>>).

[117] Wineburg, S., McGrew, S., Breakstone, J. & Ortega, T., “Evaluating Information: The Cornerstone of Civic Online Reasoning”, 22 November 2016, <<http://purl.stanford.edu/fv751yt5934>>.

3.12. Tema 12.



Si mund të bashkëpunoj në mjedisin tim arsimor dhe më gjerë për të sfiduar antisemitizmin dhe paragjykimet?

Pyetje për temën

- Si mund të punoj brenda dhe përgjatë fushave të kurrikulës për të trajtuar antisemitizmin dhe paragjykimet?
- Si mund të angazhohem me dhe brenda komunitetit dhe kontekstit tim lokal për të sfiduar antisemitizmin dhe paragjykimet?

Rezultatet e të nxënit

RN 35: Mësuesit identifikojnë mënyrat në të cilat antisemitizmi dhe paragjykimet mund të trajtohen në kurrikul (për shembull, nëpërmjet evidentimit se ku shfaqet tema e paragjykitimit në lëndën e tyre dhe në lëndët e tjera, planifikojnë mësimdhënien).

RN 36: Mësuesit identifikojnë mënyrat në të cilat antisemitizmi dhe paragjykimet mund të trajtohen në të gjithë shkollën përmes edukimit qytetar dhe planifikojnë të mësuarit për ta arritur këtë, për shembull, nëpërmjet iniciativave që eksplorojnë parimet e të drejtave të njeriut.

RN 37: Mësuesit identifikojnë mënyrat se si të përfshijnë komunitetin lokal në iniciativat për të sfiduar antisemitizmin, për shembull, duke u mbështetur në historinë lokale ose tregimet e komunitetit.

Të mësuarit bashkëpunues brenda komuniteteve shkollore, sipas ekipeve lëndore të një shkolle ose një projekti të shtrirë gjatë një viti shkollor, ndërmjet nxënësve dhe mësuesve të tyre mund të jetë një mënyrë e shkëlqyer për të bashkuar shkollën në një qëllim të përbashkët dhe për të angazhuar të gjithë komunitetin e shkollës në zgjidhjen e problemeve (antisemitizmin). Bashkëpunimi lejon që të mësuarit të përforcohet në lëndë të ndryshme në mënyra efektive. Bashkëpunimi mund të eksplorojë një temë, të tillë si historia e diversitetit në lokalitetin e një shkolle, për një periudhë të gjatë kohore në lëndë të ndryshme, për shembull, përmes historisë,

Ai gjithashtu mund të paraqesë një kombinim të llojeve të detyrave, të tilla si detyrat krijuese, detyrat kërkimore historike apo projektet. Qasje të ngjashme mund të zhvillohen në një mënyrë më kompakte dhe më të fokusuar rreth një ngjarjeje të caktuar, për shembull duke zhvilluar një grup aktivitete në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit [118] ose ngjarjeve të ngjashme me ndikim lokal ose kombëtar. Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit u krijua nga Rezoluta 60/7, në 1 Nëntor 2005 ("Kujtimi i Holokaustit"), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Dita Ndërkombëtare në nderim dhe kujtim të viktimave të Holokaustit mbahet çdo vit më 27 janar, data e çlirimit të kampit gjerman Aushvic-Birkenau nga ushtria sovjetike.

Përkujtimi i datave të veçanta si Dita e të Drejtave të Njeriut [119], mund të jetë një mundësi për stafin e shkollës që të pezullojë orarin e rregullt dhe të krijojë një ditë të qëllimshme që eksploron çështje/pyetje kyç, të tilla si "Çfarë janë stereotipitë dhe nga vijnë ato?" Qasja mund të kapërcejë një ndarje që shpesh ekziston midis ekipeve lëndore, duke sjellë një qasje më kohezive dhe të ndërruar për të nxënësit në mbarë shkollën. Partnerët e jashtëm mund të ndihmojnë që këto ditë të jenë të suksesshme. Në këto ditë shkolla mund të ftojë folës të tillë si: historianë që kanë studiuar Holokaustin ose persona që kanë ndihmuar hebrenjtë [120] gjatë Luftës së Dytë Botërore ose anëtarë të komunitetit të shkollës që kanë përjetuar paragjykimet/diskriminime antisemitike, ose shkelje të të drejtave të njeriut si të afërm të viktimave të komunizmit në Shqipëri apo ish të persekutuar ose persona të tjerë që janë të lumtur të diskutojnë përvojën e tyre me nxënësit. Nxënësit mund të punojnë në grupe për të adresuar pyetje apo intervista që kanë përgatitur paraprakisht.

Mësuesit duhet të kenë parasysh se sjellja e një të mbijetuarit në shkollë është një angazhim që kërkon kohë, kërkon kujdes dhe vëmendje të veçantë. Ashtu si folësi duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë audiencë të veçantë, ashtu edhe nxënësit duhet të përgatiten dhe të informohen mbi përvojën nëse duam të maksimizohet potenciali i tyre i të mësuarit.

Mundësitë e të mësuarit nga familja dhe komuniteti mund të jenë efektive për të bashkuar njerëzit dhe për të afruar familje të tëra në aktivitetet e të mësuarit rreth temave të përshkruara në këtë kurrikul. Krijimi i ngjarjeve që ftojnë prindërit dhe gjyshërit, oficerët e policisë, përfaqësuesit e qeverisjes vendore etj., për të marrë pjesë në mësim për adresimin e antisemitizmit ose dhe çështjeve të tjera qytetare, mund të bëjë një ndryshim të konsiderueshëm për komunitetin në përgjithësi.

[118] The International Day of Commemoration in Memory of the Holocaust was established by Resolution 60/7 of 1 November 2005 ("Holocaust Remembrance") adopted by the General Assembly of the United Nations. The International Day is held every year on 27 January, the liberation date of the German Nazi extermination and concentration camp of Auschwitz-Birkenau by the Soviet Army.

[119] Human Rights Day is observed every year on 10 December – the day the United Nations General Assembly adopted, in 1948, the Universal Declaration of Human Rights.

[120] Shih Aneks 4

Mësuesit dhe qeveritë e nxënësve, me mbështetjen dhe inkurajimin e drejtorit të shkollës, mund të udhëheqin iniciativa me komunitetet vendase, muzetë, OJQ-të dhe shkollat e tjera për të shqyrtuar projekte ose programe të përbashkëta që arrijnë në thelbin e asaj se çfarë është antisemitizmi, si mund të parandalohet dhe si të trajtohen shembuj të tjerë të intolerancës që mund të jenë të rëndësishme në kontekstin lokal. Të qenit pro aktiv mund të transformojë marrëdhëniet brenda dhe jashtë shkollës, por gjithashtu mund të sjellë rreziqe ndaj iniciativat duhet të kryhen me kujdesin dhe ndjeshmërinë e duhur. Menaxhimi i ngjarjeve që hapin biseda të vështira kërkon aftësi ndaj rekomandohet që në fillim të ecet me hapa të vegjël në këtë drejtim. Megjithatë, nëse bëhet mirë, puna në partneritet brenda dhe jashtë shkollës mund të jetë një mënyrë dinamike për t'u demonstruar të rinjve se ndërtimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe më të sigurt përfshin individë që synojnë të luajnë rolin e tyre në realizimin e ndryshimeve pozitive në shoqëri.

Kurrikula e historisë në Shqipëri, si në arsimin bazë ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë, siguron hapësirë të bollshme në adresimin e temave dhe aktiviteteve të Holokaustit (tema dhe çështje), ku nxënësit fitojnë njohuritë/aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme në lidhje me këtë periudhë dhe ngjarje historike.

Gjatë mësimit të historisë në Shqipëri, nxënësit krahas studimit të ngjarjeve historike që kanë karakterizuar shekullin XX, aftësohen të parandalojnë përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur në histori si Holokausti, gjenocidi dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të vlerave themelore dhe të të drejtave të njeriut, të cilat janë kërkesa të shprehura qartë në Rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI.

Përgjatë lëndës së historisë [121] nxënësit aftësohen:

- të gjykojnë dhe të vlerësojnë natyrën e ndryshueshme të konflikteve dhe të bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve dhe ndikimet e tyre në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë natyrën dhe ndikimin e dy luftërave botërore, Holokaustin dhe rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve;
- të shpjegojnë dhe të gjykojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore: pasojat ekonomike, pasojat sociale, pasojat psikologjike, gjenocidin e në veçanti pasojat e Holokaustit;
- të vlerësojnë rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve të luftës;
- të vlerësojnë rolin dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore.

- të njihen dhe të ndërgjegjësohen me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët në historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;
- të reflektojnë mbi ideologjitë që shkaktuan Luftën e Dytë Botërore dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur shmangien apo përsëritjen e ngjarjeve të tilla;
- të kryejnë aktivitete të ndryshme në funksion të zbatimit të Vendimit të Ministrave të Edukimit (Krakovi 2000), lidhur me caktimin në shkollë të një dite përkujtimore të Holokaustit për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- të kujtojnë ashtu si Evropa, 27 janarin, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit, duke kryer aktivitete dhe projekte të ndryshme në këtë ditë.

Tekstet shkollore të historisë

Bazuar në programet e historisë, autorët e teksteve shkollore kanë hartuar tekstet e reja të historisë për arsimin parauniversitar në Shqipëri, të certifikuara nga Ministria e Arsimit gjatë viteve 2015-2020. Trajtimi i holokaustit është pjesë e këtyre teksteve.

Tema të tilla në tekstin shkollor të historisë si “Shqiptarët dhe hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore” nxisin kuriozitetin e nxënësve për të njohur historinë dhe kulturën e hebrenjve ndër shekuj, guximin, heroizmin dhe forcën e tyre për të mbijetuar dhe për t’u ringritur. Po ashtu ata vlerësojnë ndihmën që populli shqiptar jiu dha mijëra hebrenjve, në një kohë ku pjesa tjetër e Evropës iu mbylli dyert.

Veprimtaritë për Holokaustin të vendosura në programet dhe tekstet e historisë i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj.

Nxënësit për këtë pjesë të errët të historisë së njerëzimit me pasoja fatale, vlerësojnë dhe gjykojnë ngjarjen historike për të mos harruar të shkuarën në mënyrë që ngjarje të tilla të mos përsëriten më kurrë dhe e ardhmja të ndërtohet e sigurt.

Vendet e përkujtimit të Holokaustit në Shqipëri:

- Një hapësirë publike në Shqipëri kushtuar Holokaustit është një pavion në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. E përbërë nga fotografi, tekste, harta dhe dokumente të kohës së luftës, ai u hap më 29 Nëntor 2004.
- Muzeu "Solomon" në Berat u hap më 3 maj 2018 dhe u kushtohet hebrenjve në Shqipëri.
- Në korrik 2020 Shqipëria ka përruar memorialin e Holokaustit në kryeqytet për nder të nderimit të hebrenjve dhe të qytetarëve shqiptarë që rrezikuan jetën e tyre për të mbrojtur hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këta shqiptarë ishin si të krishterë, ashtu dhe myslimanë që respektonin një kod nderi të quajtur “Besa”.

Memoriali i Holokaustit në Tiranë u projektua nga arkitekti i shquar hebre Stephen Jacobs. Stephen Jacobs, 81 vjeç, i mbijetuari i holokaustit ra dakord që të punojë në memorialin pasi mësoi se Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë që kishte më shumë hebrenj se më parë, pas Luftës së Dytë Botërore. Memoriali i Holokaustit në Tiranë, përmes një mbishkrimi të shkruar në tri pllaka guri në anglisht, hebraisht dhe shqip: "Shqiptarët, të krishterë dhe myslimanë, rrezikuan jetën e tyre për të mbrojtur dhe shpëtuar hebrenjtë", thekson bashkëjetesën paqësore fetare në Shqipëri, si dhe fisnikërinë e kontributin e shqiptarëve në shpëtimin e hebrenjve.

Përurimi i këtij memoriali prej guri në Shqipëri vjen si një inkurajim dhe është veçanërisht domethënës gjatë kohës së pandemisë globale të COVID-19, ku janë shfaqur shenja shqetësuese të shfaqjes së dhunës dhe të antisemitizmit, kudo në botë".

Së fundmi Ambasada e Izraelit në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit, në mjediset e shkollës "Jordan Misja", promovuan librin "Shqiptarët gjatë Holokaustit dhe shpëtimi i hebrenjve", si pjesë të kurrikulës së arsimit parauniversitar.

Materiale burimore

Për mësimin dhe trajtimin e Holokaustit, mësuesit në Shqipëri duhet t'i referohen materialeve të prodhuara nga Këshilli i Evropës, të tilla si "Udhëzimet për mësuesit dhe edukatorët" për mësimin rreth Holokaustit. Publikime të UNESCO -s, ODIHR, IHRA. Muzeu Yad Vashem, rekomandime për mësimdhënien dhe mësimin rreth Holokaustit- 2019, IHRA, dhe publikimeve të studiuesve shqiptarë, si më poshtë:

- Historia e shqiptarëve, volumni IV
- "Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj" Apostol Kotani
- "Shqiptarët dhe hebrenjtë" Shaban Sinani
- "Hebrenjtë në trojet shqiptare" Edmond Malaj
- "Hebrenjtë në Shqipëri 1933-1946" Monika Stafa
- "Arkiva e shtetit shqiptar" Nevila Nika
- Shqiptarët gjatë Holokaustit dhe shpëtimi i hebrenjve
- Mësimdhënia e historisë moderne të Evropës Juglindore: Materiale mësimore plotësuese "Lufta e Dytë Botërore". (workbook4_shq.pdf (jointhistory.net))

Përvoja të huaja për trajtimin e Holokaustit

- Royal Wootton Bassett Academy është një shkollë e mesme e madhe në Mbretërinë e Bashkuar, me 1,800 nxënës të moshës 11 deri në 18 vjeç. Royal Wootton Bassett Academy ka zhvilluar një program edukimi për Holokaustin dhe gjenocidin (<<https://www.rwba.org.uk/information/holocaust-and-genocide/programme/>>),

i cili trajton antisemitizmin dhe çështje të tjera. Një nga arsytet e krijimit të këtij programi ishte shqetësimi i përdorimit të gjuhës fyese nga të rinjtë, si përdorimi i fjalës “gay” me konotacion negativ. Shkolla nisi këtë projekt për të adresuar këtë dhe çështje të tjera, duke e parë veten si një faktor për të parandaluar dhe për të minimizuar këto fenomene. Ky program mundësoi biseda, mësim dhe krijimin e marrëdhënie të reja. Ekziston një angazhim i gjerë i prindërve në programin e shkollës për Holokaustin dhe edukimin e gjenocidit. Ekspozita e krijuar nga ky program u shikua nga 184 prindër ose vizitorë të komunitetit, përveç stafit dhe grupeve të nxënësve. Bisedime e dëshmi të realizuara gjatë takimeve në orët e pasdites u ndoqën nga 178 nxënës, staf, prindër, anëtarë të komunitetit lokal dhe kolegë partnerë të shkollës.

- Centropa (<<https://www.centropa.org/>>) është një institut hebre jofitimprurës, i dedikuar për ruajtjen e historive dhe fotografive të familjeve hebreje të shekullit XX nga Evropa Qendrore dhe Lindore dhe nga Ballkani, si dhe për shpërndarjen e këtyre historive dhe fotove përmes filmave, librave dhe ekspozitave. Iniciativat e informimit të Centropa përfshijnë një konkurs për krijimin e videove (<<https://www.centropa.org/border-jumping/school/jewish-history-sopron-soproni-zsidóság-története>>) për nxënësit e shkollave të mesme për të krijuar filma të shkurtër mbi historinë hebraike të qytetit të tyre. Një iniciativë tjetër informuese e sponsorizuar nga Centropa është një ekspozitë udhëtuese.

(<<https://www.centropa.org/exhibition/stories-family-album-hungary>>)

që tregon historinë e një familjeje hebreje, të bazuar në një album familjar. Nxënësit trajnohen për të qenë guidë turistike të kësaj ekspozite dhe për rrjedhojë, veprojnë si urë lidhëse midis tregimit dhe publikut.

04

MATERIALE MBËSHTETËSE DHE UDHËZUESE

Ky kapitull përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë (4.1) përfshin shembuj të praktikave më të mira që mund të jenë të dobishme për trajnerët e mësuesve për të zhvilluar të kuptuarit e tyre mbi anësitë, paragjykimet, intolerancën dhe antisemitizmin, si dhe për të treguar mënyrën se si mësuesi mund t'i trajtojë këto fenomene me nxënësit e tij në klasë.

Pjesa e dytë (4.2) përshkruan një qasje të bazuar në skenar për adresimin e këtyre çështjeve me nxënësit. Udhëzimet e përgjithshme për përdorimin e këtyre skenarëve janë dhënë së bashku me një bankë skenarësh ilustrues. Këto duhet të përshtaten në kontekstin e tyre specifik nga trajnerët si pjesë e programeve të trajnimit lokal ose kombëtar.

a) Materialet e praktikave të mira

Modele të praktikave janë integruar në kapitullin e tretë “Pyetje për temat dhe rezultatet e të nxënit”. Këto dhe materialet shtesë janë renditur më poshtë për lehtësi referimi.

Materiale për fushën “Vetë – njohja”

- Rruga e të mësuarit "Tregimet që lëvizin" e Shtëpisë së Anne Frank (<https://www.annefrank.org/en/education/product/33/stories-that-move-english/>) “Të shohësh dhe të jesh” ofron materiale të dobishme ndërvepruese përmes të cilave eksplorojnë paragjykimet, stereotipitë dhe çështjet e lidhura me to.
- Materiale mësimore të ODIHR dhe Shtëpisë së Anne Frank për të luftuar antisemitizmin – Pjesa 3: Paragjykimet – Edhe ju? (<https://www.osce.org/odihr/24569>) ofrojnë materiale të vlefshme mësimore për të eksploruar paragjykimet.
- Faqja e internetit e Projektit “Implicit” (<https://implicit.harvard.edu/implicit/takeatest.html>) përmban një numër testesh të shoqatës “Implicit” (IAT) të realizuara nga studiues. [122] Një numër IAT-sh janë gjithashtu të disponueshëm si aplikacion (<https://apps.apple.com/gb/app/implicit-association-test/id775872487>). Këto janë mjete të dobishme për të njohur, kuptuar dhe parandaluar paragjykimet e nënkuptuara si një stimul për diskutim.
- Studio Globo (<https://www.studioglobo.be/>), në Belgjikë, ofron plane mësimore dhe udhëzime për mësuesit e arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, të fokusuara rreth edukimit zhvillimor.

[122] Banaji, M. R. & Greenwald, A. G., Blind Spot: Hidden Biases of Good People.

- Fondacioni “Shkolla dhe siguria”, (<<https://www.schoolenveiligheid.nl/>>), në Holandë, eksploron natyrën e paragjykimeve dhe mënyrën se si ato formohen si dhe ofron modele të vlefshme për krijimin e mjediseve shkollore gjithëpërfshirëse. Udhëzimet për mësimdhënien rreth diskriminimit përfshijnë video (<<https://www.schoolenveiligheid.nl/po-vo/thema/discriminatie-2/>>) që shpjegojnë paragjykimet dhe diskriminimin e përditshëm, duke përfshirë dhe vetë-testimin. Kjo faqe përmban edhe udhëzime dhe njohuri për zhvillimin e përmbajtjes.
- “Pohimi dhe paragjykime të tjera” [123], prezanton plane mësimore dhe materiale të tjera të hartuara nga Facing History and Ourselves. (<<https://www.facinghistory.org/resource-library/facing-ferguson-news-literacy-digital-age/confirmation-and-other-biases>>), të cilat ofrojnë mjete praktike tërheqëse dhe ndërvepruese për eksplorimin e paragjykimeve dhe supozimeve të ndryshme.
- Faqja e McGraw Hill “Understanding Prejudice” (<<https://secure.understandingprejudice.org/>>) përmban një sërë mjedesh praktike të vetëvlerësimit për të ndihmuar kuptimin e anësive dhe paragjykimeve.
- Ushtrimi i Shërbimit të Transmetimeve Publike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Sorting People” (<https://www.pbs.org/race/002_SortingPeople/002_00-home.html>) janë ushtrime të cilat u kërkojnë pjesëmarrësve të kategorizojnë individët në grupe racore, bazuar vetëm në pamjen e tyre dhe në këtë mënyrë ndezin një dialog për racën si një formë shoqërore.
- Burimi irlandez Spotlight on Stereotyping (<<https://developmenteducation.ie/resource/spotlight-on-stereotyping-a-resource-for-teachers-of-civic-social-and-political-education/>>) ofron plane mësimore dhe materiale për t'u mundësuar të rinjve të eksplorojnë stereotipet në një gamë mënyrash sistematike.
- Iniciativa Teaching Diverse Students (<<https://www.tolerance.org/>>) përfshin një sërë burimesh për të ndihmuar në krijimin e një përvoje takimi, për të mundësuar sfidimin e stereotipive.
- Guida “Teaching Respect for All Implementation” (<<http://www.unesco.org/new/en/archives/education/themes/leading-the-international-agenda/human-rights-education/resources/projects/teaching-respect-for-all/>>), zhvilluar nga UNESCO, përmban aktivitete dhe vlerësime që mësuesit mund t'i përdorin për të promovuar respektin në klasë.

[123] The “Confirmation and Other Biases”

Materiale për fushën “Njohuri për përmbajtjen”

- Historia e shqiptarëve, volumni IV
- “Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj” Apostol Kotani
- “Shqiptarët dhe hebrenjtë” Shaban Sinani
- “Hebrenjtë në trojet shqiptare” Edmond Malaj
- “Hebrenjtë në Shqipëri 1933-1946” Monika Stafa
- “Arkiva e shtetit shqiptar” Nevila Nika
- Shqiptarët gjatë Holokaustit dhe shpëtimi i hebrenjve
- “Përballja me diskriminimin [124]” dhe “Tregime që lëvizin” të Anne Frank’s House (<<https://www.annefrank.org/en/education/product/33/stories-that-move-english/>>) përmbajnë modele mësimi për eksplorimin e antisemitizmit.[125] .
- Materiale mësimore të Shtëpisë së ODIHR dhe Shtëpisë së Anne Frank për të luftuar antisemitizmin. Pjesa 1: Antisemitizmi në Evropë deri në vitin 1945 (<<https://www.osce.org/odihr/24567>>) dhe Pjesa 2: Antisemitizmi – Një luftë e pafund? (<<https://www.osce.org/odihr/24568>>) ofrojnë mjete të vlefshme për eksplorimin dhe zhvillimin e njohurive të përmbajtjes rreth formave të ndryshme të antisemitizmit. (<<https://tandis.odihr.pl/handle/20.500.12389/22546>>).
- Burimet akademike për studimin e antisemitizmit mund të gjenden në shumë faqe për shembull, në faqen e internetit të Pears Institute for the Study of Antisemitism (<<http://www.pearsinstitute.bbk.ac.uk/research/>>) në Birkbeck, Universiteti i Londrës.
- Kursi online i Yad Vashem “Antisemitizmi: Nga origjina e tij deri në të tashmen” (<<https://www.yadvashem.org/education/online-courses/antisemitism.html>>) është një kurs sistematik, i detajuar dhe i gjerë në të gjitha aspektet e antisemitizmit. Historia e zhvillimit të antisemitizmit, format e tij historike dhe bashkëkohore janë të rëndësishme për të eksploruar ndikimet dhe efektet e tij.
- Materialet e Echoes & Reflections (<<https://echoesandreflections.org/>>) mbi antisemitizmin nazist (<<https://echoesandreflections.org/unit-2-antisemitism/>>) dhe antisemitizmin bashkëkohor (<<https://echoesandreflections.org/unit-11/>>) përfshijnë plane mësimore, burime dhe shembuj të strategjive praktike pedagogjike. Këto plotësohen me materiale video të prodhuara nga Yad Vashem, duke përfshirë video mbi ideologjinë naziste (<<https://www.yadvashem.org/education/educational-videos/video-toolbox/hevt-nazi-ideology.html>>), video për antisemitizmin, (<<https://www.yadvashem.org/education/educational-videos/video-toolbox/hevt-antisemitism.html>>), dhe video për Holokaustin.

[124] “Facing Discrimination”

[125] The “Machinery of Discrimination”; The “Zooming in and “out” pathways and The “Life Stories”.

- <<https://www.yadvashem.org/education/educational-videos/video-toolbox/hevt-whatis.html>>)
- Leksioni me video “Natyra e antisemitizmit modern” (<<https://www.yadvashem.org/holocaust/about/nazi-germany-1933-39/antisemitism.html>>), nga David Bankier, është një burim i vlefshëm me njohuri për aspekte të kësaj teme.
- Faqja e internetit Éduquer contre le racisme et l'antisémitisme (<<https://www.reseau-canope.fr/eduquer-contre-le-racisme-et-lantisemitisme/comprendre.html>>) përmban burime dhe materiale për të mbështetur aktivitetet në klasë për njohjen dhe eksplorimin e antisemitizmit dhe formave të tjera të lidhura me racizmin.
- Projekti "Kujtesa e Kombeve" (<<http://territoryterror.org.ua/en/projects/international-projects/nation-memory/>>) në Republikën Çeke ofron burime historike që ndihmojnë nxënësit të eksplorojnë diversitetin në komunitetet e tyre.
- Erinnern.at Nationalsozialismus und Holocaust: Gedächtnis und Gegenwart (<<http://www.erinnern.at/bundeslaender/oesterreich/lernmaterial-unterricht/antisemitismus>>) është një organizatë austriake që prodhon materiale studimore dhe plane mësimore për të mësuar rreth Holokaustit dhe gjenocidit rom dhe sinti.
- Muzeu i Holokaustit në Montreal (<<https://museeholocauste.ca/en/>>) ofron një sërë programesh edukative për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë një kuptim mbi Holokaustin dhe fenomene më të gjera, si gjenocidi, duke përfshirë ekspozita virtuale për nxënësit, me udhërrëfyes. Shih, për shembull, <<https://museeholocauste.ca/en/exhibition/united-against-genocide-travelling-exhibition/>>.
- Faqja “Antisemitizmi, atëherë dhe tani” (<<https://antisemitismdaochnu.se/>>), e zhvilluar nga Komiteti Suedez për Antisemitizmin dhe Forumi i Historisë, ofron një burim të dobishëm për zhvillimin e njohurive të antisemitizmit historik dhe bashkëkohor.
- “Semitizmi. Përballja me historinë dhe vetveten” është një burim të dobishëm (<<https://www.facinghistory.org/standing-up-hatred-intolerance/contemporary-antisemitism-youth>>) për të eksploruar antisemitizmin bashkëkohor dhe abuzimin në internet.
- Faqja e internetit IWitness e Fondacionit USC Shoah (<<https://iwwitness.usc.edu/sfi/>>) përmban 2515 dëshmi të plota të të mbijetuarve dhe të dëshmitarëve të gjenocideve.

- Këto burime mbulojnë format bashkëkohore dhe historike të antisemitizmit, dhe gjithashtu trajtojnë një sërë episodesh të tjera historike të diskriminimit dhe paragjykit. Fondacioni ofron gjithashtu burime online dhe offline (plane mësimore në gjuhë të ndryshme, ekspozita online dhe dokumentarë), si dhe seminare për trajnimin e mësuesve dhe udhëzime se si të jepet mësim duke përdorur dëshminë.
- Artikulli në blog i Susan T. Fiske "Paragjykimi, diskriminimi dhe stereotipizimi" (<<https://nobaproject.com/modules/prejudice-discrimination-and-stereotyping>>) ofron një eksplorim sistematik të një sërë aspektesh të anësive dhe të paragjykimeve, si dhe të formave të racizmit dhe sistemeve stereotipi të besimit.
- Një mjet i fuqishëm për të menduar për përgjegjësitë e mësuesve dhe ndryshimin që mësuesit duhet të bëjnë, është "Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës", e cila është pjesë e së drejtës ndërkombëtare. UNICEF ofron një përmbledhje të dobishme, të disponueshme këtu (<http://www.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2010/05/UNCRC_summary-1.pdf>).
- Paketa arsimore e Këshillit të Evropës "Compass: Manual për edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut" (<<https://www.coe.int/en/web/compass>>) ofron udhëzime dhe materiale pedagogjike shumë të dobishme për eksplorimin e të drejtave të njeriut në mënyra ndërvepruese. Këshilli i Evropës prodhon gjithashtu një sërë materialesh që japin këshilla praktike për njohjen dhe minimin e pikëpamjeve paragjykuese rreth grupeve të ndryshme, duke përfshirë emigrantët (<<https://edoc.coe.int/en/196-migration>>), personat LGBTI (<<https://edoc.coe.int/en/222-lgbt>>), personat me aftësi të kufizuara (<<https://edoc.coe.int/en/223-people-with-disabilities>>), si dhe për të drejtat e pakicave (<<https://edoc.coe.int/en/218-minority-rights>>).
- Avokati i Popullit i Irlandës për të Drejtat e Fëmijëve ofron materiale të shumta (<<https://www.oco.ie/childrens-rights/education-materials/>>) për të ndihmuar mësuesit të planifikojnë për fëmijët, realizimin e edukimit të fokusuar në të drejtat e njeriut.
- EveryOther (ish-RightInfo) ka prodhuar një seri filmash të fokusuar në të drejtat e njeriut (<<https://eachother.org.uk/fighthatewithrights/>>) që mund të përdoren për një sërë qëllimesh, të tilla si për të eksploruar antisemitizmin si çështje e të drejtave të njeriut. Këta filma (<<https://eachother.org.uk/videos/>>) tregojnë mbi 80 histori rreth çështjeve të të drejtave të njeriut në vende të ndryshme.
- Instituto Padre António Vieira (<<http://www.ipav.pt/index.php/o-ipav>>) ofron programe mbi edukimin për të drejtat e njeriut për mësuesit.

- Platforma Bullgare e Sofjes (<<http://sofiaplatform.org/>>) ofron materiale dhe burime pedagogjike të fokusuara në kulturën politike demokratike, dialogun dhe kujtesën, si dhe materiale mbi fatin e hebrenjve bullgarë gjatë Holokaustit. Shihni gjithashtu “Fuqia e shoqërisë civile në një kohë gjenocidi: Punimet e Sinodit të Shenjtë të Bullgarisë. Kisha Ortodokse për Shpëtimin e Hebrenjve në Bullgari 1940-1944”. (<http://jews.archives.bg/jews/uploaded_files/The_Power_Of_Civil_Society_In_A_Time_Of_Genocide.pdf>).
- Librat e historisë së përbashkët “Lufta e Dytë Botërore”, të botuara dhe në gjuhën shqipe (<http://jointhistory.net/>), nxisin zhvillimin e aftësive të mendimit kritik te nxënësit dhe janë një koleksion unik i burimeve historike nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Qëllimi kryesor i tyre është të tregojnë se çdo histori ka këndvështrime të shumëfishta, që të luftosh paragjykimet duhet të njohësh historinë dhe kulturën e një populli me qëllim që të kuptojmë se sa të ndryshëm dhe të njëjtë jemi njëkohësisht.

Materiale për fushën “Njohuri pedagogjike”

- Amnesty International “Right Here Right Now: Mësimi i qytetarisë përmes të drejtave të njeriut” (<<https://www.amnesty.org/en/documents/sec01/015/2009/en/>>) ofron ide dhe burime mësimore me një seri prej 12 mësimesh që mbulojnë një sërë çështjesh.
- Agjencia Kombëtare Suedeze për Arsimin (<<https://www.skolverket.se/>>) ofron materiale në internet për të zhvilluar të kuptuarit e ndërtimit të mjedisve arsimore gjithëpërfshirëse, dhe gjithashtu ofron një mjet online për stafin, për të shqyrtuar dhe për të analizuar situatën e shkollës në lidhje me racizmin dhe ksenofobinë.
- New York Times “26 mini-filma të për të eksploruar racën, paragjykimet dhe identitetin me nxënësit” (<<https://www.nytimes.com/2017/03/15/learning/lesson-plans/25-mini-films-for-exploring-race-bias-and-identity-with-students.html>>) ofron një paketë mjetesh didaktike të dobishme për eksplorimin e aspekteve të ndryshimit në mënyra dinamike përmes një sërë çështjesh.
- The Czech NGO People in Need (<<https://www.jsns.cz/en/home>>) drejton programe arsimore dhe zhvillon burime për të luftuar paragjykimet dhe ksenofobinë.
- “7 hapa për të zbutur paragjykimet e pandërgjegjshme në mësimdhënie dhe në procesin e të nxënit” (<<https://www2.le.ac.uk/departments/physics/people/equality/Documents/7-steps-to-mitigating-unconscious-bias-in-teaching-and-learning/view>>)

nga R. Muneer, D. Cotton & J. Winter, është një përmbledhje shumë e dobishme, e shkurtër por sistematike nga Universiteti Plymouth, e strategjive kryesore për kundërshtimin e paragjytimeve të pavetëdijshme.

- Expo (<<https://expo.se/what-expo>>) është një organizatë suedeze që merret me racizmin bashkëkohor që, ndër të tjera, ofron leksione për mësuesit se si të trajtojnë konspiracionin në klasë.
- Programi Irlandez Yellow Flag (<<http://yellowflag.ie/>>) ofron materiale në internet dhe skema të strukturuar të punës për nxënësit e arsimit bazë dhe të mesëm për të eksploruar dhe për të zhvilluar vlerësimin aktiv të diversitetit bashkëkohor.
- Zentrum Polis Politik Lernen in der Schule (<<https://www.politik-lernen.at/site/praxis/unterrichtsideen>>) është një organizatë austriake që ofron një bazë të dhënash në internet me ide mësimesh për temat e edukimit politik, duke përfshirë të drejtat e njeriut, diskriminimin dhe racizmin.
- Programi Canadian Choose Your Voice (<<https://www.chooseyourvoice.ca/>>) ofron burime mësimore në internet për të ndihmuar nxënësit të flasin kundër racizmit, antisemitizmit dhe intolerancës.
- “Klasa e ndryshimeve” The Anti-Defamation League’s (<https://www.adl.org/who-we-are/our-organization/signature-programs/a-world-of-difference-institute/classroom?_ga=1.152577849.1662775936.1475773635>) ofron edukim kundër paragjytimeve dhe promovon respektin, gjithë përfshirjen dhe civilizimin.
- Moduli “Përballja me diskriminimin” i Anne Frank House’s “Stories “Tregime që lëvizin” (<<https://www.annefrank.org/en/education/product/33/stories-that-move-english/>>) përmban tri mësimet për të ndihmuar nxënësit të eksplorojnë këtë çështje në mënyra ndërvepruese dhe dinamike. Rëndësi të veçantë kanë pjesët “Shtigjet e zmadhimit dhe zbritjes” dhe “Pesë skenarët: Mbi ju”.
- The Living History Forum (<<https://www.levandehistoria.se/english>>), një agjenci kombëtare suedeze, zhvillon burime dhe materiale për mësimin e tolerancës, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, duke përdorur si pikënisje Holokaustin dhe krime të tjera kundër njerëzimit.
- Konferenca Gjermane e Ministrive të Arsimit dhe Këshilli Qendror i Hebrenjve kanë prodhuar materiale mësimore mbi historinë hebraike dhe antisemitizmin në Evropë (<<https://www.kmk-zentralratderjuden.de/>>) që mund të përdoren për edukimin qytetar në shkollë dhe jashtë saj.
- Fondacioni EVZ (<<https://www.stiftung-evz.de/start.html>>), me seli në Berlin, prodhon një sërë materialesh të fokusuara në shqyrtimin kritik të historisë, të drejtave të njeriut dhe kujtimit të viktimave të socializmit.
- CEJI – Një Kontribut Hebre për një Evropë Gjithëpërfshirëse (<<https://ceji.org/>>)

• ofron mundësi arsimimi dhe trajnimit për të zhvilluar respektin dhe diversitetin, burime për përballje me antisemitizmin në internet(<<https://ceji.org/webinar-on-antisemitic-hate-speech-with-john-mann-mp/>>).

- Erinnern.at Nationalsozialismus und Holocaust: Gedachtnis und Gegenwart Gegenwart (<<http://www.erinnern.at/bundeslaender/oesterreich>>) është një organizatë austriake që prodhon materiale studimore dhe plane mësimore për mësimdhënien rreth Holokaustit, gjenocidit rom dhe sinti, si dhe manifestimeve bashkëkohore të antisemitizmit.
- IHRA ka prodhuar materiale edukative për mësimdhënien rreth Holokaustit (<<https://www.holocaustremembrance.com/resources/educational-materials>>). Burime të dobishme janë të disponueshme nëpërmjet faqes së internetit të Qendrës UCL për Edukimin e Holokaustit (<<https://www.holocausteducation.org.uk/>>).
- Burimet e Muzeut Përkujtimor të Holokaustit të Shteteve të Bashkuara për mësuesit (<<https://www.ushmm.org/educators>>) përfshijnë plane mësimore dhe materiale dhe udhëzime të gjera kurrikulare për adresimin e antisemitizmit. (<<https://www.ushmm.org/educators/teaching-about-the-holocaust/general-teaching-guidelines>>) (<<https://www.ushmm.org/confront-antisemitism>>) dhe për adresimin e Holokaustit (<<https://www.ushmm.org/educators/lesson-plans>>).
- Programi i trajnimit Pestalozzi i Këshillit të Evropës "Nga kujtimi i Holokaustit në parandalimin e radikalizimit dhe krimeve kundër njerëzimit" (<<https://www.coe.int/en/web/pestalozzi/prev2-module>>) mbulon një numër të gjerë me tema shumë të vlefshme, duke përfshirë mënyrën se si mësuesit mund të trajtojnë paragjykimet dhe stereotipitë përmes praktikës së tyre.
- Mémorial de la Shoah ofron udhëzime të dobishme (<<http://www.memorialdelashoah.org/en/education-training/pedagogical-notes/secondary-school.html>>) se si të trajtohen aspektet kryesore të historisë së Holokaustit me nxënësit, si dhe një sërë materialesh online dhe seminare praktike mbi të gjitha aspektet e Holokaustit.
- Fondacioni Hungarez Haver (<<http://haver.hu/english>>) punon me shkollat e mesme dhe universitetet për të luftuar paragjykimet dhe diskriminimin dhe për të promovuar kohezionin social përmes dialogut midis hebrenjve dhe jo hebrenjve, trajnimit, arsimimit dhe advokimit.
- Akademia Mbretërore Wootton Bassett, në Mbretërinë e Bashkuar, ka zhvilluar një Program Edukimi për Holokaustin dhe Gjenocidin (<<https://www.rwba.org.uk/information/holocaust-and-genocide/programme/>>), i cili trajton antisemitizmin dhe çështje të tjera, të tilla si përdorimet e stereotipive të gjuhës.

- Shumë muze ofrojnë burime shumë të vlefshme që mund të konsultohen në vend ose në internet nga mësuesit dhe nxënësit për të zhvilluar njohuri dhe kuptim të jetës, traditave dhe kulturës hebraike, si dhe atyre të grupeve të tjera. Muzeu POLIN i Historisë së Hebrenjve Polakë (<<https://www.polin.pl/en/about-the-museum>>), në Varshavë, paraqet historinë 1000-vjeçare të hebrenjve polakë, si dhe burime për t'u përballur me stereotipitë dhe burime për të sfiduar ksenofobinë dhe paragjykimet nacionaliste; Muzeu i Trashëgimisë Hebraike (<<https://mjhnyc.org/>>), në Nju Jork; Muzeu Hebre në Pragë (<<https://www.jewishmuseum.cz/>>); Muzeum Rómské Kultury (Muzeu i Kulturës Rome, <<https://www.rommuz.cz>>), në Brno, Republika Çeke Muzeu Hebre në Londër, Bordi i Deputetëve të Hebrenjve Britanikë ka krijuar një ekspozitë të lëvizshme udhëtuese të quajtur "Përvoja të jetesës së hebrenjve" (<<https://www.bod.org.uk/issues/education/>>).
- Shumë muze dhe vende përkujtimore ofrojnë burime të shkëlqyera në vend dhe në internet për të ndihmuar mësuesit dhe nxënësit të eksplorojnë Holokaustin, për shembull, Yad Vashem (<<https://www.yadvashem.org/holocaust.html>>); Holokaust Memorial Muzeum i Shteteve të Bashkuara (<<https://www.ushmm.org/learn>>); Muzeu Kombëtar i Holokaustit në Amsterdam (<<https://jck.nl/nl/locatie/nationaal-holocaust-museum>>); dhe Muzeu i pushtimit të Letonisë (<<http://okupacijasmuzejs.lv/en/education/>>). Biblioteka Wiener Holocaust, Londër, ofron një listë të dobishme të muzeve dhe të vendeve përkujtimore të Holokaustit. (<<https://www.wienerlibrary.co.uk/holocaust-museums-memorials>>)
- Burimet e Anne Frank House's "Stories that Move" (<<https://www.annefrank.org/en/education/product/33/stories-that-move-english/>>) "Mësimi i medias" dhe "Marrja e vendimeve" ofrojnë strategji shumë të dobishme ndërvepruese për t'u mundësuar të rinjve të ndërtojnë arsimim mediatik.
- Mësimi Teaching Tolerance's "Analyzing How Words Communicate Bias" (<<https://www.tolerance.org/classroom-resources/tolerance-lessons/analyzing-how-words-communicate-bias>>) dhe materialet shoqëruese ofrojnë strategji të dobishme për të eksploruar se si përdorimi i gjuhës kodon paragjykimet dhe pozicionon negativisht tjetrin.
- Materialet online të arsytimit qytetar të Stanford History Education Group (<<https://sheg.stanford.edu/civic-online-reasoning>>) dhe punimet (<<https://purl.stanford.edu/fv751yt5934>>), ofrojnë qasje novatore dhe të bazuara në kërkime për edukimin kritik mediatik.

- Ka shumë faqe interneti të shkëlqyera që eksplorojnë të menduarit kritik, duke përfshirë Fondacionin për Mendimin Kritik (<<https://www.criticalthinking.org/>>); P4C Co-operative (<<https://p4c.com/>>); Universitetin e Projektit të Mendimit Kritik në Queensland (<<https://critical-thinking.project.uq.edu.au/home>>) dhe Konsorciumin Kanadez të Mendimit Kritik (<<https://tc2.ca/>>).
- ODIHR ka krijuar materiale që mund të ndihmojnë politikëbërësit dhe mësuesit në trajtimin e antisemitizmit, të tilla si Adresimi i antisemitizmit: Pse dhe si? Një udhëzues për mësuesit (<<https://www.osce.org/odihr/29890>>).
- UNESCO ka hartuar udhëzime të ndryshme për politikëbërësit, mësuesit dhe të gjitha palët e tjera të interesuara se si të ndërtohet elasticiteti i nxënësve ndaj ideologjive të dhunshme ekstremiste, paragjykimeve dhe të gjitha formave të diskriminimit. Këto përfshijnë një udhëzues për politikëbërësit (<<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000247764>>) dhe udhëzues për mësuesit (<<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000244676>>) mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm përmes arsimit, si dhe botimet “Edukimi global i qytetarisë (<<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000232993>>) dhe “Kundërshtimi i gjuhës së urrejtjes në internet (<<http://wayback.archive-it.org/10611/20160803083440/http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002332/233231e.pdf>>). UNESCO ka botuar më tej një udhëzues për politikëbërësit mbi edukimin rreth holokaustit dhe parandalimin e gjenocidit (<<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000248071>>), si dhe broshurën “Pse mësojmë rreth Holokaustit?”. (<<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000218631>>).
- Kurrikula e historisë në arsimin parauniversitar në Shqipëri (programi i klasave 8; 9; 10; 11) jep udhëzime për përmbajtjen dhe mënyrën se si mësuesi të trajtojë aspektet kryesore të historisë së Holokaustit me nxënësit.

b) Qasje të bazuara në skenar për trajtimin e antisemitizmit

Materialet që vijojnë ofrojnë (a) sugjerime metodologjike për zhvillimin e aktiviteteve duke përdorur skenarë (rast studimor/situata) për të diskutuar dhe analizuar incidente të mundshme kritike dhe (b) 13 modele skenarë (raste studimore/situata) për të eksploruar çështjet e anësive, paragjykimeve, intolerancës dhe antisemitizmit.

Skenarët e renditur më poshtë si ilustrime, prezantojnë episode reale të raportuara në shtyp. Rekomandohet që trajnerët të përshtatin dhe të përdorin skenarët që janë të përshtatshëm për kontekstet e tyre të veçanta, për të nxitur diskutimin midis mësuesve gjatë trajnimit në sallë. Skenarët përfaqësojnë thirrje të mundshme për veprim në situata komplekse dhe, në këtë mënyrë, kërkojnë që mësuesit të reflektojnë mbi to, të analizojnë situatat dhe të diskutojnë mbi përgjegjësitë e tyre personale dhe profesionale. Së fundi, ata duhet të mendojnë për llojet e veprimeve që janë më të përshtatshme në secilin rast, pasi këto meritojnë reflektim dhe shqyrtim të hollësishëm. Mësuesit duhet të inkurajohen të mendojnë në mënyrë kritike për situatat që modelojnë skenarët dhe të marrin në konsideratë një sërë pyetjesh, si në vijim:

1. A ka anësi, paragjykime apo çështje të tjera për t'u trajtuar në këtë rast?
2. Cila është natyra e problemit? A është, për shembull, një rast i qartë i antisemitizmit të hapur apo një çështje e stereotipizimit të pavetëdijshëm ose jo reflektues?
3. Sa të drejtat dhe interesat e njerëzve ndikohen nga ajo që po ndodh në këtë skenar? Çfarë është në rrezik dhe për kë?
4. A ka viktima të anësive dhe të paragjykimeve në këtë rast dhe interesat e kujt është më e domosdoshme që mësuesi të mbrojë në këtë rast?
5. Përtej njerëzve të përfshirë direkt në incident, interesat e kujt tjetër janë në rrezik? Nëse nuk jepen përgjigjet e duhura a mund të ndikojë ose të rrezikojë të ndikojë ky incident, në kulturën dhe moralin e shkollës?
6. Çfarë lloj veprimi duhet të ndërmerret për incidentin – veprim mbrojtës i menjëhershëm afatshkurtër, ose një përgjigje më e vonë, afatgjatë, si ndryshimi i kurrikulës apo ndonjë kombinim i të dyjave?
7. Cilat janë kostot dhe përfitimet si nga veprimi ashtu edhe nga mosveprimi, dhe cilat veprime ose mosveprime janë më të përshtatshme në këto rrethana?
8. Çfarë sfidash dhe çfarë mundësish paraqet incidenti? (Përveç rreziqeve që mund të kenë nevojë të adresohen urgjentisht, incidenti mund të krijojë mundësi për të pasur ndikime pozitive nëpërmjet përgjigjeve afatgjata.)
9. Kush është më i përshtatshëm për t'u përgjigjur – ata në kontekstin e menjëhershëm të incidentit, kolegët e tjerë në shkollë, kolegët jashtë shkollës, apo ndonjë kombinim i të gjitha këtyre?

10. Kush tjetër duhet të përfshihet që besimi në institucion të krijohet, të rikthehet, të ruhet ose të rritet përmes reagimit ndaj incidentit?

Adresimi i skenarëve në mënyrë sa më efektive kërkon gjithashtu përdorimin e gjuhës modale dhe të kushtëzuar – duke marrë parasysh se çfarë mund, çfarë duhet dhe/ose çfarë duhet bërë ose jo në një situatë të caktuar.

Ai gjithashtu përfshin marrjen në konsideratë të veprimeve zinxhirë të kushtëzuar (nëse/atëherë) si p.sh.: - "Nëse X është bërë, atëherë çfarë ka të ngjarë të ndodhë më pas?" dhe "Nëse X nuk është bërë, cilat janë pasojat për Y dhe Z?"

Shembujt e skenarëve më poshtë janë krijuar për të mbështetur këtë lloj reflektimi dhe për të identifikuar gamën e kompleksitetit brenda antisemitizmit, i cili mund të jetë i pranishëm në shkolla. Këto situata mund të përdoren në seminare të trajnimit të mësuesve në shumë mënyra:

- Grupeve të ndryshme mund t'u jepen të njëjtat skenarë për t'iu përgjigjur nga e njëjta perspektivë dhe më pas u kërkohet të ndajnë dhe të krahasojnë përgjigjet dhe perceptimet e tyre.
- Grupeve të ndryshme mund t'u jepen të njëjtat skenarë, por u kërkohet të reflektojnë mbi aspekte të ndryshme të tyre ose nga këndvështrime të ndryshme brenda tyre, për shembull, çfarë është në rrezik për persona të ndryshëm të përfshirë në skenar?
- Grupeve të ndryshme mund t'u jepen skenarë të ndryshëm dhe t'u kërkohet t'i përdorin ato për të reflektuar mbi parimet e përgjithshme, për shembull, hartimin e një politike të gjithë shkollës për të trajtuar paragjykimet.
- Grupeve të ndryshme mund t'u jepet e njëjta përzgjedhje skenarësh dhe t'u kërkohet t'i renditin ose t'i klasifikojnë ata, për shembull, për sa i përket rëndësisë të sfidave që ata ngrenë ose për sa i përket kohës së zgjidhjes së tyre. (Kërkojnë një afat të menjëhershëm ose afatgjatë; një përgjigje disiplinore ose një përgjigje jo disiplinore.).
- Pasi kanë studiuar disa skenarë, grupeve mund t'u kërkohet të zhvillojnë një skenar që lidhet me kontekstin e tyre, duke u mbështetur në përvojën personale ose atë të shkollës së tyre.

Për të gjitha këto raste, sugjerohet që të bëhet diskutim në grupe të vogla për detyrat e dhëna nga trajneri dhe më pas reflektimi të bëhet për të gjithë grupin mbi qasjet dhe vendimet që kanë marrë grupe të ndryshme. Më pas trajneri, duke nënvizuar parimet e përgjithshme, bën një përmbledhje të të gjitha diskutimeve.

Numri	Skenarët
01	Një mësuese e lëndëve shoqërore udhëzohet nga shkolla e saj që të mësojë rreth judaizmit duke përdorur literaturën që ofron shkolla. Ajo ka rezerva për burimet që ofron shkolla. Këto burime fokusohen ekskluzivisht në judaizmin ortodoks. Të gjitha imazhet e popullit hebre janë imazhe të burrave, ka referenca për mënyrat se si njerëzit hebrej janë stereotipizuar me kalimin e kohës, por këto stereotipi vetëm përmenden dhe nuk sfidohen. <i>Çfarë veprimi duhet të marrë ajo për të trajtuar problemet me literaturën shkollore që kolegët e saj e kanë udhëzuar të përdorë?</i>
02	Një mësues, i cili sapo ka përfunduar një kurs trajnimi për antisemitizmin, ka vënë re mbishkrime antisemite në një mur rrethues të shkollës, duke përfshirë simbole të urrejtjes (p.sh., “88”^[126]). Ai e ka parë drejtorin e shkollës dhe nxënësit të kalojnë aty disa herë gjatë rrugës për në shkollë. Mbishkrimet janë aty prej disa javësh. Mësuesi ia tregon këtë kolegut të tij, i cili përgjigjet duke thënë se kjo është një gjë është e zakonshme. <i>Çfarë veprimesh duhet të ndërmarrë mësuesi për të zgjidhur këtë situatë?</i>
03	Dy shokë/shoqe po grinden në pjesën e pasme të klasës. Shkaku i grindjes ishte që njërit prej nxënësve (i cili ka një baba hebre) i thuhet nga nxënësi tjetër (i cili nuk është hebre) “të piqesh në furrë, hebre”. Nxënësi të cilit i është drejtuar komenti, nuk shfaq asnjë shenjë mërzie. <i>Si duhet t'i përgjigjet një mësues kësaj situatë?</i>

[126] “88” është simbol nazist, kod numerik i supremacisë së bardhë i përdorur për “Heil Hitler”.

Numri	Skenarët
04	Një nxënës vizaton simbole naziste në librat e tij. Ai është paralajmëruar disa herë që të mos e bëjë këtë, gjithashtu ai ka marrë njohuri për Holokaustin në shkollë. Ai nuk shfaq probleme me shokët e tij të klasës dhe ata e duan atë. <i>Çfarë veprimesh duhet të ndërmerret mësuesi në këtë rast?</i>
05	Në përfundim të periudhës, ju jepet nga drejtoria e shkollës, detyra e mëposhtme: "Shpjegoni pse disa njerëz paragjykojnë kundër hebrenjve". Ju jeni udhëzuar nga drejtoria e shkollës që t'i vlerësoni nxënësit vetëm në lidhje me këtë detyrë. <i>Si duhet të reagoni si mësues?</i>
06	Dy kolegë mësues në ekipin tuaj lëndor (njëri prej të cilëve është hebre) shpesh hedhin batuta me njëri –tjetrin me stereotipitë hebreje, të tilla si "kontrollimi i botës" dhe "rrëmbimi i parave". Kjo bëhet me shaka dhe mësuesi hebre ia kthen duke e quajtur mësuesin tjetër "fshatar". <i>Çfarë duhet të bëni ju si mësues?</i>
07	Gjatë një pushimi, dy nxënës po diskutojnë lojën e futbollit të FIFA-s që luajtën kundër njëri-tjetrit në fundjavë në tastierën e tyre PlayStation. Një nxënës vëren se ai e fitoi lojën me dinakëri (gol hebre). Ata të dy qeshin. <i>Si duhet të reagoni ju si mësues i tyre?</i>
08	Televizioni dhe mediat e shkruara raportuan historinë e një politikani vendas, i cili u fye qëllimisht në internet dhe u kërcënua fizikisht në mediat sociale për "të qenët hebre". Publikuesi u ndoq me sukses nga policia dhe u dënua me burg. Megjithatë, disa nxënës janë dëgjuar duke përsëritur në oborrin e shkollës disa nga abuzimet që u publikuan gjatë gjykimit. <i>Si duhet të reagoni si mësues i tyre?</i>

Numri

Skenarët

09

Një i mbijetuar i moshuar i Holokaustit që jeton vetëm pranë shkollës suaj, merr kërcënime me vdekje nga një grup ekstremist. Një natë, një tullë hidhet nga dritarja e tij në katin e poshtëm, shumë pranë tij. Grupi ekstremist merr përgjegjësinë për sulmin, duke deklaruar se ishte një paralajmërim për të ndaluar “gënjeshttrat” që ai ka thënë për Holokaustin. Pas sulmit, të gjitha dritaret e tij ishin të pajisura me rrjetë çeliku dhe shtëpia e tij ishte e mbrojtur me drita dhe alarm sigurie.

Ai tha pas sulmit: “Pasi shpëtova dhe u largova nga kampet, nazistët ende duan të më vrasin”.

Ky ngjarje bëhet lajm në media lokale dhe kombëtare. A duhet të përgjigjeni ju si mësues? Nëse po, si?

10

Një mësues po merr pjesë në një ditë trajnimi, të fokusuar në mësimdhënien rreth Holokaustit. Gjatë pushimit të drekës, ai dëgjon një koleg tjetër që ndjek trajnimin të thotë sa vijon:

“Politikanët dhe liderët luajnë lojëra me përkufizimet dhe më së shumti janë të fokusuar te pushteti. Qeveria izraelite përdor Holokaustin për të siguruar mbështetje për Izraelin nga komuniteti ndërkombëtar, ndërkohë që i trajton palestinezët ashtu siç i trajtuan gjermanët hebrenjtë.

Çfarë duhet të bëjë mësuesi?

11

Një mësues dha mësim rreth antisemitizmit në klasë gjatë javës së kaluar. Mësimet shkuan mirë. Javën tjetër, mësuesi merr një letër nga një prind, i cili pyet: “Pse po fokusohesh kaq shumë te hebrenjtë? Ka edhe shumë minoritete të tjera në vendin tonë që kanë vuajtur po aq shumë. Ne vetë kemi vuajtur po aq keq në të kaluarën.”

Si duhet të përgjigjet mësuesi?

Për kontekstin shqiptar

Dy nxënës po grinden në bankat e fundit të klasës. Shkaku i grindjes është se njërit prej nxënësve (i cili ka një gjyshen hebreje) i thuhet nga nxënësi tjetër (i cili nuk është hebre) “çifut” (shihni aneksin 5). Nxënësi, të cilit i është drejtuar komenti, nuk shfaq asnjë shenjë se ai është i mërzitur.

Si duhet t'i përgjigjet një mësues kësaj situatë?

Nxënësit tuaj lexojnë komentin e mëposhtëm në një tekst:

Inxhinieri Marko Menahem, një bir hebre, në vitin 1986 gjatë një takimi në Tiranë, kur unë përdora fjalën çifut, me tha: Të lutem mos e përdor këtë fjalë për të emëruar popullin tonë. Këtë fjalë na e kanë vendosur arabët për të shprehur përbuzjen e tyre ndaj nesh. Fjala “Çifut” ka një kuptim të ngjashëm me fjalën shqipe “Pufte”, që ju shqiptarët e përdorni për një person të pavlerë.

Fjala hebre / hebreu / hebrenj /hebrenjtë, ose Jude / judeu / judenj / judenjtë, mund të përdoret për popullin tonë për kohën e shkuar, kurse pas formimit të shtetit të Izraelit, për të emëruar banorët e këtij shteti mjafton emri izraelit.

Si do ta drejtonit diskutimin ju si mësues në klasë?

05

MUNDËSI PËR TRAJTIMIN E HOLOKAUSTIT NË KURRIKULËN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË SHQIPËRI

Pse duhet mësuar në shkollë historia e holokaustit?

Historia e Holokaustit [127] prezanton dokumente të gjera dhe efektive për një shqyrtim pedagogjik të çështjeve themelore morale. Një kërkim i strukturuar mbi historinë e Holokaustit jep mësim kritik për një hetim të sjelljes njerëzore. Studimi i Holokaustit i ndihmon nxënësit të bëhen qytetarë të përgjegjshëm që është përmbushja e një nga parimeve kryesore të arsimit.

Nëpërmjet studimit të Holokaustit, nxënësit kuptojnë se:

- Institucionet dhe vlerat demokratike nuk janë të qëndrueshme automatikisht, por duhet të vlerësohen, të edukohen dhe të mbrohen.
- Heshtja dhe indiferenca ndaj vuajtjeve të të tjerëve ose ndaj shkeljes së të drejtave civile në çdo shoqëri, mund të shërbejë megjithëse pa dashje, për të përkeqësuar dhe për të përjetësuar problemet.
- Holokausti nuk ishte një aksident në histori. Ai ndodhi sepse individët, organizatat dhe qeveritë bënë zgjedhje që jo vetëm legalizuan diskriminimin, por që lejuan paragjykimin, urrejtjen dhe vrasjen masive.

Për shkak se synimi i mësimdhënies së çdo lënde është të ngjallë kureshtjen e nxënësve me qëllim që të zhvillojë aftësitë e mendimit kritik, krijues dhe rritjen personale, është e nevojshme që mësuesit e historisë, qytetarisë, letërsisë, arteve kur të hartojnë planet mësimore për Holokaustin, të marrin parasysh disa pyetje:

- Pse nxënësit duhet ta mësojnë këtë histori?
- Cilat janë mësimet kryesore që nxënësit duhet të nxjerrin rreth Holokaustit?
- Pse leximi, imazhi, dokumenti ose filmi është një mjet i përshtatshëm për përcjelljen e mësimave që dëshironi të jepni rreth Holokaustit?

Ndër arsyetimet e ndryshme të ofruara nga mësuesit që kanë përfshirë studimin e Holokaustit në lëndën/t e tyre janë këto:

- Holokausti është një nga ngjarjet më të rënda që ka ndodhur në historinë e njerëzimit.
- Studimi i Holokaustit i ndihmon nxënësit të kuptojnë pasojat e paragjykit, racizmit dhe stereotipive në çdo shoqëri. Ai i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndërgjegjësim për vlerën e pluralizmit dhe inkurajon tolerancën ndaj diversitetit në një shoqëri pluraliste.
- Holokausti ofron një kontekst për të eksploruar rreziqet e të qenit i heshtur, apatik dhe indiferent përballë shtypjes së të tjerëve.

[127] GUIDELINES FOR TEACHING ABOUT THE HOLOCAUST (usf.edu)

- Historia e Holokaustit tregon se si një komb modern mund të përdorë ekspertizën e tij teknologjike dhe infrastrukturën burokratike për të zbatuar politika shkatërruese duke filluar nga inxhinieria sociale deri te gjenocidi.
- Studimi i Holokaustit i ndihmon nxënësit të mendojnë për përdorimin dhe abuzimin e pushtetit, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e individëve, organizatave dhe kombeve kur përballen me shkelje të të drejtave civile, antisemitizmin dhe/ose politika të gjenocidit.
- Nxënësit fitojnë njohuri/aftësi dhe qëndrime mbi shumë faktorë historikë, socialë, fetarë, politikë dhe ekonomikë që rezultuan në Holokaust. Ata fitojnë një perspektivë se si ndodh historia dhe se si një konvergjencë e faktorëve mund të kontribuojë në shpërbërjen e vlerave të qytetërimit. Në një shoqëri demokratike është pjesë e përgjegjësisë së çdo qytetari të mësojë të identifikojë sinjalet e rrezikut dhe të dijë kur të reagojë.

Kur ju, si mësues, merrni kohë për të shqyrtuar qasjen tuaj për mësimin mbi Holokaustin, keni më shumë gjasa të zgjidhni përmbajtje që përkojnë me interesat e nxënësve tuaj dhe që u ofrojnë atyre një kuptim më të qartë të historisë.

Shumë nxënës tregojnë interes për të studiuar Holokaustin pasi kjo temë ngre pyetje të drejtësisë, identitetit individual, presionit të bashkëmoshatarëve, indiferencës dhe bindjes, çështje me të cilat adoleshentët përballen në jetën e tyre të përditshme. Nëpërmjet letërsisë nxënësit habiten nga përmasat e Holokaustit dhe fakti se si kaq shumë njerëz vepronin si bashkëpunëtorë, autorë dhe se si “kalimtarë” lejuan që ky gjenocid të ndodhte duke mos protestuar apo rezistuar.

5.1. Konsiderata metodologjike për mësuesit e lëndëve të historisë, letërsisë, qytetarisë, arteve.

1) Përcaktoni se çfarë kuptoni me "Holokaust".

Holokausti i referohet një ngjarjeje specifike në historinë e shekullit XX: Asgjësimi sistematik, burokratik i gjashtë milionë hebrenjve nga regjimi nazist dhe bashkëpunëtorëve të tyre si një akt qendror i shtetit nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1933 rreth nëntë milionë hebrenj jetonin në 21 vendet e Evropës që do të pushtoheshin nga Gjermania naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Deri në vitin 1945, dy në çdo tre hebrenj evropianë ishin vrarë. Megjithatë hebrenjtë ishin viktimat kryesore, deri në gjysmë milioni ciganë dhe të paktën 250,000 persona me aftësi të kufizuara mendore ose fizike ishin gjithashtu viktimat të gjenocidit. Ndërsa tirania naziste u përhap në të gjithë Evropën nga viti 1933 deri në 1945, miliona njerëz të tjerë të pafajshëm u persekutuan dhe u vranë.

Më shumë se tre milionë robër lufte sovjetike u vranë për shkak të kombësisë së tyre. Polakët, si dhe sllavët e tjerë, u vunë në shënjestër të punës së skllëvërve dhe si rezultat i terrorit nazist, pothuajse dy milionë u vranë. Homoseksualët dhe të tjerët që konsideroheshin "antisocialë" gjithashtu u persekutuan dhe shpesh u vranë. Për më tepër, mijëra disidentë politikë dhe fetarë si komunistë, socialistë, sindikalistë u persekutuan për bindjet dhe sjelljet e tyre dhe shumë nga këta individë vdiqën si rezultat i keqtrajtimit.

2) *Shmangni krahasimet e dhimbjes.*

Një studim i Holokaustit duhet të nxjerrë në pah gjithmonë politikat e kryera nga regjimi nazist ndaj grupeve të ndryshme të njerëzve. Këto dallime nuk duhet të paraqiten si bazë për krahasimin e vuajtjeve ndërmjet tyre. Shmangni përgjithësimet që sugjerojnë ekskluzivitete, të tilla si "viktimat e Holokaustit vuajtën mizorinë më të madhe të hasur ndonjëherë nga një popull në historinë e njerëzimit". Nuk mund të supozohet se tmerri i një individi, familjeje apo komuniteti të shkatërruar nga nazistët ishte më i madh se ai i përjetuar nga viktimat e gjenocideve të tjera.

3) *Shmangni përgjigjet e thjeshta për historinë komplekse.*

Një studim i Holokaustit ngre pyetje të vështira rreth sjelljes njerëzore dhe shpesh përfshin përgjigje të ndërlikuara se përse ndodhën ngjarjet. Lërimi nxënësit të mendojnë për faktorët e ndryshëm që kontribuan në Holokaustin; mos u përpiqni ta reduktoni historinë e Holokaustit në një ose dy katalizatorë të veçuar nga faktorët e tjerë që hynë në lojë. Holokausti nuk ishte thjesht pasoja logjike dhe e pashmangshme e racizmit të shfrenuar. Përkundrazi, racizmi, i kombinuar me fanatizmin shekullor, i ripërtërirë nga një zjarr nacionalist që u shfaq në Evropë në gjysmën e dytë të shekullit XIX, i nxitur nga disfata e Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore, vendimet e Traktatit të Versajës, kohët e vështira ekonomike, paefektshmëria e Republikës së Vajmarit dhe indiferenca ndërkombëtare e ndjekur nga karizma politike, gjithëpërfshirja militariste dhe propaganda manipuluese e regjimit nazist të Adolf Hitlerit, kontribuan në ngjarjet e Holokaustit.

4) *Vetëm për shkak se ndodhi, nuk do të thotë se ishte e pashmangshme.*

Shumë shpesh, nxënësit kanë përshtypjen se Holokausti ishte i pashmangshëm. Vetëm se ka ndodhur një ngjarje historike dhe është dokumentuar në tekste dhe filma, nuk do të thotë se duhej të ndodhte. Ky koncept në dukje i dukshëm shpesh anashkalohet nga nxënësit dhe mësuesit. Holokausti ndodhi sepse individët, grupet dhe kombet morën vendime për të vepruar ose jo. Duke u fokusuar në ato vendime, ne fitojmë njohuri për historinë dhe natyrën njerëzore dhe mund t'i ndihmojmë më mirë nxënësit tanë që të bëhen mendimtarë kritikë.

5) *Përpiquni për saktësinë e gjuhës.*

Çdo studim i Holokaustit prek nuancat e sjelljes njerëzore. Për shkak të kompleksitetit të historisë, ekziston një tundim për të përgjithësuar dhe në këtë mënyrë për të shtrembëruar faktet (p.sh., "të gjitha kampet e përqendrimit ishin qendra vrasjesh" ose "të gjithë gjermanët ishin bashkëpunëtorë"). Përkundrazi, mësuesit duhet të përpiqen t'i ndihmojnë nxënësit të bëjnë dallimin midis kategorive të sjelljes dhe referencave historike përkatëse, për të sqaruar dallimet midis paragjykitimit dhe diskriminimit, bashkëpunëtorëve dhe kalimtarëve, rezistencës së armatosur dhe shpirtërore, urdhrave të drejtpërdrejta dhe urdhrave të marra, kampeve të përqendrimit dhe qendrave të vrasjes, si dhe fajit dhe përgjegjësisë.

Fjalët që përshkruajnë sjelljen njerëzore shpesh kanë kuptime të shumëfishta. Rezistenca, për shembull, zakonisht i referohet një akti fizik të revoltës së armatosur. Gjatë Holokaustit, ajo nënkuptonte gjithashtu aktivizimin partizan që varionte nga kontrabanda e mesazheve, ushqimeve dhe armëve deri te angazhimi ushtarak. Por, rezistenca përqafoi edhe mosbindjen e qëllimshme: vazhdimi i praktikimit të traditave fetare dhe kulturore në kundërshtim me rregullat; krijimi i artit të bukur, muzikës dhe poezive brenda getove dhe kampeve të përqendrimit. Për shumë njerëz, thjesht ruajtja e vullnetit për të mbetur gjallë përballë brutalitetit të tmerrshëm ishte akti më i sigurt i rezistencës shpirtërore.

6) *Bëni dallime të kujdesshme për burimet e informacionit.*

Nxënësit kanë nevojë për praktikë në dallimin ndërmjet faktit, opinionit dhe trillimit; ndërmjet burimeve parësore dhe dytësore, dhe midis llojeve të provave si dëshmitë gjyqësore, historitë gojore dhe dokumente të tjera të shkruara. Hermeneutika, shkenca e interpretimit, duhet të përdoret për të ndihmuar nxënësit në analizën e burimeve. Nxënësit duhet të inkurajohen të marrin në konsideratë pse u shkrua një tekst i caktuar, kush ishte audienca e synuar, nëse kishte ndonjë paragjykim të natyrshëm në informacion, ndonjë boshllëk në diskutim, nëse boshllëqet në fragmente të caktuara ishin të paqëllimshme apo jo, dhe si përdoret informacioni për të interpretuar ngjarje të ndryshme.

Për shkak se studiuesit shpesh i bazojnë kërkimet e tyre në burime të ndryshme informacioni, mund të shfaqen interpretime të ndryshme të historisë. Për rrjedhojë, të gjitha interpretimet i nënshtrohen vlerësimit analitik. Vetëm duke përpunuar "hermeneutikën e dyshimit", nxënësit mund të bëhen lexues që dallojnë dallimin midis studiuesve legjitimë që paraqesin interpretime historike konkurruese dhe atyre që shtrembërojnë ose mohojnë faktet historike për përfitime personale ose politike.

7) Mundohuni të shmangni përshkrimet stereotipike.

Megjithëse të gjithë hebrenjtë u shënjestruan për shkatërrim nga nazistët, përvojat e të gjithë hebrenjve nuk ishin të njëjta. Pikëpamjet e thjeshtuara dhe stereotipitë ndodhin kur grupet e njerëzve shihen si të njëanshëm në qëndrime dhe në veprime. Mënyra se si grupet etnike ose grupet sociale etiketohen dhe portretizohen në shkollë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si nxënësit i perceptojnë ato në jetën e tyre të përditshme. Kujtojeni nxënësve tuaj se megjithëse anëtarët e një grupi mund të ndajnë përvoja dhe besime të përbashkëta, përgjithësimet rreth tyre, pa përfitimin e termave modifikues ose cilësues (p.sh., "ndonjëherë", "zakonisht", "në shumë raste, por jo të gjitha") priren të stereotipizojnë sjelljet në grup dhe të shtrembërojnë realitetin historik. Kështu, të gjithë gjermanët nuk mund të karakterizohen si nazistë dhe asnjë kombësi nuk duhet të reduktohet në një përshkrim apo në një dimension të vetëm.

Nëse në diskutimet në klasë shfaqet një stereotip specifik antisemitik, është e nevojshme të trajtohet. Së pari diskutoni modelet e stereotipizimit përpara se të diskutoni stereotipin specifik, historikun dhe origjinën e tij. Shpjegimi i stereotipave në përgjithësi dhe eksplorimi i përdorimit të tyre janë më të dobishëm sesa përfshirja në argumente. Duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet fakteve dhe opinioneve. Ekzistojnë dy lloje të stereotipave: njëra bazohet në fantazi të pastër, siç është ideja e "Komploti i botës hebreje" ose kontrolli i mediave botërore ose i sistemeve financiare të botës; tjetri përgjithëson dhe shtrembëron fragmente të realitetit. Shfaqja e shtrembërimit të atyre stereotipave mund të jetë një mënyrë e suksesshme për të çmontuar këto perceptime ndaj hebrenjve. Për shembull, nëse hebrenjtë perceptohen si të spikatur në një profesion të caktuar, ky fakt nuk duhet të nënkuptojë automatikisht kontrollin hebre mbi atë fushë dhe as nuk do të thotë që hebrenjtë nga natyra janë të kualifikuar ose të pakualifikuar për disa profesione. Nuk ka asnjë ndryshim midis profesionistëve hebrenj dhe jo hebrenj në çdo fushë të caktuar.

8) Krahasoni stereotipat me qasjet e tjera ndaj identitetit.

Mësuesit duhet t'u kërkojnë nxënësve të tyre të reflektojnë mbi identitetet e tyre të ndryshme. Pyetini nxënësit se kush janë ata duke marrë parasysh gjininë, fenë, kulturën, gjuhën dhe origjinën, por gjithashtu dhe pasionet e tyre, si interesat, prirjet, aftësitë. Kështu, nxënësit mësojnë se njerëzit janë të ndryshëm dhe zbulojnë se askush nuk mund të reduktohet në një dimension të vetëm. Ndërsa socializimi padyshim ndikon në identitetet tona, individët gjithashtu mund të angazhohen në mënyrë aktive dhe të përcaktojnë se kush janë ata. Kuptimi i konceptit "identitet" i ndihmon nxënësit të kuptojnë mekanizmin e pranimi dhe të përjashtimit, pra i ndarjes së njerëzve në "ne" dhe "ata".

9) Mos e romantizoni historinë për të tërhequr interesin e nxënësve.

Në mësimin e Holokaustit saktësia e faktit duhet të jetë përparësia e mësuesit. Njerëzit që rrezikuan jetën e tyre për të shpëtuar viktimat e shtypjes naziste, ofrojnë modele të dobishme dhe të rëndësishme për nxënësit, megjithatë një theksim i tepruar i tregimeve heroike mbi Holokaustin rezulton në një përshkrim të pasaktë dhe të pabalancuar të historisë. Është e rëndësishme të dihet se nën pushtimin nazist, "në rastin më të mirë, më pak se gjysma e një për qind të popullsisë totale (të jo hebrenjve) ndihmuan për të shpëtuar hebrenjtë". [Oliner dhe Oliner, 1991, f. 363]

10) Kontekstualizoni historinë.

Ngjarjet e Holokaustit dhe veçanërisht mënyra se si individët dhe organizatat silleshin në atë kohë, duhet të vendosen në një kontekst historik në mënyrë që nxënësit të kuptojnë rrethanat që inkurajuan ose dekurajuan këto akte. Kufizoni qasjen tuaj ndaj ngjarjeve specifike dhe akteve të bashkëpunimit ose të kundërshtimit duke marrë parasysh se kur dhe ku ka ndodhur një akt; pasojat e menjëhershme për veten dhe familjen e viktimave që ndihmojnë; shkalla e kontrollit që kishin nazistët mbi një vend ose popullsi lokale; qëndrimet historike-kulturore të popullsisë të ndryshme vendase karshi grupeve të ndryshme të viktimave dhe disponueshmëria, efektiviteti dhe rreziku i vendeve të mundshme të fshehjes.

Nxënësve duhet t'u sillet në vëmendje se individët dhe grupet jo gjithmonë përshtaten në të njëjtat kategori të sjelljes. Pra të njëjtët njerëz nuk kanë vepruar gjithmonë si "kalimtarë", "bashkëpunëtorë", "autorë" apo "shpëtimtarë". Individët dhe grupet sillen ndryshe në varësi të ndryshimit të ngjarjeve dhe të rrethanave. I njëjti person, i cili në vitin 1933 mund të kishte mbetur i pa përfshirë ndërsa ishte dëshmitar i diskriminimit social të hebrenjve, më vonë mund të bëhej bashkëpunëtor ose mund të kundërshtonte dhe të vepronte në mbrojtje të miqve dhe të fqinjëve hebrenj.

Inkurajoni nxënësit që të mos i kategorizojnë grupet e njerëzve vetëm në bazë të përvojave të tyre gjatë Holokaustit: kontekstualizimi është thelbësor në mënyrë që viktimat të mos perceptohen vetëm si viktima. Megjithëse hebrenjtë ishin viktimat qendrore të regjimit nazist, ata kishin një kulturë të gjallë dhe një histori të gjatë në Evropë para epokës naziste. Duke iu treguar nxënësve disa prej kontributeve dhe arritjeve kulturore të dy mijë viteve të jetës hebreje evropiane, ju i ndihmoni ata të balancojnë perceptimin e tyre për hebrenjtë si viktima dhe të vlerësojnë më mirë

traumën në historinë hebraike të shkaktuar nga Holokausti.

Në mënyrë të ngjashme, nxënësit mund të dinë shumë pak për ciganët, përveç imazheve negative dhe përshkrimeve nënçmuese të shpallura nga nazistët. Nxënësit do të përfitonin nga një këndvështrim më i gjerë, duke mësuar për historinë dhe kulturën e ciganëve dhe duke kuptuar mënyrat e ndryshme të jetesës midis grupeve të ndryshme të ciganëve.

11) Përkthejini statistikën në njerëz.

Në çdo studim të Holokaustit, mësuesit duhet të tregojnë se pas statistikave qëndrojnë njerëz me familje, prindër, fëmijë dhe gjyshër. Rrëfimet në vetën e parë dhe kujtimet u ofrojnë nxënësve një mënyrë për t'u dhënë kuptim numrave kolektivë, duke u zhvendosur “nga një mori statistikash, vendesh dhe ngjarjesh të largëta, te drama “personale”. [Totten, 1987, f. 63].

12) Jini të ndjeshëm ndaj përmbajtjes së shkruar dhe audio-vizuale.

Një nga shqetësimet kryesore të mësuesve është se si t'i prezantojnë nxënësit me tmerret e Holokaustit. Materiali grafik duhet të përdoret në mënyrë të arsyeshme dhe vetëm në masën e nevojshme për të arritur rezultatet e mësimit. Mësuesit duhet t'i kujtojnë vetes se çdo nxënës dhe çdo klasë është e ndryshme dhe se ajo që duket e përshtatshme për një mund të mos jetë për të gjithë.

Nxënësit janë një “audiencë e robëruar”. Kur i sulmojmë me imazhe tmerri për të cilat ata janë të papërgatitur, ne shkelim një besim themelor: detyrimin e një mësuesi për të ofruar një mjedis të sigurt mësimor. Supozimi se të gjithë nxënësit do të kuptojnë sjelljen njerëzore pasi të jenë ekspozuar ndaj imazheve të tmerrshme, është i gabuar. Disa nxënës mund të tmerrohen aq shumë nga imazhet e brutalitetit dhe vrasjeve masive sa që nuk duan të studiojnë më tej për këtë temë. Shumë ngjarje dhe vepra që ndodhën në kontekstin e Holokaustit, nuk mbështeten për përshkrimin e tyre drejtpërdrejt në tmerrin grafik të vrasjeve masive apo barbarizmave të tjera. Rekomandohet që imazhet dhe tekstet që nuk shfrytëzojnë as kujtimet e viktimave dhe as dobësinë emocionale të nxënësve, të jenë në qendër të kurrikulës së Holokaustit.

13) Përpikuni për ekuilibër në përcaktimin e këndvështrimit të kujt informon studimin tuaj të Holokaustit.

Shpesh, theksi vihet mbi viktimat e agresionit nazist, në vend të shkaktarëve që i detyronin njerëzit të bënin zgjedhje të pamundura ose thjesht i lanë pa zgjidhje. Shumica e nxënësve shprehin ndjeshmëri për viktimat e vrasjeve masive. Por, nuk është e pazakontë që nxënësit të supozojnë se viktimat mund të kenë bërë diçka për të justifikuar veprimet ndaj tyre, dhe në këtë mënyrë t'u vënë fajin e papërshtatshëm vetë viktimave.

Ekziston edhe një tendencë midis nxënësve për të lavdëruar pushtetin, edhe kur përdoret për të vrarë njerëz të pafajshëm. Në disa raste, ka nxënës të cilët mund të joshen nga simbolet e pushtetit që përshkruajnë propagandën naziste (p.sh., flamujt nazistë, parullat naziste, ritualet dhe muzika). Në vend që të nënvizojnë “kurthe” të pushtetit nazist, mësuesit duhet t'u kërkojnë nxënësve të vlerësojnë se si elementë të tillë përdoren nga qeveritë për të ndërtuar, mbrojtur dhe mobilizuar një shoqëri. Nxënësit gjithashtu duhet të inkurajohen të mendojnë se si elementë të tillë mund të manipulohen nga qeveritë për të zbatuar dhe legjitimuar akte terrori, madje edhe gjenocidi ashtu si ndodhi me hebrenjtë.

14) Zgjidhni aktivitetet e duhura mësimore.

Vetëm për shkak se nxënësit pëlqejnë një aktivitet të caktuar mësimor, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se duhet përdorur në rastin e studimit të Holokaustit.

Për mësimin e Holokaustit preferohen aktivitete mësimore që nxitin analizën, gjykimin dhe mendimin kritik. Aktivitetet e simulimit mund të përdoren në mënyrë efektive, veçanërisht kur ato janë krijuar për të eksploruar aspekte të ndryshme të sjelljes njerëzore si: frika, zgjidhja e konflikteve dhe vendimmarrja e vështirë. Prezantimi i Holokaustit nëpërmjet dëshmisë së të mbijetuarve ose të familjarëve të tyre zbulon para nxënësve dhe argumenton pamundësinë për të përfytyruar me saktësi se si ishte të jetosh çdo ditë me frikë, uri, sëmundje, humbje të pamatshme dhe kërcënim të pandërprerë nga brutaliteti i tmerrshëm dhe nga vdekja.

Meqenëse ka shumë rrëfime të burimeve parësore, të shkruara dhe vizuale që përshkruajnë Holokaustin, mësuesit duhet të përdorin këto burime në mësimin e tij. Diskutimi, një detyrë me shkrim ose t'u kërkojë nxënësve të marrin në konsideratë këndvështrime të ndryshme mbi një ngjarje të caktuar ose përvojë historike është një metodë efikase për mësimin e Holokaustit.

15) Përforconi rezultatet e të nxënës

Si në të gjitha situatat e mësimdhënies, hapja e mësimi dhe mbyllja janë etapa jashtëzakonisht të rëndësishme të orës së mësimi. Hapja e mësimi duhet të shërbejë për të shpërndarë dezinformatat që nxënësit mund të kenë përpara studimit të Holokaustit. Ky studim duhet t'i bëjë nxënësit të reflektojnë, të lëvizin nga pasivë në aktivë, t'u tregojë atyre se idetë dhe opinionet e tyre kanë rëndësi dhe të përcaktojnë se kjo histori ka degëzime të shumta për ata si individë dhe si anëtarë të shoqërisë në tërësi.

Një mbyllje e fortë duhet të theksojë sintezën duke i inkurajuar nxënësit ta lidhin këtë histori me ngjarje të tjera botërore, si dhe me botën ku ata jetojnë sot. Nxënësit duhet të inkurajohen të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar dhe të marrin në konsideratë se çfarë do të thotë ky studim për ta si qytetarë, pjesë e një shoqërie demokratike. Mbyllja e mësimi duhet të inkurajojë shqyrtimin e mëtejshëm të historisë, letërsisë dhe artit të Holokaustit.

5.2. Mundësi për përfshirjen e Holokaustit në kurrikulën shkollë të arsimit parauniversitar në Shqipëri

Holokausti mund të integrohet në mënyrë efektive në lëndë të ndryshme brenda kurrikulës shkollë. Më poshtë jepen shembuj për përfshirjen e Holokaustit në lëndë të ndryshme si histori, letërsi, art etj.

- ***Histori*** [128]

Lënda e historisë fillon të studiohet për herë të parë në klasën e katërt të arsimit fillor dhe përfundon në klasën XII. Gjatë shkollës së mesme nxënësi, njohuritë për lëndën e historisë i merr nëpërmjet kurrikulës bërthamë dhe asaj të avancuar.

Hartimi i kurrikulës së historisë mbështetet në Rekomandimet Rek (2001)¹²⁸ të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

Gjatë zhvillimit të lëndës së historisë nxënësit kuptojnë dhe gjykojnë mbi natyrën dhe shkaqet e konflikteve, si dhe rrugët e bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve, si faktorë me ndikim në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë ndikimin e këtyre faktorëve në dy luftërat botërore (Lufta e Parë Botërore dhe Lufta e Dytë Botërore), Holokaustin dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve.

128] Getting Started Guide for Teachers — United States Holocaust Memorial Museum (ushmm.org)

Në aspekte të përgjithshme mësuesit e kanë detyrim që përgjatë gjithë ciklit të studimit të historisë në arsimin parauniversitar t'i kushtojnë vëmendje të veçantë trajtimit të Holokaustit si një nga ngjarjet më të rëndësishme të përjetuara nga shoqëria njerëzore. Kurrikula e historisë, si në arsimin bazë ashtu dhe në arsimin e mesëm të lartë, ofron hapësira të gjera në trajtimin e temave dhe veprimtarive për Holokaustin (tema dhe çështje), ku nxënësit fitojnë njohuritë/aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme lidhur me këtë periudhë e ngjarje historike.

Gjatë mësimit të historisë nxënësit krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimipaqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, ***aftësohen të parandalojnë përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur në histori si Holokausti***, gjenocidi dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore. Për këtë qëllim, në lëndën e historisë nxënësit:

- shqyrtojnë ngjarjet, veprat dhe idetë në historinë evropiane, të cilat kontribuan në Holokaustin, të tilla si: historia e antisemitizmit në Evropë, racizmi, ngritja e nacionalizmit gjerman, disfata e Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore dhe dështimi i Republikës së Vajmarit.
- njihen dhe ndërgjegjësohen me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi; reflektojnë mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmangjet përsëritja e fakteve të tilla;
- kuptojnë se çfarë ndodh kur institucionet demokratike parlamentare dështojnë;
- analizojnë procesin e degjenerimit të një shteti nga një demokraci (parlamentare) në një shtet totalitar (p.sh., duke shqyrtuar proceset me anë të të cilave nazistët fituan kontrollin absolut të qeverisë gjermane dhe se si qeveria naziste më pas kontrolloi pothuajse të gjitha segmentet e shoqërisë në Gjermani);
- shqyrtojnë se si zhvillimi i politikës publike mund të çojë në përfundime gjenocide, veçanërisht kur njerëzit qëndrojnë të heshtur përballë praktikave diskriminuese (p.sh., zhvillimi i politikave naziste racore dhe gjenocidi ndaj hebrenjve dhe grupeve të tjera të viktimave, duke filluar me platformën filozofike të përpunuar në Mein e Hitlerit Kampf, duke vazhduar me ligjet e Nurembergut të imponuara nga shteti dhe duke kulmuar me politikat qeveritare të vrasjeve dhe shfarosjes pas vitit 1941);

- shqyrtojnë rolin e burokracisë naziste në zbatimin e politikave të vrasjeve dhe të asgjësimit (p.sh., zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi për të identifikuar, izoluar, dëbuar, skllavëruar dhe vrarë njerëzit e synuar dhe më pas në rishpërndarjen e sendeve të tyre të mbetura);
- shqyrtojnë rolin e individëve të ndryshëm në ngritjen dhe rënien e një qeverie totalitare (p.sh., ata që mbështetën Gjermaninë naziste, ata që ishin pasivë dhe ata që rezistuan nga brenda, si partizanët dhe të tjerët që kryen revolta, dhe nga jashtë, siç ishin forcat aleate);
- gjykojnë dhe vlerësojnë natyrën e ndryshueshme të konflikteve dhe të bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve dhe ndikimet e tyre në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë natyrën dhe ndikimin e dy luftërave botërore, Holokaustit dhe rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve;
- shpjegojnë dhe gjykojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore: pasojat ekonomike, pasojat sociale, pasojat psikologjike dhe pasojat e Holokaustit;
- vlerësojnë rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve të luftës;
- vlerësojnë rolin dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore.
- evidentojnë se një ndër trashëgimitë e Holokaustit ka qenë krijimi i Kombeve të Bashkuara në 1945 dhe përpjekjet e vazhdueshme të saj për të zhvilluar dhe miratuar projektligje të shumta, domethënëse për të drejtat e njeriut (p.sh., Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa e OKB-së për Gjenocidin).
- kryejnë aktivitete të ndryshme në funksion të zbatimit të vendimit të ministrave të edukimit (Krakovi 2000), lidhur me caktimin në shkollë të një dite përkujtimore të Holokaustit për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- kujtojnë ashtu si Evropa, **27 janarin**, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit duke kryer aktivitete dhe projekte të ndryshme në këtë ditë.

Mësuesit e historisë mund të përfshijnë Holokaustin në temat: Pasojat e Luftës së Parë Botërore; Ngritja e Diktatorëve; Bota në luftë, 1939-1945; Pasojat e Luftës së Dytë Botërore. Në mënyrë specifike Holokausti trajtohet në ato klasa ku nxënësit aftësohen mbi periudhën bashkëkohore, ku pjesë e saj është dhe Lufta e Dytë botërore. Më poshtë specifikohen klasat dhe ku e si trajtohet Holokausti në kurrikulën e historisë.

Klasa VIII

Në klasën e 8-të, përmbajtja e programit të lëndës “Historia e qytetërimeve bashkëkohore” përveç të tjerave në tematikën “Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)”, trajton dhe temën “Lufta e Dytë Botërore” (1939-1945)

Programi në këtë pjesë të tij, trajton zhvillimet e reja ideologjike, kulturore, ekonomike, sociale e politike që shkaktuan tronditjet dhe krizat të cilat çuan në fillimin e luftërave botërore. Nxënësit kuptojnë dhe gjykojnë natyrën dhe shkaqet e konflikteve si dhe rrugët e bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve, si faktorë me ndikim në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë ndikimin e këtyre faktorëve në dy luftërat botërore, Holokaustin dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve.

Tematika	Tema	Rezultate e të nxënit	Situatë e sugjeruar
Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Lufta dhe paqja 1914-1920	Nxënësi: • përcakton dhe përdor këto koncepte e terma historikë: luftë botërore, blloqe ndërluftuese, fronte luftimi, rend i ri botëror, vetëvendosje, Konferenca e Paqes në Paris, Lidhja e Kombeve; • përcakton aleancat politike e ushtarake në prag të luftës; • shpjegon rritjen e tensionit në Evropë, duke evidentuar shkaqet e Luftës së Parë Botërore; • evidenton ndryshimin midis shkaqeve dhe pretekstit të luftës; • tregon dhe gjykon rrjedhojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të luftës; • analizon vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes; • gjykon arsyet dhe vlerëson rëndësinë e krijimit të Lidhjes së Kombeve;	Qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore <i>Nxënësi vlerëson rolin e shqiptarëve ndaj hebrenjve</i>

Tematika	Tema	Rezultate e të nxënit	Situatë e sugjeruar
Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Sistemet politike në vitet 1920-1939	Nxënësi: - përcakton dhe përdor këto koncepte e terma historikë: komunizëm, fashizëm, totalitarizëm, diktaturë, liberalizëm, demokraci; - shpjegon dhe gjykon rrugët dhe shkaqet e ardhjes në pushtet të qeverisjeve totalitare; - evidenton tiparet e sistemeve kryesore politike në vitet 1920-1939 (Gjermani, BRSS, SHBA); - portretizon figurat e sistemeve kryesore politike në vitet 1920-1939, duke përshkruar drejtimet e politikës së brendshme e të jashtme të këtyre figurave;	
Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Ekonomia në periudhën 1920-1939	Nxënësi: - përcakton dhe përdor këto koncepte e terma historikë: depresioni i madh, “marrëveshja e re”, shteti i mirëqenies, mbiprodhim, klasë e mesme; - përshkruan dhe gjykon gjendjen ekonomike pas Luftës së Parë Botërore; - evidenton dhe gjykon shkaqet dhe pasojat e krizës 1929-1933; - vlerëson politikat e ndryshme që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike: shteti i mirëqenies në Angli, Fronti Popullor në Francë, marrëveshja e re (Kursi i Ri i Rusveltit në SHBA);	

Tematika	Tema	Rezultate e të nxënit	Situatë e sugjeruar
Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca në vitet 1920-1939	Nxënësi: - shpjegon ndryshimet sociale, kulturore dhe shkencore që pësoi shoqëria në periudhën midis dy luftërave botërore; - dallon ndryshimet ndërmjet tipareve të shoqërive totalitare me ato të shoqërive demokratike; - evidenton karakteristikat e artit dhe kulturës në vitet 1920-1939;	
Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Lufta e Dytë Botërore (1939-1945) (Shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, karakteri i saj; Holokausti, zhvillimi dhe përfundimi i luftës; Pasojat e Luftës së Dytë Botërore; Roli i institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve)	Nxënësi: - shqyrton dhe tregon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; - dallon blloqet kryesore ushtarake në prag të Luftës së Dytë Botërore; - përcakton në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; - shpjegon dhe gjykon pasojat e Luftës së Dytë Botërore: pasojat ekonomike, pasojat sociale, pasojat psikologjike; pasojat e holokaustit; - vlerëson rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve të luftës;	

Klasa IX

Në klasën e 9-të, përmbajtja e programit të lëndës “Historia e shqiptarëve” përveç të tjerave trajton dhe tematikën “Shqiptarët dhe Lufta e dytë Botërore 1939 – 1944”

Programi në këtë tematikë trajton pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo tematikë evidenton tiparet e rezistencës shqiptare ndaj pushtuesve italianë dhe gjermanë, ngjashmëritë dhe dallimet e administratave të pushtimit, lidhjen e rezistencës shqiptare me atë të Aleatëve të Mëdhenj të Koalicionit të Kombeve të Bashkuara dhe tregon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit aftësohen të shpjegojnë rrjedhjat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe mbarë botën.

Situatë e sugjeruar

Përgatitja e një albumi me temë:

- Hebrenjtë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore

Klasa X

Në klasën e 10-të, përmbajtja e programit të lëndës “Historia e Qytetërimeve Botërore” në periudhën e qytetërimeve bashkëkohore, përveç të tjerave trajton dhe Luftën e Dytë Botërore”

Në këtë pjesë të tij nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nxënësit kuptojnë, analizojnë dhe gjykojnë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Nxënësit gjykojnë dhe mbajnë qëndrim për pasojat e holokaustit, vlerësojnë trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Kjo tematikë u mëson nxënësve përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijojnë te ata bindjen se çdo konflikt rajonal apo me shtrirje më të gjerë sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Tematika krijojnë një tablo të qartë për drejtimet e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë dy sistemeve (demokratike dhe totalitare).

Tematika	Tema	Rezultate e të nxënësve	Situatë e sugjeruar
Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Fillimet e krizave të shekullit XX. Lufta dhe paqja (1914-1920)	Nxënësi: • analizon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore; • përcakton në hartë frontet kryesore në të cilat u zhvillua Lufta e Parë Botërore; • analizon konceptin e planit të SHBA-së për paqen në botë (14 pikat e Willsonit); • gjykon mbi vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes së arritur në Versajë; • pasqyron hartën e re politike të Evropës pas Luftës së Parë Botërore. • gjykon pasojat politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve të paqes në përfundim të saj;	Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nxënësi vlerëson kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e popullsisë hebraike gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Tematika	Tema	Rezultate e të nxënës	Situatë e sugjeruar
Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Fashizmi në Itali	Nxënësi: - shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit; - analizon tiparet e sistemit politik në Italinë fashiste; - shpjegon tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të fashizmit në Itali; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Italinë fashiste; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Italinë fashiste;	
Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Gjermania	Nxënësi: - shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Hitlerit; - analizon tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani; - gjykon antisemitizmin e Hitlerit, që solli Holokaustin, duke gjykuar për rrjedhojat e tij; - analizon arsyet e militarizimit të ekonomisë si faktor për daljen nga kriza ekonomike;	
Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)	Nxënësi: - shpjegon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; - përcakton në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; - shpjegon rolin e grupeve të rezistencës gjatë Luftës së Dytë Botërore; - analizon trashëgiminë e Luftës së Dytë Botërore: - pasojat ekonomike, - pasojat sociale, - pasojat psikologjike; - pasojat e Holokaustit.	

Klasa XI

Në klasën e 11-të, përmbajtja e programit të lëndës “Historia e shqiptarëve” përveç të tjerave trajton dhe tematikën “Shqiptarët dhe Lufta e dytë Botërore, 1939 – 1944”

Programi në këtë tematikë trajton pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo tematikë evidenton reagimin e grupeve të ndryshme politike ndaj pushtuesit gjerman, njeh misionet e huaja që vepruan në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe tregon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe popullsisë çame në Greqi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit aftësohen të shpjegojnë rrjedhojat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe mbarë botën.

Situatë e sugjeruar

Ese:

-Hebrenjtë dhe shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore

Klasa XII (Lëndë me zgjedhje)

Në klasën e 12-të, programi i historisë, gjatë shkallës së gjashtë të kurrikulës, trajton në mënyrë të integruar historinë e qytetërimeve botërore dhe historinë e shqiptarëve në periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve.

Në këtë program në tematikën “Periudhën e qytetërimeve bashkëkohore”, përveç të tjerave trajtohet dhe “Lufta e Dytë Botërore.

Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit aftësohen të shpjegojnë rrjedhojat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe pasojat e saj në mbarë botën, ku fokus është Holokausti.

Situatë e sugjeruar

Holokausti, mikpritja e shqiptarëve ndaj hebrenjve dhe ushtarëve italiane pas kapitullimit të Italisë.

Pyetjet që mësuesit duhet t'u drejtojnë nxënësve për të nxitur mendimin kritik

Kur mësuesit e historisë trajtojnë “Pasojat e Luftës së Parë Botërore” ata mund të pyesin nxënësit:

- Cilat ishin pasojat e Depresionit të madh në sistemin ekonomik dhe politik evropian të krijuar nga Traktati i Versajës i vitit 1919?
- Cili ishte ndikimi i Depresionit në fuqinë elektorale të partisë naziste në Gjermani?
- A ishte Depresioni një faktor kontribuues në ardhjen e nazistëve në pushtet?
- Çfarë roli luajti Traktati i Versajës në ristrukturimin e politikës evropiane dhe botërore?
- Si ndikoi rikonfigurimi i Evropës pas Luftës së Parë Botërore në politikën kombëtare gjermane në periudhën 1919-33?

Kur mësuesit e historisë trajtojnë “Sistemet politike në vitet 1920-1939” ata mund të pyesin nxënësit:

- Cilat ishin konfliktet që lindin midis grupeve të shumicës dhe të pakicës në një sferë specifike kulturore (Evropa midis viteve 1933-45)?
- Cilët faktorë çuan në ngritjen e regjimeve totalitare në Evropë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore?
- Si mundet një qeveri të përdorë si armë për të persekutuar, vrarë dhe asgjësuar njerëzit, koncepte të tilla si: kultura, etnia, raca, diversiteti dhe kombësia?
- Si u përdor antisemitizmi nga nazistët dhe regjimet e tjera (Italia, BRSS) për të justifikuar masat totalitare?

Kur mësuesit e historisë trajtojnë “Lufta e Dytë Botërore” ata mund të pyesin nxënësit:

- Pse Holokausti është quajtur shpesh një “luftë brenda luftës?”
- Pse është “më e lehtë” të kryhen akte gjenocidi gjatë kohës së luftës sesa gjatë një periudhe paqeje relative?
- Cila ishte politika e qeverisë shqiptare ndaj hebrenjve gjatë regjimit të Zogut dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore?
- Cili ishte roli dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore?

Kur mësuesit e historisë trajtojnë “Pasojat e Luftës së Dytë Botërore” ata mund të pyesin nxënësit:

- Si hebrenjtë mbijetuan dhe ruajtën kulturat dhe traditat e tyre, kur u përballen me kërcënime për vetë ekzistencën e tyre (p.sh., mbajtja e praktikave fetare, regjistrimi i rrëfimeve të dëshmitarëve okularë dhe fshehja e simboleve dhe artefakteve kulturore)?
- Cilat janë gjenocide të tjera që kanë ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore?
- Cila ishte lidhja midis Luftës së Dytë Botërore dhe formimit të Shtetit të Izraelit?

Disa modele veprimtarie mësimore në lëndën e historisë

- Kërkojuni nxënësve në klasë të hulumtojnë se si politikat e ndryshme të regjimit nazist ishin të ndërlidhura (p.sh., lidhjet mes krijimit të një qeverie totalitare, zbatimit të politikave racore dhe zhvillimit të luftës.
- Kërkojuni nxënësve në klasë të përkufizojnë konceptin “civilizim” dhe më pas të reflektojnë mbi implikimet morale dhe etike të epokës naziste (p.sh., planifikimi dhe zbatimi sistematik i një politike të qeverisë për të vrarë miliona njerëz; përdorimi i përparimeve teknologjike për të kryer masakra masive; roli i bashkëpunëtorëve nazistë dhe roli i kalimtarëve në mbarë botën që zgjodhën të mos ndërhyjnë në persekutimin dhe vrasjen e hebrenjve dhe të viktimave të tjera. Disonanca e ngritur në një mësim të tillë i ndihmon nxënësit të kuptojnë se politikat e qeverisë mund të përfshijnë të keqen, veçanërisht kur vepron shtypja, terrori dhe forca brutale.
- Kërkojuni nxënësve në klasë të gjykojnë mbi ngjashmëritë dhe dallimet midis politikave qeveritare gjatë Holokaustit dhe politikave të sotme që krijojnë potencialin për etnocid ose gjenocid (p.sh., krahasimi dhe kontrasti i filozofisë dhe/ose politikave të regjimit nazist me atë të Khmerëve të Kuq në Kamboxhia);
- Kërkojuni nxënësve në klasë të diskutojnë mbi problemet bashkëkohore botërore sot nëpërmjet studimit të Holokaustit dhe pasojave të tij me qëllim parandalimin e gjenocidit dhe mos-përsëritjen ngjarjeve të tilla në historinë e njerëzimit.

Qytetari

Nëse nxënësit shprehin teori konspirative, mësuesit duhet të reagojnë siç duhet duke zbuluar pse është përdorur kjo teori konspiracioni dhe çfarë justifikon. Është e dobishme të njihni burimin e teorisë specifike të konspiracionit për të pyetur pse nxënësi e ngriti atë. Diskutimi duhet të drejtohet drejt zbulimit dhe kuptimit të teorisë. Shpjegojuni nxënësve pse teoritë e konspiracionit janë tërheqëse dhe cilat strategji mund të jenë të dobishme për të kuptuar botën. Nëse është magjepsje rreth misterit ajo që i ka tërhequr nxënësit drejt teorisë konspirative, mësuesit duhet të përpiqen të gjejnë alternativë dhe mënyra më pak të dëmshme për plotësimin e kësaj nevojë.

Mësuesit duhet t'i aftësojnë nxënësit rreth shkrimit dhe leximit mediatik. Video propagandistike antisemite, informacione të disponueshme përmes internetit, karikatura, imazhe dhe media luajnë një rol të rëndësishëm në përhapjen e teorisë konspirative. Kështu, nxënësit duhet të aftësohen mbi shkrim -leximin mediatik për të qenë në gjendje të analizojnë, përzgjedhin dhe krahasojnë në mënyrë kritike informacionin me qëllim që të hedhin poshtë pretendimet ekstremiste dhe teoritë e konspiracionit. Mësuesi dhe nxënësit mund të vendosin kritere rreth informacionit që përzgjedhin dhe saktësisë dhe besueshmërisë së tij. Kjo nuk do të thotë t'u ndalohej nxënësve përdorimi i mediave të caktuara.

Përkundrazi, nxënësit duhet të inkurajohen të përdorin burimet e informacione të tilla si interneti për qëllime konstruktive me një qasje kritike, në mësimin rreth antisemitizmit. Mësuesit duhet të kenë një qasje racionale dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e nxënësve gjatë mësimin. Sa herë që një nxënës shpreh një teori konspirative për shembull, në lidhje me politikën bashkëkohore, mësuesit duhet të punojnë së bashku gjatë orëve të edukimit qytetar. Nxënësit duhet t'u krijohet mundësia që në mënyrë kritike të analizojnë zhvillimet globale dhe të kuptojnë se si këto lidhen me realitetin e tyre të përditshëm. Mësuesit duhet të punojnë me “frikën” si bazë të shpjegimeve të teorisë së konspiracionit për një orientim të bazuar në realitet që lehtëson pjesëmarrjen e informuar në shoqëri.

Letërsi [129]

Gjuha shqipe dhe letërsia [130] zhvillohen përgjatë gjithë viteve të arsimit parauniversitar nga klasa I deri në klasën XII. Letërsia është e aftë të ofrojë këndvështrime të ndryshme për një mori temash, të cilat i angazhojnë në mënyrë efikase nxënësit duke i njohur dhe përballur ata dhe me problemet që ka kaluar historia e shoqërisë njerëzore.

Holokausti trajtohet gjini dhe lloje të ndryshme letrare, si: romane, tregime të shkurtra, drama, poezi, ditarë dhe kujtime. Ky spektër i gjerë u jep mësuesve një gamë të mirë zgjedhjesh. Për shkak se letërsia e Holokaustit rrjedh nga një epokë e vërtetë në historinë njerëzore, krijimet e saj zbulojnë të vërtetat bazë për natyrën njerëzore dhe u ofrojnë nxënësve modele të besueshme heroizmi dhe dinjiteti. Në të njëjtën kohë, kjo letërsi i përball ata pushtetin e të keqes njerëzore.

Për shkak se shumë prej tregimeve ndërthuren me çështje në jetën e vetë nxënësve, letërsia e Holokaustit mund të frymëzojë te nxënësit angazhimin për të refuzuar indiferencën ndaj vuajtjes njerëzore dhe mund t'i ndërgjegjësojë për çështje të rëndësishme sociale. Studimi i përgjigjeve letrare ndaj Holokaustit e ndihmon nxënësin:

- të zhvillojë një respekt më të thellë për dinjitetin njerëzor dhe të përballet me shthurjen morale dhe shtrirjen e së keqes naziste (p.sh., mizorinë e tmerrshme të trajtimit nazist të viktimave para arrestimeve dhe dëbimeve; dëbimet me makina kuti, vrasjet masive dhe të ashtuquajturat eksperimente mjekësore të mjekëve nazistë);
- të njohë veprat e heroizmit të demonstruar nga adoleshentët dhe të rriturit në geto dhe kampe përqendrimi (p.sh., korrierët që dërgonin mesazhe, mallra dhe armë brenda dhe jashtë getos së Varshavës; partizanët që përdorën armët për t'iu rezistuar nazistëve; kryengritjet dhe revoltat në geto të ndryshme, duke përfshirë Varshavën, dhe në qendrat e vrasjeve si Treblinka);

[129] Classroom materials – Centre for Holocaust Education

[130] Në arsimin bazë, në lëndën e gjuhës shqipe integrohet edhe letërsia. Në arsimin e mesëm të lartë, këto dy lëndë zhvillohen të ndara.

- të analizojë rezistencën shpirtërore të evidentuar në letërsi që portretizon dinjitetin e njerëzve që kapërcejnë të keqen e vrasësve të tyre, siç gjendet, për shembull, në shkrimet klandestine të ditarëve, poezive dhe dramave;
- të përshkruajë rolet e ndryshme që iu ngarkuan njerëzve gjatë Holokaustit, si viktimat, shtypës, kalimtarë dhe shpëtimtarë;
- të shqyrtojë zgjedhjet morale ose mungesën e zgjedhjeve, me të cilat janë përballur të rinjtë të moshuarit, viktimat dhe dhunuesit;
- të analizojë korrupsionin e gjuhës të kultivuar nga nazistët, veçanërisht në përdorimin e eufemizmave për të maskuar qëllimin e tyre të keq, si p.sh., përdorimi i termave:
 - “emigracion” për dëbim;
 - “evakuim” për dëbim;
 - “deportim” për transport në kampet e përqendrimit dhe qendrat e vrasjeve;
 - “aksionet e policisë” për grumbullimet që zakonisht çuan në vrasje masive;
 - “zgjidhja përfundimtare” për asgjësimin e planifikuar të çdo hebreu në Evropë.

Artet dhe Histori arti

Një nga qëllimet e studimit të historisë së artit është t'u mundësojë nxënësve që të kuptojnë rolin e artit në shoqëri. Holokausti mund të përfshihet në një studim të artit dhe të historisë së artit për të kuptuar se si nazistët përdorën artin për qëllime propagandistike dhe se si viktimat përdorën shprehjen artistike për të komunikuar protestën, dëshpërimin dhe/ose shpresën e tyre. Një studim i artit gjatë Holokaustit e ndihmon nxënësin:

- të analizojë motivimet dhe implikimet e aktiviteteve të censurës së nazistëve në artet e bukura dhe letrare, teatër dhe muzikë (p.sh., ndalimi i librave dhe i stileve të caktuara të pikturës, djegiet e librave në maj 1933);
- të shqyrtojë vlerat dhe besimet e nazistëve dhe mënyrën se si regjimi e perceptoi botën, për shembull, duke shqyrtuar simbolet naziste të pushtetit, posterat propagandistike naziste, pikturat dhe vizatimet që konsiderohen “të pranueshme” dhe jo “të degjeneruara”;
- të studiojë se si njerëzit që jetonin nën kontrollin nazist e përdornin artin si një formë rezistence (p.sh., duke shqyrtuar shkallën në të cilën viktimat krijuan art; rreziqet me të cilat u përballën duke vepruar kështu; format e ndryshme të artit që u krijuan dhe mjediset në të cilat ato u krijuan dhe larminë e temave dhe të përmbajtjes);
- të shqyrtojë artin e krijuar nga viktimat dhe të mbijetuarit e Holokaustit dhe të eksplorojë aftësinë e tij për të dokumentuar përvoja të ndryshme, duke përfshirë jetën para Holokaustit, jetën brenda getove, dëbimet dhe një mori përvojash në sistemin e kampeve të përqendrimit;
- të shqyrtojë interpretimet e Holokaustit siç shprehen në artin bashkëkohor, ekspozitat e artit dhe memorialet.

06

REFERENCA

- Anti-Defamation League, "Annual Audit 2017", <<https://www.adl.org/resources/reports/2017-audit-of-anti-semitic-incidents>>.
- Anti-Defamation League (ADL), "Challenging Anti-Semitism: Debunking the Myths and Responding with Facts", ADL website, Summer 2006. <<https://www.adl.org/education/educator-resources/lesson-plans/challenging-anti-semitism-debunking-the-myths-and>>.
- Anti-Defamation League, "What the Women's March Teaches Us about Intersectionality", ADL website, 24 January, 2017, <<https://www.adl.org/blog/what-the-womens-march-teaches-us-about-intersectionality>>.
- Anti-Defamation League, ADL Global 100: An Index of Anti-Semitism, <<https://global100.adl.org/map>>.
- Banaji, M. R. & Greenwald, A. G., *Blind Spot: Hidden Biases of Good People* (New York: Bantam Books, 2016).
- Bauer, Y., *The Jews: A Contrary People* (Zurich and Munich: Lit Verlag, 2014).
- Bericht des unabhängigen Expertenkreises Antisemitismus, "Antisemitismus in Deutschland – Erscheinungsformen, Bedingungen, Präventionsansätze", Deutscher Bundestag, Unterrichtung durch die Bundesregierung, Drucksache 17/7700, 10.11.2011.
- Best, R., "Pastoral Care and Personal Social Education. A Review of UK Research Undertaken for the British Educational Research Association", British Educational Research Association website, <<https://www.bera.ac.uk/wp-content/uploads/2014/01/best-pastoralcarepse.pdf?noredirect=1>>.
- Blair, I. V. & Banaji, M. R., "Automatic and Controlled Processes in Stereotype Priming", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 70, No. 6, 1996, pp. 1142–1163.
- Blair, I. V., Ma, J. E. & Lenton, A. P., "Imagining Stereotypes Away: The Moderation of Implicit Stereotypes Through Mental Imagery", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 81, No. 5, 2001, pp. 828–841.
- Boscardin, C., "Reducing Implicit Bias Through Curricular Interventions", *Journal of General Internal Medicine*, Vol. 30, No. 12, 2015, pp. 1726–1728.
- Brewer, M. B., "A Dual-Process Model of Impression Formation", In T. K. Srull & R. S. Wyer, (Eds.), *Advances in Social Cognition* (Hillsdale, NJ: Laurence Erlbaum Associates Publishers, 1988), pp. 1–36.
- Brewer, M. B., "Ingroup Identification and Intergroup Conflict: When Does Ingroup Love Become Outgroup Hate?", in R. E. Ashmore & L. Jussim (Eds.), *Social Identity, Intergroup Conflict and Conflict Reduction* (New York: Oxford University Press, 2001), pp. 17–41.
- Bruner, J. S., *The Process of Education* (Cambridge, M.A.: Harvard University Press, 1960).
- Burgess, D., van Ryn, M., Dovidio, J. & Somnath, S., "Reducing Racial Bias Among Health Care Providers: Lessons from Social-Cognitive Psychology", *Journal of General Internal Medicine*, Vol. 22, No. 6, 2007, pp. 882–887.
- Burns, M. D., Parker, L. R. M. & Monteith, M. J., "Self-regulation Strategies for Combatting Prejudice", in C. G. Sibley & F. K. Barlow (Eds.), *The Cambridge Handbook of the Psychology of Prejudice* (Cambridge: Cambridge University Press, 2016).
- Cambridge English Dictionary Online, "Bias", <<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/bias>>.

- Carnes, M., Devine, P. G., Baier Manwell, L., Byars-Winston, A., Fine, E., Ford, C. E. & Sheridan, J., "The Effect of an Intervention to Break the Gender Bias Habit for Faculty at One Institution: A Cluster Randomized, Controlled Trial", *Academic Medicine*, Vol. 90, No. 2, 2015, pp. 221–230.
- Castello, E. R., Romero, E. & Kapó, U. M., *The Jews and Europe: 2,000 Years of History* (Edison, NJ: Chartwell Books, 1994).
- Chelsea Football Club, "Say No to Antisemitism", Chelsea Football Club website, 31 March 2018, <<https://www.chelseafc.com/en/foundation/say-no-to-antisemitism>>.
- Clavane, A., "We Thought Antisemitism in Football Was Long Gone: How Wrong We Were", *The Guardian*, 5 December 2016, <<https://www.theguardian.com/commentisfree/2016/dec/05/antisemitism-football-antisemitic-incidents-abuse>>.
- College of Policing, "Critical Incident Management", College of Policing website, <<https://www.app.college.police.uk/app-content/critical-incident-management/types-of-critical-incident/>>.
- Devine, P. G., Forscher, P. S., Austin, A. J. & Cox, W. T. L., "Long-Term Reduction in Implicit Race Bias: A Prejudice Habit-Breaking Intervention", *Journal of Experimental Social Psychology*, Vol. 48, No. 6, 2012, pp. 1267–1278.
- Devine, P. G. & Sharp, L. B., "Automaticity and Control in Stereotyping and Prejudice", in T. D. Nelson (Ed.), *Handbook of Prejudice, Stereotyping, and Discrimination* (London: Routledge, 2009), pp. 61–88.
- Dovidio, J. F., Hewstone, M., Glick, P. & Esses, V. M. (Eds.), *The Sage Handbook of Prejudice, Stereotyping and Discrimination* (London: SAGE Publications Ltd, 2010).
- Eagly, A. H. & Diekmann, A. B., "What Is the Problem? Prejudice as an Attitude-in-Context", in J. F. Dovidio, P. Glick & L. A. Rudman (Eds.), *On the Nature of Prejudice: Fifty Years after Allport* (Malden, Massachusetts & Oxford: Blackwell Publishers, 2005), pp. 19–35.
- Fein, S. & Spencer, S. J., "Prejudice as Self-Image Maintenance: Affirming the Self Through Derogating Others", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 73, No. 1, 1997, pp. 31–44.
- Feldman, D., "Toward a History of the Term 'Anti-Semitism'", *The American Historical Review*, Vol. 123, No. 4, 2018, pp. 1139–1150, <<https://doi.org/10.1093/ahr/rhy029>>.
- Fiske, S. T., "Stereotyping, Prejudice and Discrimination", in D. T. Gilbert, S. T. Fiske & G. Lindzey (Eds.), *The Handbook of Social Psychology* (Vol. 2) (New York: McGraw-Hill, 1998), pp. 357–411.
- Fiske, S. T., Cuddy, A. J. C., Glick, P. & Xu, J., "A Model of (Often Mixed) Stereotype Content: Competence and Warmth Respectively Follow from Perceived Status and Competition", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 82, No. 6, 2002, pp. 878–902.
- Fiske, S. T. & Neuberg, S. L., "A Continuum of Impression Formation, from Category-Based to Individuating Processes: Influences of Information and Motivation on Attention and Interpretation", in M. P. Zanna (Ed.), *Advances in Experimental Social Psychology* (Vol. 23) (San Diego, California: Academic Press, 1990), pp. 1–74.
- Foster, S., Pettigrew, A., Pearce, A., Hale, R., Burgess, A., Salmons, P. & Lenga, R. A., "What Do Learners Know and Understand about the Holocaust? Evidence from English Secondary Schools", UCL Centre for Holocaust Education website, <<https://www.holocausteducation.org.uk/wp-content/uploads/What-do-learners-know-and-understand-about-the-Holocaust2.pdf>>.

- Friedländer, S., *Nazi Germany and the Jews: The Years of Persecution, 1933-1939 (Vol. 1)* (New York: HarperCollins, 1997).
- Gaertner, S. L. & Dovidio, J. F., *Reducing Intergroup Bias: The Common Ingroup Identity Model* (New York: Psychology Press, 2000).
- Galinsky, A. D. & Moskowitz, G. B., "Perspective-Taking: Decreasing Stereotype Expression, Stereotype Accessibility, and In-Group Favoritism", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 7, No. 4, 2000, pp. 708-724.
- Gay, P., *The Cultivation of Hatred: The Bourgeois Experience: Victoria to Freud* (London: Fontana, 1993).
- Glick, P. & Fiske, S. T., "Ambivalent Stereotypes as Legitimizing Ideologies: Differentiating Paternalistic and Envious Prejudice", in J. T. Jost & B. Major (Eds.), *The Psychology of Legitimacy: Emerging Perspectives on Ideology, Justice, and Intergroup Relations* (New York: Cambridge University Press, 2001), pp. 278-306.
- Greene, R. A., "A Shadow Over Europe: CNN Poll Reveals Depth of Anti-Semitism in Europe", CNN Interactive website, <<https://www.cnn.com/interactive/2018/11/europe/antisemitism-poll-2018-intl>>.
- Government Response to Home Affairs Committee (2016) Report: "Anti-Semitism in the UK" <https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/576792/CM9386_-_Select_Committee_Response_-_Antisemitism_in_UK.pdf>.
- Hayes, P., *Why? Explaining the Holocaust* (New York: W.W. Norton and Company, 2017).
- Jewish Community Security Service (2016), "Report on Antisemitism in France", <<https://www.antisemitisme.fr/dl/2016-EN.pdf>>.
- International Holocaust Remembrance Alliance, "Working Definition of Antisemitism", IHRA website, <<https://www.holocaustremembrance.com/working-definition-antisemitism>>.
- Julius, A., *The Trials of the Diaspora: A history of anti-Semitism in England* (1st ed.) (Oxford: Oxford University Press, 2010).
- Lai, C. K., Marini, M., Lehr, S. A., Cerruti, C., Shin, J.-E. L., Joy-Gaba, J. A. & Nosek, B., "Reducing Implicit Racial Preferences: A Comparative Investigation of 17 Interventions", *Journal of Experimental Psychology*, Vol. 143, No. 4, 2014, pp. 1765-1785, <<https://doi.org/doi:10.1037/a0036260>>.
- Lee, P. & Shemilt, D., "A Scaffold, Not a Cage: Progression and Progression Models in History", *Teaching History*, Vol. 113, 2003, pp. 13-23.
- Legault, L., Gutsell, J. N., & Inzlicht, M., "Ironic Effects of Antiprejudice Messages: How Motivational Interventions Can Reduce (but Also Increase) Prejudice", *Psychological Science*, Vol. 22, Issue 12, 2011, pp. 1472-1477.
- Lipstadt, D., *Denying the Holocaust: The Growing Assault on Truth and Memory* (London: Penguin Books, 1993).
- Mackie, D. M., Devos, T. & Smith, E. R., "Intergroup Emotions: Explaining Offensive Action Tendencies in an Intergroup Context", *Journal of Personality and Social Psychology*, Vol. 79, No. 4, 2000, pp. 602-616.

- Marrus, M. R., *Lessons of the Holocaust* (Toronto, Buffalo and London: University of Toronto Press, 2016).
- Nazarian, S., "By Rejecting Jews, Intersectionality Betrays Itself". ADL website, 25 January 2018, <<https://www.adl.org/news/op-ed/by-rejecting-jews-intersectionality-betrays-itself>>.
- ODIHR, "Hate Crime Reporting: Anti-Semitism", OSCE website, <<http://hatecrime.osce.org/what-hate-crime/anti-semitism>>.
- ODIHR & UNESCO, *Addressing Anti-Semitism through Education: Guidelines for Policymakers* (Warsaw, Paris: ODIHR & UNESCO, 2018), <<https://www.osce.org/odihr/383089>>.
- ODIHR, UNESCO & the Council of Europe, *Guidelines for Educators on Countering Intolerance and Discrimination against Muslims: Addressing Islamophobia through Education* (Warsaw: OSCE/ODIHR, 2011).
- Osler, A. & Starkey, H., *Teachers and Human Rights Education* (Stoke on Trent: Trentham Books, 2010).
- Oxford English Dictionary Online, "Intolerance", Oxford University Press, 2019.
- Oxford University Press, "Bias", Lexico.com, 2019, <<https://www.lexico.com/definition/bias>>.
- Oxford University Press, "Intolerance", Lexico.com, 2019, <<https://www.lexico.com/definition/intolerance>>.
- Oxford University Press, "Prejudice", Lexico.com, 2019, <<https://www.lexico.com/definition/prejudice>>.
- Pew Research Center, "The Global Religious Landscape: A Report on the Size and Distribution of the World's Major Religious Groups as of 2010", Pew Research Center website, 18 December 2012, <<http://www.pewforum.org/2012/12/18/global-religious-landscape-exec/>>.
- Phoenix, A., "What is intersectionality?", British Academy website, 8 March 2018, <<https://www.thebritishacademy.ac.uk/blog/what-is-intersectionality>>.
- Rosenfeld, A. H., *Resurgent Antisemitism: Global Perspectives* (Bloomington, Indiana: Indiana University Press, 2013).

07

ANEKSE

Aneks 1

Përkufizimi i antisemitizmit i miratuar nga Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit

Më 26 maj 2016, Plenari [IHRA] në Bukuresht vendosi:

Pranoni përkufizimin e mëposhtëm, jo-ligjor të detyrueshëm, të antisemitizmit:

"Antisemitizmi[131] është një perceptim i caktuar i hebrenjve, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit janë të drejtuara ndaj individëve hebrenj ose johebrenj dhe/ose pronës së tyre, ndaj institucioneve të komunitetit hebre dhe objekteve fetare."

Për të udhëhequr IHRA-n në punën e saj, shembujt e mëposhtëm mund të shërbejnë si ilustrim:

"Manifestimet mund të përfshijnë shënjestrimin e shtetit të Izraelit, i konceptuar si një bashkësi hebreje. Megjithatë, kritikën ndaj Izraelit të ngjashme me ato të bëra ndaj çdo vendi tjetër nuk mund të konsiderohen si antisemite."

Antisemitizmi shpesh i akuzon hebrenjtë për komplot për të dëmtuar njerëzimin dhe shpesh përdoret për të fajësuar hebrenjtë për "përse gjërat shkojnë keq". Ai shprehet në të folur, të shkruar, forma vizuale dhe veprime, si dhe përdor stereotipa dhe tipare negative të karakterit.

Shembuj bashkëkohorë të antisemitizmit në jetën publike, media, shkolla, vendin e punës dhe në sferën fetare, duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm, mund të përfshijnë, por nuk janë kufizuar në:

- *Kërkesa, ndihma ose justifikimi i vrasjes ose dëmtimit të hebrenjve në emër të një ideologjie radikale ose një pikëpamjeje ekstremiste fetare.*
- *Akuza mashtruese, çnjerëzore, demonizuese ose stereotipike për hebrenjtë të tilla si siç është "fuqia e hebrenjve si kolektiv", veçanërisht, por jo ekskluzivisht, miti për një komplot botëror hebre ose për hebrenjtë që kontrollojnë median, ekonominë, qeverinë, shoqërinë ose institucionet.*
- *Akuzimin e hebrenjve si popull, se janë përgjegjës për të këqija reale ose të imagjinuara të kryera nga një person i vetëm ose grup hebre, apo edhe për veprime të kryera nga jo hebrenj.*
- *Mohimin e faktit, qëllimeve, mekanizmave (p.sh., dhomat e gazit) të gjenocidit të bërë ndaj popullit hebre nga Gjermania Nacional Socialiste dhe e mbështetësve dhe bashkëpunëtorëve të saj gjatë Luftës së Dytë Botërore (Holokausti).*

[131] The definition can be found online at <<https://www.holocaustremembrance.com/resources/working-definitions-charters/working-definition-antisemitism>>.

- *Akuzimin e hebrenjve si popull, ose Izraelit si shtet, për shpikjen ose ekzagjerimin e Holokaustit.*
- *Akuzimin e qytetarëve hebrenj se janë më besnikë ndaj Izraelit ose ndaj prioriteteve të supozuara të hebrenjve në mbarë botën, sesa ndaj interesave të kombeve të tyre.*
- *Mohimin e së drejtës së popullit hebre për vetëvendosje, p.sh., duke pretenduar se ekzistenca e një shteti të Izraelit është një përpjekje raciste.*
- *Zbatimin e standardeve të dyfishta duke kërkuar Izraelit një sjellje që nuk pritet ose kërkohet nga çdo komb tjetër demokratik.*
- *Përdorimin e simboleve dhe i imazheve që lidhen me antisemitizmin klasik (p.sh., pretendimet për hebrenjtë që vrasin Jezusin) për të karakterizuar Izraelin ose izraelitët.*
- *Bërjen e krahasimeve të politikës bashkëkohore izraelite me atë të nazistëve.*
- *Trajtimin e hebrenjve, si kolektivisht përgjegjës për veprimet e shtetit të Izraelit.*

Aktet antisemitike janë kriminale kur ato janë të përcaktuara me ligj (për shembull, mohimi i Holokaustit ose shpërndarja e materialeve antisemitike në disa vende).

Veprimet kriminale janë antisemitike kur objektivat e sulmeve, qofshin ato njerëz apo pronë – si ndërtesa, shkolla, vende kulti dhe varreza – zgjidhen sepse janë ose perceptohen të jenë hebrenj ose të lidhur me hebrenjtë.

Diskriminimi antisemitik është mohimi për hebrenjtë i mundësive apo i shërbimeve të disponueshme për të tjerët. Ky diskriminim është i paligjshëm në shumë vende.

Aneks 2

Përkufizimi i mohimit dhe i shtrembërimit të Holokaustit, miratuar nga Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit

Përkufizimi [132] aktual është një shprehje e vetëdijes se mohimi dhe shtrembërimi i Holokaustit duhet të sfidohen dhe të denoncohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe kanë nevojë për shqyrtim në nivel global.

IHRA miraton si mjet pune përkufizimin e mëposhtëm, jo të detyruar ligjërisht.

- *Mohimi i Holokaustit është diskurs dhe propagandë që mohon realitetin historik, shtrirjen e tij dhe shfarosjen e hebrenjve nga nazistët dhe bashkëpunëtorët e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore, i njohur si Holokausti apo Shoah. Mohimi i Holokaustit i referohet në mënyrë specifike çdo përpjekjeje për të pretenduar se Holokausti/Shoah nuk u zhvillua.*
- *Mohimi i Holokaustit mund të përfshijë mohimin publikisht ose vënien në dyshim të përdorimit të mekanizmave kryesorë të shkatërrimit (të tilla si dhomat e gazit, të shtënat masive, uria dhe torturat).*
- *Mohimi i Holokaustit, në format e tij të ndryshme, është një shprehje e antisemitizmit. Përpjekja për të mohuar gjenocidin e hebrenjve është një përpjekje për të shfajësuar nacional-socializmin dhe antisemitizmin nga faji ose përgjegjësia për gjenocidin e bërë ndaj popullit hebre.*
- *Format e mohimit të Holokaustit përfshin fajësimin e hebrenjve për ekzagjerim ose krijimin e Shoah-ut për përfitime politike ose financiare, sikur vetë Shoah të ishte rezultat i një komploti nga hebrenjtë. Qëllimi është që hebrenjtë të bëhen fajtorë dhe antisemitizmi të bëhet edhe një herë legjitim.*
- *Qëllimet e mohimit të Holokaustit shpesh janë rehabilitimi i një antisemitizmi eksplisit dhe promovimi i ideologjive politike dhe i kushteve të përshtatshme për ardhjen e vetë llojit të ngjarjes që mohon.*

Deformimi i Holokaustit, ndër të tjera, i referohet:

- *përpjekjes së qëllimshme për të justifikuar ose minimizuar ndikimin e Holokaustit ose elementëve të tij kryesorë, duke përfshirë bashkëpunëtorët dhe aleatët e Gjermanisë naziste;*
- *minimizimit të numrit të viktimave të Holokaustit në kundërshtim me burimet e besueshme;*
- *përpjekjes për të fajësuar hebrenjtë për shkaktimin e gjenocidit të tyre;*
- *deklaratave që e konsiderojnë Holokaustin si një ngjarje historike pozitive.*

[132]The definition can be found online at <<https://www.holocaustremembrance.com/resources/working-definitions-charters/working-definition-holocaust-denial-and-distortion>>.

Këto deklarata nuk janë mohim i Holokaustit, por janë të lidhura ngushtë me të si një formë radikale e antisemitizmit. Ata mund të sugjerojnë se Holokausti nuk shkoi aq larg sa duhet për të përmbushur qëllimin e tij për “Zgjidhjen Përfundimtare të Çështjes Hebraike”;

- *përpyqjes për të turbulluar përgjegjësinë për ngritjen e kampeve të përqendrimit dhe të vdekjes, të krijuara dhe të operuara nga Gjermania naziste, duke fajësuar kombet ose grupet e tjera etnike.*

Aneks 3

Shqiptarët dhe hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore

Në tërë historinë e tyre, shqiptarët e kanë dashur dhe inkurajuar paqen dhe bashkëpunimin midis popujve. Ata i kanë mirëpritur vizitorët e huaj në vendin e tyre duke shpalosur shpirtin e tyre mikpritës e miqësor. Bashkëjetesa ndër shekuj e popullit shqiptar me popullin hebre ka përafruar gjithnjë e më shumë dy vendet tona, duke krijuar ngaherë marrëdhënie miqësore, të ngrohta dhe solide.

Nazistët vranë 6 milionë hebrenj, por Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë ku asnjë hebre nuk vdiq ose u dorëzua, madje që i vetmi vend me më shumë hebrenj pas Luftës së Dytë Botërore sesa përpara saj. Në një kohë kur në kontinentin tonë, të ishe hebre, ishte praktikisht një dënim me vdekje, Shqipëria u kthye në një strehë të sigurt për hebrenjtë. Në themel të këtij akti human, qëndron “Besa” - kodi i nderit i shqiptarëve, i cili është i rrënjësuar thellë në kulturën dhe besimin e çdo shqiptari, qoftë ai mysliman, ortodoks apo katolik. Kjo sjellje morale kërkon nga çdo shqiptar që të hapë dyert dhe të marrë përgjegjësinë për jetën e “mikut”, në rast nevojë, duke e mbrojtur atë pavarësisht rrezikut dhe pasojave që mund të ketë vetë.

Deri vonë, Shqipëria ndoqi një politikë izoluese, kështu që askush nuk mundi t'i bënte të njohura veprimet e shqiptarëve në mbrojtje të hebrenjve. Në vitin 1991, shumica e bashkësisë hebre u vendos nga Shqipëria në Izrael, ku morën me vete dokumente, të cilat tregonin se si shqiptarët i kishin shpëtuar duke rrezikuar veten e tyre e që pikërisht ky akt i madh unik, njerëzor duhej të gëzonte nderin që i takonte.

Sipas regjistrimit të Yad Vashem-it, hebrenjtë që u shpëtuan në Shqipëri ishin 2265. Kjo listë i përket vitit 2005. Dy javë më parë, në Forumin Ndërkombëtar mbi Përkujtimin e Holokaustit dhe Luftën kundër Antisemitizmit, të mbajtur në Malmo, kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, i ka dorëzuar personalisht drejtorit të muzeut të Yad Vashem, një listë të përditësuar me të gjitha të dhënat përkatëse, ku shkon në **3750 numri i hebrenjve të shpëtuar në Shqipëri**.

Humanizmi, fryma e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, si dhe bashkëpunimi mes kombeve citohen në krye të kushtetutës sonë:

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, **për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare**, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin

dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit.”

Po ashtu dhe neni 18 i saj citon:

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore

Kjo Kushtetutë përshkallëzohet në ligjin "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë". Neni 5 "E drejta për arsimim" thekson: "Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar."

Nelson Mandela ka shkruar "Arsimimi është arma më e fortë që ne mund të përdorim për të ndryshuar botën". Në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, arsimi përveç të tjerave ka si synim të edukojë nxënësin e aftë:

- të ketë bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia, bashkëpunimi dhe respekti për të tjerët janë vlerat më të larta njerëzore;
- të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmesën e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë;
- të respektojë traditat e popujve të tjerë;

Kurrikula e historisë – programi lëndor

Hartimi i programit lëndor të historisë mbështetet në Rekomandimet Rek (2001)¹⁵ të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

Holokausti është pjesë e kurrikulës së re të historisë në arsimin parauniversitar (nga 2014 dhe në vazhdim, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë").

Kurrikula e historisë si në arsimin bazë ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë siguron hapësirë të bollshme në adresimin e temave dhe aktiviteteve të Holokaustit (tema dhe çështje), ku nxënësit fitojnë njohuritë/aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme në lidhje me këtë periudhë dhe ngjarje historike.

Gjatë mësimin të historisë nxënësit krahas studimit të ngjarjeve historike që kanë karakterizuar shekullin XX, aftësohen të parandalojnë përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur në histori si Holokausti, gjenocidi dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të vlerave

themelore dhe të të drejtave të njeriut, të cilat theksohen në mënyrë të veçantë në Rekomandimet e Këshillit të Evropës.

Përgjatë lëndës së historisë nxënësit aftësohen:

- të gjykojnë dhe të vlerësojnë natyrën e ndryshueshme të konflikteve dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve dhe ndikimet e saj në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë natyrën dhe ndikimin e dy luftërave botërore, Holokaustit dhe rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve;
- të shpjegojnë dhe të gjykojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore: pasojat ekonomike, pasojat sociale, pasojat psikologjike, gjenocidin e në veçanti pasojat e Holokaustit;
- të vlerësojnë rolin e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve të luftës;
- të vlerësojnë rolin dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore.
- të njihen dhe tëndërgjegjësohen me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët në historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;
- të reflektojnë mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmanget përsëritja e fakteve të tilla;
- të kryejnë aktivitete të ndryshme në funksion të zbatimit të vendimit të ministrave të edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkollë të një dite përkujtimore të Holokaustit për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- të kujtojnë ashtu si Evropa, 27 janarin, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit duke kryer aktivitete dhe projekte të ndryshme në këtë ditë.

Tekstet shkollore të historisë

Bazuar në programet e historisë, autorët e teksteve shkollore kanë hartuar tekstet e reja të historisë për arsimin parauniversitar në Shqipëri, të cilat janë certifikuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit gjatë viteve 2015-2020. Trajtimi i Holokaustit është pjesë e këtyre teksteve.

Tema të tilla në tekstin shkollor të historisë si “Shqiptarët dhe hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore” nxisin kuriozitetin e nxënësve për të njohur historinë dhe kulturën e hebrenjve ndër shekuj, guximin, heroizmin dhe forcën e tyre për të mbijetuar dhe për t’u ringritur. Po ashtu ata vlerësojnë ndihmën që populli shqiptar iu dha mijëra hebrenjve, në një kohë kur pjesa tjetër e Evropës iu mbylli dyert.

Veprimtaritë për Holokaustin të vendosura në programet dhe tekstet e historisë i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të respektojnë

vërtetësinë e burimeve historike duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga "mësimet" historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën "të burgosurit" e saj.

Nxënësit për këtë pjesë të errët të historisë së njerëzimit me pasoja fatale, vlerësojnë dhe gjykojnë ngjarjen historike për të mos harruar të shkuarën në mënyrë që ngjarje të tilla të mos përsëriten më kurrë dhe e ardhmja të ndërtohet e sigurt.

Materiale burimore

Për mësimin dhe trajtimin e Holokaustit, mësuesit i referohen materialeve të prodhuara nga Këshilli i Evropës, të tilla si "Udhëzimet për mësuesit dhe edukatorët" për mësimin rreth Holokaustit. Gjithashtu mund të përdoren publikime të UNESCO -s, ODIHR, IHRA. muzeut Yad Vashem, Rekomandimet për mësimdhënien dhe mësimin rreth Holokaustit- 2019, IHRA, dhe publikimet e studiuesve shqiptarë, si më poshtë:

- *Historia e shqiptarëve volumni IV*
- *"Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj" Apostol Kotani*
- *"Shqiptarët dhe hebrenjtë" Shaban Sinani*
- *"Hebrenjtë në trojet shqiptare" Edmond Malaj*
- *"Hebrenjtë në Shqipëri 1933-1946" Monika Stafa*
- *"Arkiva e shtetit shqiptar" Nevila Nika*

Së fundmi Ambasada e Izraelit në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit promovuan librin "Shqiptarët gjatë Holokaustit dhe shpëtimi i hebrenjve", si pjesë të kurrikulës së arsimit parauniversitar.

Dita e përkujtimit

Bazuar në ligjin nr. 9280, miratuar më 23 shtator 2004, shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin numër 4345, më 11 tetor 2004, Shqipëria kremton 27 janarin si ditën e përkujtimit të Holokaustit, duke e quajtur "Dita e përkujtimit" ose "Dita e kujtesës".

Çdo 27 janar, institucionet qeveritare, kombëtare dhe lokale - marrin pjesë në aktivitete përkujtimore në kujtim të viktimave të Holokaustit dhe atyre që sakrifikuan jetën e tyre në luftën për liri kundër nazizmit. Në manifestimet përkujtimore marrin pjesë zyrtarë qeveritarë të të gjitha niveleve, duke përfshirë presidentin, kryeministrin dhe ministra të tjerë të Këshillit të Ministrave, kryetarin e Kuvendit Popullor, kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe zyrtarë të tjerë dhe punonjës të qeverisë.

Shkollat organizojnë aktivitete dhe projekte të ndryshme në kujtim të viktimave të Holokaustit.

Vendet e përkujtimit të Holokaustit në Shqipëri:

- Një hapësirë publike në Shqipëri kushtuar Holokaustit, është një pavion në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. E përbërë nga fotografi, tekste, harta dhe dokumente të kohës së luftës, ai u hap më 29 Nëntor 2004.
- Muzeu "Solomon" në Berat u hap më 3 maj 2018 dhe i kushtohet hebrenjve në Shqipëri.
- Në korrik 2020 Shqipëria ka përruruar memorialin e Holokaustit në kryeqytet për nder të nderimit të hebrenjve dhe qytetarëve shqiptarë që rrezikuan jetën e tyre për të mbrojtur hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Memoriali i Holokaustit në Tiranë u projektua nga arkitekti i shquar hebre Stephen Jacobs. 81 vjeçari Stephen Jacobs i mbijetuari i Holokaustit, pranoi që të punojë në këtë memorial pasi mësoi se Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë që kishte më shumë hebrenj se më parë pas Luftës së Dytë Botërore. Memoriali i Holokaustit në Tiranë, përmes një mbishkrimi në tri pllaka guri, shkruar në anglisht, hebraisht dhe shqip "Shqiptarët, të krishterë dhe myslimanë, rrezikuan jetën e tyre për të mbrojtur dhe shpëtuar hebrenjtë", thekson bashkëjetesën paqësore fetare në Shqipëri, si dhe fisnikërinë e kontributit të shqiptarëve në shpëtimin e hebrenjve.

Përrurimi i këtij memoriali prej guri në Shqipëri vjen si një inkurajim dhe është veçanërisht domethënëse gjatë pandemisë globale COVID-19, ku janë shfaqur shenja shqetësuese të dhunës dhe antisemitizmit kudo në botë".

Aktivitete të ndërmarra në nivelin e institucioneve arsimore

Çdo 27 janar, shkollat organizojnë aktivitete dhe veprimtari që synojnë përkujtimin e Holokaustit dhe viktimave të tij.

Aktivitetet e organizuara në shkolla përfshijnë ekspozita të pikturave dhe të vizatimeve, poezi dhe ese. Temë e përbashkët e të gjitha aktiviteteve është "Kurrë më", ku nxënësit vlerësojnë gabimet historike të së shkuarës për të parandaluar përsëritjen e tyre në të ardhmen. Gjatë këtyre aktiviteteve mësuesit dhe nxënësit integrojnë tema multi-kulturore, si: antisemitizmin, gjenocidin dhe krime të tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive, shkeljen e të drejtave dhe vlerave themelore të njeriut, etj.

Bashkëpunimi me Izraelin

Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri ka pasur gjithnjë marrëdhënie të forta bashkëpunimi me shtetin e Izraelit. Kështu:

- janë zhvilluar workshope në Izrael me pjesëmarrjen e një grupi mësuesish të historisë nga Tirana, Berati, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Lezha dhe Kukësi, si dhe të disa specialistëve/ekspertëve të arsimit.

Në këto workshope janë trajtuar tema: “Një kalim mbi përditshmërinë e jetës së hebrenjve në Evropë para luftës”, “Holokausti dhe Lufta e Dytë Botërore”, “Trajtimi i ngjarjeve të Holokaustit nëpërmjet shfaqjeve të filmit” etj.

- janë zhvilluar seminare me nxënës dhe me mësues në Muzeun Historik Kombëtar, me temë “Të mbrosh një jetë”, me mbështetjen e Ambasadës së Izraelit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- janë organizuar online seminare nga qendra e trajnimeve në Ministrinë e Jashtme të Izraelit, me temë “Rreziku për fëmijët dhe të rinjtë gjatë pandemisë COVID-19”, me pjesëmarrjen e dhjetëra specialistëve të edukimit, mësuesve dhe psikologëve.

Zhvillimi profesional i mësuesve

Në tetor 2019, është ngritur rrjeti i mësuesve të Holokaustit, i përbërë nga 9 mësues nga ZVAP-të Tiranë, Vorë, Elbasan, Shijak, Shkodër, Berat, Fier dhe Përrenjas. Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar seanca të ndryshme trajnime nga rrjeti i mësuesve të Holokaustit lidhur me burimet mjetet dhe veprimtaritë mësimore që përdoren për mësimin e Holokaustit në shkollë.

Përfaqësimi në projektin e vitit 2019 “Holokausti si pikënisje: Të krahasosh dhe të shkëmbesh” që u mbajt në datat 26-28 mars 2019 në kryeqytetin e Maqedonisë së Veriut, në Shkup ku morën pjesë 45 mësues, respektivisht nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Nisma arsimore në vijim...

- Përdorimi i përkufizimit të IHRA-s për antisemitizmin në kurrikulën e arsimit parauniversitar.
- Zyrtat Vendore Arsimore në bashkëpunim me shkollat të hartojnë strategji dhe plane konkrete veprimi për luftuar antisemitizmin.
- Trajnimi i specialistëve në arsim
- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit e historisë, mësuesit e edukimit qytetar, mësuesit e gjeografisë dhe mësuesit e letërsisë për format e trajtimit në klasë të çështjeve që kanë të bëjnë me antisemitizmin, Holokaustin, gjenocidin, dhunën, diskriminimin apo çfarëdolloj forme tjetër të shkeljes së të drejtave të njeriut.
- Përkthimi dhe publikimi në gjuhën shqipe i botimit me katër vëllime “Adresimi i antisemitizmit në shkollë”, të hartuara nga UNESCO dhe ODIHR për trajnerët e (1) mësuesve të arsimit fillor, (2) mësuesve të shkollave të mesme, (3) mësuesve të shkollave profesionale, dhe (4) drejtorëve të shkollave. Këto botime do të përdoren nga trajnerë të fushës së arsimit për të punuar në mënyrë efektive drejt forcimit të kapaciteteve dhe zhvillimit profesional të drejtorëve dhe të mësuesve të shkollave për të parandaluar dhe reaguar ndaj antisemitizmit.

Aneks 4

Holokausti dhe ndihma që shqiptarët u ofruan hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore

Auzhvici

Auzhvici është kampi më i madh dhe më i tmerrshëm i përqendrimit dhe i shfarosjes. Organizator i vrasjeve masive është Adolf Eichmann. Ai kryeson departamentin e ashtuquajtur për çështje hebreje në Zyrën e Sigurimit të Rajhut. Me përfundimin e luftës, Eichmann me ndihmën e Vatikanit u largua për në Argjentinë.

Në maj të vitit 1960, Eichmann gjurmohet nga shërbimi inteligjent izraelit. Ai rrëmbehet dhe dërgohet në Izrael. Kundër tij zhvillohet një proces gjyqësor, në të cilin ai përpiket të minimizojë rolin e tij gjatë Holokaustit:

“Mua më vjen keq dhe e dënoj shfarosjen e hebrenjve, të urdhëruar nga udhëheqja e atëhershme shtetërore.”. Ai deklaron se vetë nuk ka qenë në gjendje të bëjë të pamundurën: “Unë kam qenë vetëm një mjet në duart e pushteteve të forta dhe forcave të fuqishme të “një fati të pashpjegueshëm”, dhe përpiket ta minimizojë përgjegjësinë e tij. Arsyetimet cinike dështojnë në gjyq dhe mbeten pa efekt. Gjykata e shpall atë fajtor dhe e dënon me vdekje. Eichman ekzekutohet në vitin 1962.

Adolf Eichmann kapet në Argjentinë në vitin 1960 nga shërbimi inteligjent izraelit. Kampi i përqendrimit në Auzhvic, rreth 60 kilometra në jugperëndim të Krakovit u ngrit në pranverën e vitit 1940. Në shtator të vitit 1941, komandanti i kampit Rudolf Hess jep urdhrin që të përdoret gazi me helm “Ciklon B” për të vrarë të burgosurit. Ciklon B përdorej fillimisht si një mjet dezinfektues. Tymi i tij shkakton vdekjen brenda disa minutave. Që nga viti 1942, trupat SS i dëbonin hebrenjtë nga e gjithë Evropa në Auzhvic. Nga viti 1943, hebrenjtë, romët dhe të përndjekurit e tjerë nga nazistët vriteshin në mënyrë “industriale”: Të burgosurit vriteshin në katër dhoma gazi dhe më pas digjeshin në furra të mëdha.



Holokausti dhe ndihma që shqiptarët u ofruan hebrenjve

Si shqiptarë e hedhim vështrimin nga historia dhe krenohemi me faktin se hebrenjtë u mirëpritën, u strehuan dhe u shpëtuan nga vdekja e sigurt prej shqiptarëve, duke fituar edhe titullin “Të drejtët mes kombeve”.

Nazistët vranë 6 milionë hebrenj, por Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë ku asnjë hebre nuk vdiq ose u dorëzua, madje që i vetmi vend me më shumë hebrenj pas Luftës së Dytë Botërore sesa përpara saj. Sipas regjistrit të Yad Vashem-it, hebrenjtë që u shpëtuan në Shqipëri ishin 2265. Kjo listë i përket vitit 2005. Në Forumin Ndërkombëtar mbi Përkujtimin e Holokaustit dhe Luftën kundër Antisemitizmit, të mbajtur në Malmo, 2021, kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama i ka dorëzuar personalisht drejtorit të muzeut të Yad Vashem, një listë të përditësuar me të gjitha të dhënat përkatëse, ku numri i hebrenjve të shpëtuar në Shqipëri shkon në 3750.

Arin PO, hebrenjtë JO

Shqipëria ishte i vetmi vend ku hebrenjtë nuk iu dorëzuan nazistëve që vranë 6 milionë hebrenj. Shqiptarët mbrojtën jetën e disa mijërave hebrenjve dhe ndihmuan hebrenjtë që ikën nga Gjermania dhe Austria. Jeta e refugjatëve hebrenj u shpëtua nga nazistët në Shqipëri në sajë të një ujdie të pashkruar të të gjithë shqiptarëve: myslimanë apo të krishterë.

Autoritetet më të larta të klerit shqiptar u thirrën në Berlin, të konsideruar si pala me të cilën pushtuesit nazistë mund të komunikonin dhe të negocionin. Ata iu kërkuar atyre dy gjëra; të drejtën mbi arin e Shqipërisë të depozituar në Itali dhe listën e hebrenjve të strehuar në Shqipëri. Të gjithë përfaqësuesit më të lartë të klerit asokohe, të krishterë dhe myslimanë, dhanë një përgjigje: "Arin po, hebrenjtë jo!"

Falënderime

- Joel Rubin, drejtor ekzekutiv i Kongresit të Hebrenjve shprehet: “Si një hebre amerikan, unë dua të falënderoj personalisht popullin shqiptar për atë që ju keni bërë, në emër të njerëzve hebrenj gjatë Luftës së Dytë Botërore, për të shpëtuar jetën e tyre. Shqipëria është i vetmi vend që pati më shumë hebrenj pas Holokaustit se sa para tij dhe për këtë jemi mirënjohës”.
- Yael Katzir, regjisore e filmit “Kodi i shqiptarit”, thotë: “Unë e bëra filmin dhe pse nuk jam regjisore Holokausti, por kur dëgjova historinë për Shqipërinë dhe se sa hebrenj kanë shpëtuar shqiptarët, nuk mund të qëndroja indiferente”.
- Ambasadori i Izraelit në Tiranë, Noah Gal Gendler tregon për Deutsche Wellen, se historia e mbrojtjes së jetës së hebrenjve në Shqipëri në kohën e pushtimit nazist duhet të njihet, për mesazhin e vlerës së jetës, humanizmit si vlera të njerëzimit që


kjo histori përmban. "Memoriali është një nga mënyrat për ta treguar këtë shembull të shkëlqyer të një vendi të vogël si Shqipëria, shembull dashurie dhe sakrifice për jetën. Ky është qëllimi kryesor dhe natyrisht për të edukuar brezat e rinj. Nëse kjo histori nuk tregohet pas 20- 30 vitesh, brezat e rinj në Shqipëri nuk do të dinë asgjë për atë. Këtë e them nga përvoja jonë. Memoriali jep një mesazh tolerance, përherë aktual, që duhet shpërndarë", thotë ambasadori izraelit Gendler.

"Pa dyshim është një histori unike në botë, një kombinim elementesh të ndryshëm, ku në krye është "besa" kaq e çmuar në Shqipëri. Në sajë të "besës" është bashkëpunimi i shkëlqyer mes zyrtarëve të qeverisë së asaj kohe vendase dhe hebrenjve, gjë që në shumicën e vendeve të tjera nuk ndodhi, pasi aty kishte përherë dikë që tregonte se ku fshiheshin familjet hebreje. Kjo gjë nuk ndodhi kurrë në Shqipëri", thotë ambasadori Gendler.

Historia e hebreat Avram Elaif dhe tiransit Beqir Qoqja

Tre gurë të lartë, prej mermeri gri të vendosur në hyrjen e Parkut të Liqenit Artificial të Tiranës, prezantojnë Memorialin e Holokaustit, në Shqipëri. Në tri gjuhë të ndryshme, shqip, hebraisht dhe anglisht, në secilin prej tyre dëshmohet e njëjta ngjarje historike: refuzimi i popullit shqiptar për të kallëzuar dhe dorëzuar refugjatët hebrenj dhe mikpritësit e tyre tek pushtuesit nazistë, rrezikimi i jetës për të shpëtuar hebrenjtë.

Memoriali përkujton dhe nderon 6 milionë hebrenjtë që u vranë dhe u shfarosën nga nazistët në vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe dhjetëra shqiptarë që shpëtuan jetën e qindra hebrenjve. Në bazamentin e Memorialit shkruhet me shkronja të arta shprehja në shkrimet e shenjta: "Kush shpëton një jetë, shpëton botën mbare".



Beqir Qoqja me emrin e gdhendur në Yad Vashem

A e dinin këtë shqiptarët që u shpëtuan jetën hebrenjve duke rrezikuar të tyre?

Një pasdite tetori në vitin 1943, në Tiranën e pushtuar nga nazistët, një burrë i ri trokiti në derën e dyqanit të rrobaqepësit tiranas, Beqir Qoqja. Ishte hebreu Avram Elaif, që i rekomanduar nga miq në Vlorë të rrobaqepësit Beqir Qoqja i kërkoi atij strehim dhe mbrojtje nga nazistët që e ndiqnin. Beqir Qoqja, ustai 27- vjeçar, i sapomartuar dhe me një vajzë foshnjë 1- vjeçare, e mori që atë mbrëmje Avramin në familjen e tij të re dhe e mbrojti deri sa lufta mbaroi. Avram Elaifi ishte në besën e tij, i dërguar nga Jozef Jakoel, një mik hebre në Vlorë i rrobaqepësit. Avrami dhe Beqiri kanë vite që kanë ndërruar jetë, por historia e tyre është e gjallë sot e kësaj dite. Atë e rrëfen për Deutsche Wellen, djali i Beqirit, pensionisti 68 vjeçar, Fatos Qoqja në shtëpinë e tij pothuaj 100- vjeçare me avlli, pemë dhe lule ku u strehua dhe u mbrojt nga nazistët gjerman dhe hebreu Avram Elaif.

Jetoj me familjen time në të njëjtën shtëpi ku lindi dhe ku babai im strehoi hebreun Avram Elaif. Kur nazistët filluan kontrollet për hebrenjtë dhe reprezaljet, babai arriti me miqtë e tij, t'i nxirrte një pasaportë me emrin Gani Qoqja, e veshi me rroba fshatari dhe bashkë me atë u largua në një fshat të Krujës deri sa situata të qetësohej disi,” tregon Fatos Qoqja.

“Kur lufta mbaroi, Avram Elaif dhe familja e tij që jetonin në Vlorë vazhduan jetën në Shqipërinë komuniste. Avrami qëndroi në Tiranë, filloi punën si llogaritar në Kinostudio, u martua me një vajzë hebreje, të mbrojtur nga një familje tjetër tiranase, krijoi familjen e tij dhe u bë me një djalë. Ai, derisa iku në Izrael, në vitin 1991, mbeti pjesë e familjes tonë. U nda me lot ne sy. Ju pres në Jeruzalem, na tha. Në Izrael mbajti emrin Avram Gani Qoqja, Emri Gani, u thoshte autoriteteve izraelite, më shpëtoi jetën. Kur im atë shkoi atje për të marrë Certifikatën e Mirënjohjes, për fat të keq Avrami kishte pak muaj që kishte ndërruar jetë. Babai më ka treguar mallëngjimin e madh kur takoi familjen e tij, mirënjohjen e tyre ndaj familjes sonë. Nëna e Avramit i puthte duart babait tim duke i thënë: Ke shpëtuar një jetë, jetën e djalit tim”, tregon për Deutsche Wellen (DW)” Fatos Qoqja.

Në një kënd të shtëpisë ai ka krijuar një muze të thjeshtë, por të rrallë për nga vlerat e tij me fotot e atyre viteve. Në krye është Certifikata e Mirënjohjes që iu dha të atit kur shkoi në Jeruzalem, Ka edhe fotografi nga Muri i Nderit, në Kopshtin e të Drejtëve dhe në Yad Vashem ku është gdhendur edhe emri i Beqir Qoqes.



Certifikata e nderimit për Beqir Qoqjan

Aneks 5

Përdorimi i fjalës hebre në gjuhën shqipe

Fjala “çifut” ka hyrë në shqip gjatë shekujve të pushtetit osman dhe ka shënjuar në mënyrë neutrale individët e etnisë përkatëse. Duke ditur ndikimin e madh të gjuhës turke tek gjuha jonë, kjo fjalë ka zënë vend në përdorimin e përditshëm. Në gjuhën turke fjala “çifut” ka një konotacion negativ dhe konsiderohet si fjalë fyese me natyrë raciste. Në gjuhën shqipe, fjala “çifut” nuk ka qenë përdorur në kontekste të diskriminimit, denigrimit racial dhe të persekutimit antisemit. Për këtë arsye, asnjë nga fjalorët e shqipes nuk e shënjon fjalën “çifut” si tabu a si keqësuese, por vetëm sa e përkufizon si:

Pjesëtar i një populli që banonte në Palestinë deri në shekujt e parë të erës sonë dhe që më pas u shpërnda në vende të ndryshme të botës; ai që e ka prejardhjen nga ky popull dhe që banon sot në Izrael ose në vende të tjera të botës; Sinonimi hebre [133] Përkundrazi, një përdorim i figurshëm i kësaj fjale, me kuptimin “dorështrënguar, koprrac, që sheh gjithnjë përfitimin”, ka nuanca negative. Edhe pse ky përdorim i referohet stereotipit folklorik të hebreat në kulturën evropiane, ai sot nuk zbatohet dhe nuk duhet të zbatohet më ndaj individëve të kësaj etnie. Antisemitizmi mund të mos ketë rrënjë kulturore mes nesh, por kjo nuk i bën gjë shqiptarët vetvetiu imunë ndaj tij.

Ndaj në shqipen e sotme çifut, si fjalë bisedore, e cila ka zhvilluar edhe një kuptim negativ “koprrac”, duhet zëvendësuar me fjalën hebre, si në ligjërimin libror ashtu edhe në atë bisedor. Edhe në gjuhën angleze p.sh., përdoren fjalë si Jew dhe Jewish, të cilat nuk janë as fyese as raciste në vetvete. Fjala çifut në të gjitha përdorimet e saj, e ka marrë rrugën drejt tabuizimit dhe nuk ka më të ardhme në shqipen e përditshme, sidomos në atë publike.

Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe; Recommendation CM/Rec (2011)6 of the Committee of Ministers to member states on intercultural dialogue and the image of the other in history teaching

[133] Difference between Jewish and Hebrew | Jewish vs Hebrew

Aneks 6

Deklarata e Stokholmit

“Holokausti (Shoah) në thelb sfidoi themelet e qytetërimit. Karakteri i paprecedentë i Holokaustit do të ketë gjithmonë kuptim universal.”

Neni 1 i Deklaratës së Stokholmit

Deklarata e Forumit Ndërkombëtar të Stokholmit mbi Holokaustin ose “Deklarata e Stokholmit”, është dokumenti themelues i Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit dhe vazhdon të shërbejë si një afirmim i vazhdueshëm i angazhimit të secilit vend anëtar të IHRA-s ndaj parimeve të përbashkëta.

Deklarata ishte rezultat i Forumit Ndërkombëtar të mbledhur në Stokholm midis 27-29 janar 2000 nga ish-kryeministri suedez Göran Persson. Në Forum morën pjesë përfaqësues të 46 qeverive, duke përfshirë 23 krerë shtetesh ose kryeministra dhe 14 zëvendëskryeministra ose ministra.

Vizioni i tyre ka mbetur i paprekur, i pandryshuar gjatë viteve që pasuan, duke demonstruar vlerën e saj universale dhe të qëndrueshme.

Anëtarët e Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit janë të përkushtuar ndaj Deklaratës së Forumit Ndërkombëtar të Stokholmit mbi Holokaustin, në të cilën citohet si më poshtë:

- Holokausti (Shoah) në thelb sfidoi themelet e qytetërimit. Karakteri i paprecedentë i Holokaustit do të ketë gjithmonë kuptim universal. Pas gjysmë shekulli, ai mbetet një ngjarje mjaft e afërt në kohë pasi të mbijetuarit janë dëshmitarë të tmerreve që përfshinë popullin hebre. Vuajtjet e tmerrshme edhe të shumë miliona viktimave të tjera të nazistëve kanë lënë një mbresë të pashlyeshme në të gjithë Evropën.
- Përmasat fatale të krimeve të Holokaustit, të planifikuara dhe të kryera nga nazistët, duhet të mbeten përgjithmonë në kujtesën tonë kolektive. Sakrificat vetëmohuese të atyre që sfiduan nazistët, dhe jo rrallë dhanë jetën e tyre për të mbrojtur ose shpëtuar viktimat e Holokaustit, duhet të jenë gjithashtu të gdhendura në zemrat tona. Thellësitë e atij tmerrri dhe majat e heroizmit të tyre janë gurë provash në kuptimin tonë të aftësisë njerëzore për të keqen dhe për të mirën.
- Me njerëzimin ende të plagosur nga gjenocidi, spastrimi etnik, racizmi, antisemitizmi dhe ksenofobia, komuniteti ndërkombëtar ndan një përgjegjësi solemne për të luftuar këto të këqija. Së bashkë ne duhet të mbështesim të vërtetën e tmerrshme të Holokaustit kundër atyre që e mohojnë atë.

Ne duhet të forcojmë angazhimin moral të popujve tanë dhe angazhimin politik të qeverive tona, për të siguruar që brezat e ardhshëm të kuptojnë shkaqet e Holokaustit dhe të reflektojnë mbi pasojat e tij.

- Ne zotohemi të forcojmë përpjekjet tona për të promovuar edukimin, kujtesën dhe kërkimin rreth Holokaustit, si në vendet tona që kanë bërë tashmë shumë, ashtu edhe në ato që vendosin t'i bashkohen kësaj përpjekjeje.
- Ne angazhohemi për të inkurajuar studimin e Holokaustit në të gjitha dimensionet e tij. Ne do të promovojmë edukimin për Holokaustin në shkollat dhe në universitetet tona, në komunitetet tona dhe do ta inkurajojmë atë në institucione të tjera.
- Ne angazhohemi për të përkujtuar viktimat e Holokaustit dhe për të nderuar ata që qëndruan kundër tij. Ne do të inkurajojmë forma të përshtatshme të përkujtimit të Holokaustit, duke përfshirë një ditë të Përkujtimit të Holokaustit, në vendet tona. (27 Janari, Dita e përkujtimit të Holokaustit)
- Ne angazhohemi për të hedhur dritë mbi hijet ende të errëta të Holokaustit. Ne do të ndërmarrim të gjitha hapat e nevojshëm për të lehtësuar hapjen e arkivave, në mënyrë që të sigurojmë që të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me Holokaustin, të jenë në dispozicion të studiuesve.
- Është me vend që kjo, konferencë e madhe ndërkombëtare e mijëvjeçarit të ri, të deklarojë përkushtimin e saj për të mbjellë farat e një të ardhmeje më të mirë në tokën e një të shkuare të hidhur. Ne jemi të ndjeshëm ndaj vuajtjeve të viktimave dhe frymëzohemi nga lufta e tyre. Ne duhet të kujtojmë viktimat që humbën jetën, të respektojmë të mbijetuarit ende me ne dhe të riafirmojmë aspiratën e përbashkët të njerëzimit për mirëkuptim dhe drejtësi të ndërsjellë.

Aneks 7

Deklarata ministrore e IHRA[1]-s 2020 (2020 IHRA Ministerial Declaration)

Në 75-vjetorin e çlirimit të kampeve naziste gjermane të përqendrimit dhe të shfarosjes, si dhe vendeve të tjera të persekutimit dhe vrasjeve, ne, përfaqësuesit e lartë qeveritarë të vendeve anëtare të Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) nderojmë viktimat dhe të mbijetuarit e Holokaustit (Shoah). Ne nderojmë, gjithashtu, viktimat dhe të mbijetuarit e gjenocidit të romëve dhe të tjerëve që u persekutuan. Ne premtojmë të mos harrojmë kurrë ata që u rezistuan nazistëve dhe ata që mbrojtën ose shpëtuan bashkëqytetarët e tyre të persekutuar. Sot, bota ende përballet me gjenocid, krime lufte, spastrim etnik dhe krime kundër njerëzimit dhe kërcënime të vazhdueshme ndaj shoqërive pluraliste, demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Ndërsa dëshmojmë me pikëllim ndarjen e brezit të të mbijetuarve, ne, vendet anëtare të IHRA-s:

- Rikonfirmojmë mbështetjen tonë të palëkundur për Deklaratën e Forumit Ndërkombëtar të Stokholmit (2000), dokumenti themelues i IHRA-s.
- Betohemi që viktimat dhe të mbijetuarit nuk do të harrohen kurrë dhe se trashëgimia e tyre do të mbahet gjallë.
- Theksojmë se kujtimi i gjashtë milionë viktimave hebreje të Holokaustit është përgjegjësi jo vetëm e qeverive, por e shoqërive në tërësi.
- Kujtojmë gjenocidin e romëve. Ne e pranojmë me shqetësim se neglizhenca e këtij gjenocidi ka kontribuar në paragjykimin dhe diskriminimin që shumë komunitete rome përjetojnë ende sot.
- Nderojmë të gjithë ata që u rezistuan nazistëve, veçanërisht të drejtët midis kombeve dhe të tjerët që mbrojtën ose kërkuan të shpëtonin ata që ishin në rrezik. Guximi i tyre vetëmohues duhet të na frymëzojë të gjithëve për të mbrojtur dinjitetin e çdo njeriu.
- Shprehim shqetësimet tona më të thella për rritjen e antisemitizmit.
- Pranojmë përgjegjësinë tonë për të vazhduar punën së bashku për të luftuar mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit, antisemitizmin dhe të gjitha format e racizmit dhe diskriminimit që minojnë parimet themelore demokratike. Ne do të punojmë ngushtë me ekspertët, shoqërinë civile dhe partnerët tanë ndërkombëtarë për të çuar përpara këto synime.
- Theksojmë përpjekjet për të promovuar edukimin, përkujtimin dhe kërkimin mbi Holokaustin dhe gjenocidin e romëve për të kundërshtuar ndikimin e shtrembërimit historik, gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e dhunës.

- Ruajmë të dhënat historike të Holokaustit, gjenocidit të romëve dhe persekutimit të viktimave të tjera nga Gjermania naziste, partnerëve fashistë dhe ekstremë nacionalistë dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që morën pjesë në këto krime.
- Nënvizojmë rëndësinë e identifikimit, ruajtjes dhe vënies në dispozicion të materialit arkivor, dëshmime dhe vendeve autentike për qëllime edukative, përkujtimore dhe kërkimore.
- Inkurajojmë të gjitha vendet dhe shoqëritë që të trajtojnë të kaluarën e tyre përkatëse duke u bazuar në të dhëna të sakta historike.
- Lavdërojmë përpjekjet e qeverive dhe shoqërisë civile për të përkujtuar Holokaustin dhe për të ndarë praktikën e mira.
- Gjykojmë se të kuptuarit e natyrës së paprecedentë të Holokaustit është thelbësore për parandalimin e gjenocidit dhe krimeve të mizorive masive. Ekspertiza e IHRA-s është e rëndësishme për politikëbërjen e informuar historikisht dhe adresimin e sfidave bashkëkohore.
- Të vendosur për të kujtuar ata që vuajtën dhe për të luftuar për një të ardhme më të mirë, i bëjmë thirrje komunitetit ndërkombëtar të ndajë vizionin tonë:

Një botë që kujton Holokaustin

Një botë pa gjenocid

Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit bashkon qeveritë dhe ekspertët për të promovuar edukimin, kujtimin dhe kërkimin e Holokaustit në mbarë botën.

